BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2011

P R I S H T I N Ë , Q E R S H O R 2 0 1 2

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA

CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2011

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore ---- 15

Fjala hyrëse e Guvernatorit ---- 17

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit ---- 21

Struktura organizative e BQK-së ---- 23

1. Përmbledhje ekzekutive ---- 25
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik ---- 27
3. Ekonomia e Kosovës ---- 29
   - 3.1. Sektori real ---- 30
     - 3.1.1. Produkti i brendshëm bruto ---- 30
     - 3.1.2. Çmimet ---- 31
     - 3.1.3. Tregu i punës ---- 32
   - 3.2. Sektori fiskal ---- 32
     - 3.2.1. Të hyrat buxhetore ---- 33
     - 3.2.2. Shpenzimet buxhetore ---- 34
   - 3.3. Sektori financiar ---- 35
     - 3.3.1. Karakteristikat e përgjithshme ---- 35
     - 3.3.2. Sistemi bankar ---- 39
     - 3.3.3. Fondet pensionale ---- 60
     - 3.3.4. Kompanitë e sigurimit ---- 61
     - 3.3.5. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar ---- 62
   - 3.4. Sektori i jashtëm ---- 63
     - 3.4.1. Llogaria rrjedhëse ---- 63
     - 3.4.2. Llogaria kapitale dhe financiare ---- 70
     - 3.4.3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm ---- 72
4. Mbikëqyrja e institucioneve financiare ---- 74
   - 4.1. Licencimi dhe rregullativa ---- 74
     - 4.1.1. Licencimi ---- 74
     - 4.1.2. Rregullativa ---- 77
   - 4.2. Mbikëqyrja bankare ---- 81
   - 4.3. Mbikëqyrja e sigurimeve ---- 95
   - 4.4. Mbikëqyrja e pensioneve ---- 101
5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun ---- 104
   - 5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme ---- 104
   - 5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive ---- 108
   - 5.3. Sistemi i pagesave ---- 111

5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar ---------- 111
5.3.2 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar ---------- 114
5.4. Menaxhimi i mjeteve ---------- 117
5.4.1 Menaxhimi i Mjeteve dhe Politika e Investimeve të BQK-së ---------- 117
5.4.2 Menaxhimi i Mjeteve në vitin 2011 ---------- 118
5.4.3 Menaxhimi i Rrezikut të Investimeve ---------- 120
5.4.4 Procesi i tregtimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë ---------- 121
5.5. Regjistri i kredive të Kosovës ---------- 122
5.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar ---------- 123
5.7. Aktiviteti në fushën e statistikave ---------- 125
6. Zhvillimet e brendshme ---------- 126
6.1. Kontrolli i brendshëm ---------- 126
6.2. Burimet Njerëzore ---------- 129
6.3. Aktiviteti Ligjor i BQK-së ---------- 130
6.4. Teknologjia informative ---------- 132
7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar ---------- 134
7.1. Marrëveshjet, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtare ---------- 134
8. Pasqyrat financiare të BQK-së ---------- 137
9. Shtojca statistikore ---------- 175
10. Referencat ---------- 187

LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përimirësimin e Ambijentit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio)
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSFAE	Departamenti për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike
DST	Drejtat Speciale të Tirazhit
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. Euroepan Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	General Directorate of European Statistics
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBR	Great Britain Pound
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index)

IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index)
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Auto-Përgjegjësisë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NPL	Kreditë Joperformuese (angl. Non Performing Loans)
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Procredit Bank
PIN	Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (angl. Producer Price Index)
PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse (angl. Purchasing Power Parity)
PTK	Posta dhe Telekomi i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate)
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Riskut (angl. Risk Weighted Assets)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SRK	Sistemi i Regjistrit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommuniacation
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)

TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
USD	United States Dollar
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E FIGURAVE

1. Harta makroekonomike ---- 29
2. Rritja reale e PBB-së ---- 30
3. Indeksi i Çmimit të Konsumit, importit dhe Prodhimit ---- 31
4. Kontributi i komponentëve të CPI-së në inflacionin vjetor ---- 31
5. Burimet kryesore të të hyrave kufitare ---- 33
6. Burimet kryesore të të hyrave nga tatimet vendore ---- 33
7. Struktura e kategorive kryesore të shpenzimeve buxhetore ---- 34
8. Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve ---- 36
9. Kërkesat neto të sektorit financiar ---- 37
10. Asetet e jashtme neto, sipas institucioneve ---- 37
11. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm ---- 38
12. Struktura e e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm ---- 38
13. HHI për asete, kredi dhe depozita ---- 39
14. Kontributi në rritjen e aseteve të sistemit bankar sipas kategorive ---- 40
15. Rritja e aseteve ---- 41
16. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve ---- 42
17. Struktura e kredive ---- 42
18. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike ---- 42
19. Norma vjetore e rrijtes së kredive sipas sektorëve ekonomik ---- 43
20. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit ---- 43
21. Norma e rritjes së kredive sipas afatit të maturimit ---- 44
22. Struktura e depozitave sipas sektorëve ---- 45
23. Struktura e depozitave të afatizuara sipas maturitetit ---- 46
24. Mesatarja e normave të interesit ---- 46
25. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve ---- 47
26. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve ---- 47
27. Struktura e të hyrave ---- 48
28. Struktura e të hyrave sipas kategorive ---- 48
29. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive ---- 48
30. Normat vjetore të rritjes së shpemzimeve sipas kategorive ---- 49
31. Struktura e shpenzimeve e sektorit bankar ---- 49
32. Struktura e shpenzimeve ---- 50
33. Tregusit e profitabilitetit ---- 50
34. Raporti shpenzime / të hyra ---- 51
35. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar ---- 51
36. Raporti asete likuide “broad”/detyrime afatshkurtëra ---- 52
37. Rezervat e sistemit bankar ---- 53

38. Struktura e kredive sipas klasifikimit ---- 53
39. Struktura e kredive joperformuese ---- 54
40. Raporti NPL/gjithsej kreditë ---- 54
41. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve ---- 54
42. NPL-të dhe provizionet ---- 55
43. Kapitalizmi i sistemit bankar ---- 55
44. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ ---- 56
45. Gjithsej kapaitali dhe norma vjetore e rritjes ---- 56
46. Struktura e kapitalit e sistemit bankar ---- 57
47. Struktura e kapitalit të klasit të parë ---- 57
48. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut ---- 58
49. Çmimi e aksionit të TKPK-së dhe indeksi DJI ---- 60
50. Struktura e investimeve të Trustit ---- 60
51. Primet e shitura dhe dëmet e paguara ---- 61
52. Asetet e IMF-ve ---- 62
53. Bilanci i llogarisë rrjedhëse ---- 64
54. Kategoritë kryesore të strukturës së importeve ---- 65
55. Kategoritë kryesore të strukturës së eksporteve ---- 65
56. Importet sipas BEC-it ---- 66
57. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë ---- 66
58. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtarë ---- 67
59. Llogaria e shërbimeve – kategoritë kryesore ---- 67
60. Llogaria e të ardhurave ---- 68
61. Transferet rrjedhëse ---- 69
62. Dërgeasat e emigrantëve të pranuara në Kosovë ---- 69
63. Llogaria financiare neto ---- 70
64. Investimet e Huaja Direkte si përqindje e PBB-së ---- 70
65. Investimet e Huaja Direkte sipas sektorit ekonomit ---- 71
66. Investimet e Huaja Direkte sipas vendit të origjinës ---- 71
67. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare ---- 72
68. Asetet sipas formës së investimeve ---- 72
69. Detyrimet sipas formës së investimeve ---- 73
70. Trendi i mjeteve në sektorin bankar ---- 82
71. Trendi i kredive në sektorin bankar ---- 83
72. Trendi i depozitave në sektorin bankar ---- 85
73. Pjesëmarrja e kredive problematike dhe kredive jopërformuese në gjithsej kreditë ---- 87
74. Ecuria e gjithsej mjeteve në sektorin mikrofinanciar dhe jobankar kreditues ---- 90
75. Struktura e pronësisë së kompanive të sigurimit ---- 95
76. Struktura e aseteve të industrisë së sigurimeve ---- 97

77. Struktura e detyrimeve të industrisë së sigurimeve ---- 98
78. Paraqitja grafike e lëvizjes se çmimit të njësisë ---- 102
79. Furnizimi me para të gatshme ---- 104
80. Pranimi i parave të gatshme ---- 104
81. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve ---- 105
82. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve ---- 105
83. Kartëmonedha euro të pranuara sipas denominimeve ---- 105
84. Monedha euro të pranuara sipas denominimeve ---- 105
85. Eksporti i parave të gatshme ---- 106
86. Importi i parave të gatshme ---- 106
87. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi ---- 107
88. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuara ---- 107
89. Furnizimi me kartëmonedha të reja ---- 107
90. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara ---- 107
91. Paratë euro të falsifikuara të konfiskuara në nivel të Kosovës ---- 107
92. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse ---- 109
93. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse ---- 109
94. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse ---- 109
95. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse ---- 109
96. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse ---- 110
97. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse ---- 110
98. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse ---- 110
99. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse ---- 110
100. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së ---- 111
101. Numri i transaksioneve në SEKN ---- 112
102. Vlera e transaksioneve në SEKN ---- 112
103. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN ---- 112
104. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN ---- 112
105. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre ---- 113
106. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre ---- 113
107. Numri i kartelave të debitit sipas llojit të tyre ---- 115
108. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit të tyre ---- 115
109. Numri i terminaleve ATM ---- 116
110. Numri i i terminaleve POS ---- 116
111. Raporti i investimeve të BQK-së ---- 118
112. Shpërndarja e investimeve përgjatë muajve ---- 118
113. Mesatarja mujore e ofruar e realizuar për portfolion e BQK-së ---- 119
114. Mesatarja e kthimit në portfolio dhe kthimit në benchmark ---- 119
115. Numri i certifikatave të gjeneruara ---- 122

116. Hulumtimet në sistemin e regjistrit të kredive ----------122
117. Raportimi i kredive të reja nga institucionet kredidhënëse----------123
118. Përcaktimi i fushave të auditmit në bazë të riskut----------128
119. Struktura e kualifikimit të punonjësve të BQK-së----------129

LISTA E TABELAVE

1. Pagesat elektronike ---- 40
2. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar ---- 41
3. Struktura e detyrimeve e sistemit bankar ---- 44
4. Përmbledhja e rezultateve të analizës stres-test: Rreziku i likuiditetit ---- 59
5. Bilanci tregtar i Kosovës ---- 64
6. Aktiviteti i licencimit të bankave, të kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale ---- 76
7. Aktiviteti i regjistrimit të institucioneve mikro financiare, jobankare financiare, zyreve të transferit të parave dhe zyreve të këmbimit të valutave ---- 76
8. Aktiviteti licencues i ndërmjetësuesve të sigurimit ---- 76
9. Bankat Komerciale ---- 78
10. Fondet pensionale ---- 78
11. Zyrat për transferin e parave ---- 78
12. Institucionet mikrofinanciare ---- 79
13. Institucionet financiare jobankare ---- 79
14. Kompanitë e sigurimeve ---- 80
15. Ndërmjetësuesit e sigurimeve ---- 80
16. Zyrat e këmbimit të valutave ---- 81
17. Kreditë sipas degëve të ekonomisë ---- 84
18. Struktura e kapitalit rregullator në sektor dhe ecuria e komponentëve të tij ---- 86
19. Treguesit e kapitalizimit ---- 86
20. Treguesit e cilësisë së kredive ---- 87
21. Kreditë jopërformuese sipas degëve të ekonomisë ---- 88
22. Treguesit e profitabilitetit ---- 88
23. Treguesit e likuiditetit ---- 89
24. Ekzaminimet në banka ---- 90
25. Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë ---- 91
26. Ecuria e treguesit të profitabilitetit ---- 92
27. Ekzaminimet e kryera gjatë vitit 2011 ---- 92
28. Kreditë – trendi i arkëtimeve ---- 94
29. Depozitat – trendi i rimbursimeve ---- 95
30. Numri i Policave të Shkruara ---- 95
31. Bruto Primet e Shkruara ---- 96
32. Numri i dëmeve të paguara ---- 96
33. Dëmet e Paguara ---- 97
34. Kalkulimi i Margjinës minimale të Solvencës ---- 99
35. Treguesit e Likuiditetit ---- 100
36. Ekzaminimet e plota dhe të fokusuara ---- 101

37. Ekzaminimet e kryera nga mbikëqyrja e pensioneve ----------102
38. Struktura e investimit të mjeteve pensionale ----------103
39. Struktura e kthimit nga investimet e mjeteve pensionale----------103
40. Struktura e investimit të mjeteve pensionale të FSKP-së ----------104
41. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave ----------108
42. Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive----------111
43. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SEKN ----------114
44. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuara/hyrëse në SEKN ----------114
45. Numri i llogarive----------116
46. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave ----------117
47. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut ----------127
48. Zona e auditimit----------128
49. Edukimi, zhvillimi profesional dhe trajnimet e personelit ----------129

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore

Ky Raport reflekton mbi aktivitetin e Bordit të BQK-së, Bordit Ekzekutiv dhe stafit të BQK-së përfshirë zhvillimet më të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, e veçmas në sektorin financiar në vitin 2011. Informimi i publikut të gjerë, si dhe edukimi financiar paraqesin një nga prioritetet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, prandaj në këtë raport janë paraqitur detalisht të gjitha aktivitetet e BQK-së.

Në vitin 2011 ekonomia e eurozonës edhe më tutje i ndjeu pasojat e krizës financiare globale, përkundër rritjes së eksporteve të këtyre vendeve që ishte rezultat i rimëkëmbjes së ekonomisë botërore. Problemet me borxhin shtetëror dhe rënia e besimit të bizneseve ishin faktorët kyç që ndikuan negativisht në eurozonë.

Gjatë vitit 2011 Kosova shënoi normën më të lartë të rritjes në krahasim me vendet e rajonit (5%), përkundër sfidave të shkaktuara nga turbulencat në ekonominë globale, e sidomos në atë evropiane. Mbështetja e lartë e ekonomisë së Kosovës në importe ndikoi negativisht në normën e rritjes, si dhe deficitin në llogarinë rrjedhëse. Dërgesat e emigrantëve vazhduan me trendin pozitiv të rritjes dhe paraqesin njërën nga komponentët më të rëndësishme të financimit të konsumit në vend.

Ekonomia e Kosovës edhe më tej karakterizohet me normë të lartë të papunësisë, që paraqet sfidën më kryesore të stabilitetit ekonomik e social në vend. Normat e rritjes ekonomike të viteve të fundit nuk po arrijnë të absorbojnë fuqinë punëtore në vend për shkak të strukturës së re të popullsisë. Presionet inflacioniste ishin prezente edhe në vitin 2011 në ekonominë e vendit. Norma mesatare e inflacionit ishte 7.3%. Në nivelin e inflacionit ndikim të madh patën çmimet e produkteve ushqimore për shkak të peshës së madhe të tyre në shportën e konsumatorit.

Sektori financiar vazhdoi të jetë stabil dhe i qëndrueshëm, përkundër rritjes më të ngadalshme se në vitin paraprak. Institucionet financiare edhe më tej ofrojnë shërbime financiare tradicionale, ndërsa mungojnë instrumentet financiare më të sofistikuara. Bankat komerciale aktivitetin e tyre kreditor e mbështesin në depozitat e mbledhura në vend.

Në sistemin bankar të Kosovës edhe më tej ekziston një shkallë e lartë e koncentrimit, edhe pse në vitin 2011 është shënuar një rënie e pjesëmarrjes së bankave më të mëdha në treg. Vizioni i BQK-së për sektorin financiar është ruajtja e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare nën drejtimin e forcave të tregut, por duke vepruar në kuadër të rregullativës prudente dhe kornizës së politikës së mbikëqyrjes që është e harmonizuar me direktivat e BE-së dhe KE-së.

Strategjia e BQK-së është tërheqja e investitorëve që kanë gjendje të mirë financiare dhe që mund të sjellin një vlerë të shtuar në tregun e Kosovës, duke ndihmuar kështu në forcimin e mëtejshëm të sektorit financiar, rritjen e mëtejme të besueshmërisë, rritjen e konkurrencës dhe zvogëlimin e kostos së financimit.

Bashkëpunimi i ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën Qendrore Evropiane, si dhe Bankat Qendrore dhe Autoritetet Rregullative të vendeve të

tjera ka vazhduar edhe në vitin 2011, duke e rritur kredibilitetin e BQK-së në arenën ndërkombëtare.

Prof.Dr.Gazmend Luboteni

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ky Raport reflekton përmbylljen e punës me sukses të BQK-së në vitin 2011 duke u fokusuar në vlerësimet mbi zhvillimet financiare dhe ekonomike në vend përfshirë vlerësimet mbi punën dhe aktivitetet e BQK-së në përmbushjen e agjendës së saj ligjore.

BQK ka vazhduar edhe gjatë vitit që lamë pas të jetë faktor i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik në vend, para se gjithash duke siguruar një sektor financiar të qëndrueshëm dhe në shërbim të nevojave të ekonomisë.

Ruajtja e stabilitetit financiar në vend është pika më e rëndësishme në agjendën e aktiviteteve të BQK-së. Sektori financiar i Kosovës, në vitin 2011, krahas zgjerimit të tij ka reflektuar shëndet dhe stabilitet të fortë, ndërsa shikuar nga prizmi i sistemit bankar, Kosova sot radhitet ndër vendet me rritjen më të shpejtë të kreditimit në rajon dhe me nivelin më të ultë të kredive joperformuese si dhe niveli më të lartë të mbulueshmërisë me kapital. Sistemi bankar i Kosovës ka vazhduar të përkrahë ekonominë e vendit edhe në kohën kur ekonomia botërore, më konkretisht eurozona, po kalon nëpër telashe të rënda financiare dhe fiskale. E tëra kjo është realizuar pa rrezikuar në asnjë moment stabilitetin financiar dhe atë ekonomik në përgjithësi. Krahas qasjes së kujdesshme të BQK-së si dhe kujdesit nga ana e vetë institucioneve financiare, kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit financiar ka dhënë edhe performanca e mirë e sektorit real të ekonomisë, e karakterizuar me normë pozitive të rritjes ekonomike, përderisa presionet inflacioniste nuk kanë paraqitur rrezik serioz për stabilitetin financiar.

Krahas sistemit bankar, rritje të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë është shënuar edhe në pjesët tjera të sektorit financiar të Kosovës. Kështu, vlera e kontributeve në fondet pensionale ka vazhduar të rritet, e shoqëruar me normë pozitive të kthimit nga investimi i tyre. Industria e sigurimeve ka vazhduar të zgjerohet, duke rritur shtrirjen edhe në drejtim të sigurimeve vullnetare dhe sigurimin e jetës. Në vitin 2011 filluan së operuari edhe dy kompani të reja të sigurimit të jetës me kapital të huaj, që flet se kjo industri mbetet mjaft atraktive për investimet e huaja. Institucionet mikrofinanciare shënuan tkurrje të aktivitetit kreditor si rezultat i vështirësive në sigurimin e fondeve adekuate të financimit nga tregjet e jashtme financiare. Struktura e tregut në të gjitha sferat përbërëse të sektorit financiar të Kosovës ka vazhduar të karakterizohet me rënie të shkallës së koncentrimit, duke reflektuar kështu një rritje të vazhdueshme të konkurrencës. Funksionimi adekuat i sistemit të pagesave, krahas kontributit në rritjen e efiçiencës së institucioneve financiare, ka pasur rol prijës edhe në zhvillimin e produkteve të reja financiare në treg.

Gjatë vitit 2011 BQK ishte aktive edhe në ndërmarrjen e masave të nevojshme për të fuqizuar kapacitetet për ruajtjen e stabilitetit dhe nxitjen e zhvillimit të sektorit financiar. Ka vazhduar puna në avancimin e legjislacionit financiar si dhe në ndërtimin e institucioneve ruajtëse dhe nxitëse të zhvillimit të sektorit financiar. Themelimi i Fondit për Sigurimin e Depozitave, pastaj themelimi i Byrosës Kosovare të Sigurimit si dhe kompletimi i Platformës për tregtimin elektronik të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës e radhisin vitin 2011 në mesin e viteve historike për sektorin financiar të vendit. Në këtë kontekst, vlen nënvizuar edhe rritjen e bashkëpunimit

ndërkombëtar me institucione homologe, në veçanti nënshkrimin e Marrëveshjes së mirëkuptimit me Rregullatorin e sistemit bankar të Gjermanisë (BaFin).

Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të personelit gjë që ka rezultuar me pranim ndërkombëtar të aftësive teknike e profesionale të punonjësve të BQK-së të cilët kanë filluar me dhënien e asistencës teknike në bankat qendrore të vendeve të ndryshme të botës.

Lidhur me pikëpamjen për vitin 2012, duhet theksuar se zhvillimet aktuale në eurozonë thërrasin për një qasje edhe më të kujdesshme të institucioneve financiare, posaçërisht atyre bankare, në menaxhimin e profilit të rrezikut financiar. Sidoqoftë, niveli aktual i qëndrueshmërisë së sektorit financiar bashkë me parashikimet për normë pozitive të rritjes ekonomike, na bëjnë të besojmë se, edhe në vitin 2012, stabiliteti financiar do të vazhdojë të jetë i fuqishëm dhe kontribues i rëndësishëm në stabilitetin makroekonomik të vendit. Kjo aq më tepër kur kihet parasysh se krahas rregullores së aprovuar për mbështetje me likuiditet, ligji i ri mbi bankat dhe institucionet tjera financiare që pritet të miratohet në vitin 2012 bashkë me projektin e avancimit të politikave prudenciale do të fuqizojnë edhe më shumë kapacitetin licencues, rregullues dhe mbikëqyrës të BQK-së. Padyshim, edhe Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar i dakorduar të realizohet në vjeshtën e 2012-së do të kontribuojë dukshëm në drejtim të avancimit të mëtejmë të sektorit financiar të vendit tonë, ndërsa asistenca rezidenciale e këshilltarëve të Departamentit të Thesarit Amerikan do të reflektohet në konsolidimin më cilësor të industrisë së sigurimeve, në zhvillimin e politikës dhe strategjisë kombëtare për tregun hipotekar si dhe në aktivizimin dhe zhvillimin e tregut primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, projektet e lartcekura do të kontribuojnë në thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit efektiv dhe efikas ndërinstitucional në vendin tonë.

Në mbyllje, duhet nënvizuar se i tërë ky raport është refleksion i përkushtimit të lartë të punonjësve të BQK-së dhe organeve të saja vendimmarrëse në drejtim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së institucionit tonë.

Gani Gërguri

Guvernator

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit

Aktiviteti i Bordit të Bankës Qendrore

Me qëllim të përmbushjes së suksesshme të politikave dhe kompetencave të përcaktuara sipas legjislacioneve në fuqi, Bordi i Bankës Qendrore, gjatë vitit 2011, ka mbajtur 14 mbledhje.

Për përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësive që ka Bordi i Bankës Qendrore gjatë këtij viti aktiviteti i Bordit i Bankës Qendrore është përqendruar në vazhdimësi në:

- miratimin e Rregulloreve, si në vijim;
  - Rregulloren për Plotësimin e Rregullës bankare XVI;
  - Rregulloren mbi Statistikat Monetare -Financiare dhe Llogaritë Financiare;
  - Rregulloren mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare;
  - Rregulloren mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave;
  - Rregulloren për mbështetje emergjente për Likuiditet; dhe
  - Rregulloren mbi depozitimin e aseteve si garancë, mjaftueshmerisë së kapitalit, raportim financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetin.
- miratimin e buxhetit vjetor të BQK-së;
- miratimin e raporteve periodike bashkë me gjendjen financiare të BQK-së;
- miratimin e organizimit të BQK-së;
- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;
- shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të përmbushjes së stabilitetit financiar; dhe
- çështje të tjera që janë në kompetencën e Bordit të Bankës Qendrore.

Me 31 dhjetor 2011 Bordi i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Gazmend Luboteni, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Gani Gërguri, Guvernator dhe anëtar i Bordit të Bankës Qendrore;

Zilif Lufi, Drejtor i Thesarit (anëtar i Bordit të Bankës Qendrore);

Sejdi Rexhepi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore;

Mejdi Bektashi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore.

Bordi Ekzekutiv

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 34 pika 3 Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori (kryesues i Bordit Ekzekutiv) dhe dy Zëvendësguvernatorët.

Kompetancat dhe detyrat e Bordit Ekzekutiv janë përcaktuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2011, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka mbajtur 23 takime.

Më 31 dhjetor 2011 Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Gani Gërguri (Guvernator/Kryesues i Bordit Ekzekutiv), Nexhat Kryeziu (Zëvëndësguvernator për Mbikëqyrjen e Institucioneve Financiare) dhe Lulzim Ismajli (Zëvendësguvernator për Operacione Bankare).

Sekretar i Bordit Ekzekutiv gjatë vitit 2011 ishte Flamur Mrasori (Shef i Kabinetit të Guvernatorit).

Komiteti i Auditimit

Komiteti i auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhët prej tre anëtarëve (dy anëtarë joekzekutivë të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar - ekspert i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).

Më 31 dhjetor të vitit 2011, Komiteti i Auditimit përbëhej nga këta anëtarë:

Gazmend Luboteni, kryetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Sejdi Rexhepi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore;

Arben Dërmaku, anëtar i jashtëm.

Struktura organizative e BQK-së: 31 dhjetor 2011



1. Përmbledhje ekzekutive

Pasiguritë nga vitet paraprake vazhduan të jenë të pranishme në ekonominë globale edhe gjatë vitit 2011. Pasiguritë ishin më të theksuara në ekonominë e eurozonës e cila në vitin 2011 shënoi rritje, por me ritëm më të ngadalësuar se sa në vitin paraprak. Kontribuues në rritjen ekonomike të eurozonës ishin kryesisht eksportet, ndërsa problemet rreth financave publike në disa vende të eurozonës vazhduan të jenë burimi kryesor i pasigurisë. Rritje ekonomike gjatë vitit 2011 shënuan edhe vendet e Evropës Juglindore (EJL), në mesin e të cilave rritjen më të lartë e regjistroi Kosova. Shumica e vendeve të EJL-së gjatë vitit 2011 u treguan të kujdesshme që të reduktojnë deficitin buxhetor, pavarësisht faktit që niveli i borxhit publik në vendet e EJL-së është i moderuar. Viti 2011 u karakterizua me norma më të larta të inflacionit, burim kryesor i të cilave ishte çmimi i energjisë dhe ushqimit. Si rezultat i zhvillimeve në eurozonë dhe EJL, u vërejt ngadalësim i rritjes së kredisë si dhe përkeqësim i cilësisë së portofolit kreditor në këto vende. Në kuadër të vendeve të EJL-së, Kosova vazhdon të jetë njëra ndër shtetet me rritjen më të lartë të kredisë dhe cilësinë më të mirë të portofolit kreditor.

Përkundër gjendjes së brishtë në sektorin e jashtëm, ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2011 vazhdoi të zgjerohet, duke shënuar një normë reale të rritjes prej rreth 5 përqind. Bartës kryesor i rritjes ekonomike në vend ishte sektori privat përmes rritjes së konsumit dhe investimeve, ndërsa rol të rëndësishëm kishin edhe investimet e sektorit publik. Rritja e çmimeve në nivel global u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës, ku norma mesatare e inflacionit për vitin 2011 arriti në 7.3 përqind. Shkaktarët kryesor të rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve ishin rritja e çmimeve për produktet ushqimore dhe derivatet e naftës, produkte këto që kryesisht importohen. Ekonomia e Kosovës vazhdon të karakterizohet me shkallë të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse, që po shkaktohet kryesisht nga deficiti tregtar. Niveli relativisht i ulët i eksportit të mallrave dhe vlera e lartë e importit bënë që në vitin 2011 deficiti tregtar të arrijë vlerën prej rreth 2.2 miliardë euro. Për dallim nga tregtia e mallrave, bilanci i tregtisë në shërbimeve është karakterizuar me bilanc pozitiv duke parandaluar kështu thellimin e mëtejmë të deficitit. Kontribut të rëndësishëm në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse vazhdojnë të japin edhe transferet nga jashtë e posaçërisht dërgesat e emigrantëve. Në kuadër të llogarisë kapitale dhe financiare, kategoria kryesore vazhdon të përbëhet nga investimet e huaja direkte, të cilat në vitit 2011 shënuan rritje vjetore prej 14.4 përqind.

Performanca relativisht pozitive e sektorit real të ekonomisë ndihmoi edhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar, i cili gjatë vitit 2011 vazhdoi të rrisë aktivitetin dhe të ruaj qëndrueshmërinë. Asetet e sektorit financiar në fund të vitit 2011 arritën vlerën prej 3.5 miliardë euro që paraqet rritje vjetore prej 9.3 përqind. Sistemi bankar vazhdon të dominojë asetet e sektorit financiar me pjesëmarrje prej 76.3 përqind në gjithsej asetet. Aktiviteti i sistemit bankar vazhdon të jetë i koncentruar në kreditimin e ekonomisë vendore, përderisa burimi kryesor i financimit për bankat në Kosovë mbeten depozitat e mbledhura brenda vendit. Në vitin 2011, kreditë e lëshuara nga sistemi bankar shënuan rritje vjetore prej 16.4 përqind, duke arritur në vlerën prej 1.7 miliardë euro. Rritje vazhduan të shënojnë edhe depozitat në sistemin bankar të cilat në vitin 2011 arritën vlerën prej 2.1 miliardë, që paraqet rritje vjetore prej 8.5 përqind. Sistemi bankar i Kosovës ka vazhduar të ruaj nivelin e lartë të qëndrueshmërisë, duke u karakterizuar me shkallë të lartë të kapitalizimit, cilësi të mirë të portofolit kreditor dhe pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të vitit 2011 qëndroi në 17.5 përqind, që paraqet nivel të kënaqshëm të kapitalizimit dhe tejkalon kërkesat rregullative.

Pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e lëshuara nga sistemi bankar në fund të vitit 2011 u zvogëlua në 5.7 përqind nga 5.9 përqind sa ishte në vitin 2010. Për më tepër, shkalla e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizionet për humbje nga kreditë në vitin 2011 ishte 116.7 përqind, që paraqet një nivel mjaft të kënaqshëm të mbulueshmërisë. Sistemi bankar i Kosovës vazhdoi të ruajë gjendjen e likuiditetit, me një raport kredi – depozita prej rreth 80 përqind dhe pjesëmarrje të kënaqshme të aseteve likuide në gjithsej asetet e sistemit bankar.

Gjatë vitit 2011, numri i kompanive të sigurimit që operuan ne Kosove ishte trembëdhjetë (13) ku dhjetë (10) prej tyre janë kompani Jo Jetë. Struktura e pronësisë vazhdon te dominohet nga kompanitë me kapital të huaj. Gjatë vitit 2011 bruto primi i shkruar shënoi rritje ne krahasim me vitin paraprak për 4% dhe pjesën me te madhe te portfolios së përgjithshme të bruto primeve të shkruara e zë produkti i sigurimeve nga auto përgjegjësia. Sistemi Pensional në përkundër luhatjeve të mëdha në tregjet financiare botërore ishte i qëndrueshëm dhe realizoi kthim pozitiv nga investimet e mjeteve konform zhvillimeve në tregjet financiare globale. Gjatë vitit 2011, nuk kishe licencim dhe të bankave të reja, ndërsa u licencuan dy kompani të reja të sigurimit jetësor si dhe dy institucione mikrofinanciare.

Në vitin 2011 ka hyrë ne fuqi Ligjit Nr. 04/L-018 Mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit, në shtator të vitit 2011, BQK-ja në bashkëpunim me industrinë e sigurimeve dhe akterët tjerë relevant themeluan Byronë Kosovare të Sigurimeve (BKS). Aktiviteti ligjor i BQK-së ka qenë i orientuar në draftimin/amendamentimin e ligjeve që rregullojnë në tërësi sektorin financiar (Draftimi i Ligjit për Sigurimet e Përgjithshme, për Bankat, për Sistemin e Pagesave, amendamentimi i Ligjit për Fondet Pensionale si dhe draftimi/amendamentimi i legjislacionit sekondar (ndryshimi i rregullave ekzistuese dhe nxjerrja e rregulloreve konform nevojave rregullative që kërkoheshin më anë të Ligjeve përkatëse).

Funksioni i BQK-së për sigurimin e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi është përmbyllur suksesshëm. Sistemi Ndërbankar i Pagesave ka shënuar rritje si në vëllim ashtu edhe në vlerë të pagesave, me rreth 4.2 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 5.1 miliardë euro. Gjithashtu, sistemi i pagesave në këtë vit është karakterizuar me zhvillime të reja si në aspektin ligjor ashtu edhe teknik. Vlen të theksohet zhvillimi i modulit për shlyerje të letrave me vlerë të Qeverisë në kuadër të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar të BQK-së. Përkundër luhatjeve në tregjet globale, e veçanërisht tregjet e eurozonës, BQK realizoi investimet e mjeteve konform ligjit mbi BQK-në dhe politikës e investimeve të BQK-së. Rrjedhimisht, norma e kthimit në investimet e BQK-së ishte pozitive. Njëkohësisht është kompletuar infrastruktura ligjore dhe teknike për funksionimin e tregut të brendshëm të letrave më vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Bashkëpunimi ndërkombëtar kryesisht është zhvilluar në dy drejtime që tani për tani mund të themi se janë bërë tradicionale. Së pari, në drejtim të implementimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura më parë më institucionet simotra dhe autoritetet tjera të mbikëqyrjes financiare dhe, së dyti, në drejtim të zgjerimit të bashkëpunimit dhe lidhjes së marrëveshjeve të reja me institucionet gjegjëse të vendeve tjera si marrëveshja me Autoriteti Federal për Mbikëqyrje Financiare në Gjermani (BaFin). Përveç kësaj, BQK është përfaqësuar edhe në evenimente më rëndësi regjionale, evropiane dhe ndërkombëtare përfshirë këtu pjesëmarrjen e rregullt në takimet vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik[1]

Në vitin 2011 ekonomia e eurozonës shënoi rritje reale prej 1.3 përqind krahasuar me rritjen prej 1.6 përqind në vitin 2010. Rimëkëmbja e ekonomisë botërore ka vazhduar të kontribuojë në rritjen e eksporteve të eurozonës, duke mbështetur kështu rritjen e aktivitetit ekonomik në këto vende. Kontribut në rritjen ekonomike të vendeve të eurozonës ka dhenë edhe kërkesa e brendshme. Ndërsa, ndikim negativ në aktivitetin ekonomik në eurozonë kishin problemet me borxhin shtetëror si dhe rënia e besimit të bizneseve.

Si rrjedhojë e krizës së fundit financiare, ekonomia e eurozonës gjatë vitit 2011 u përball me krizën në sektorin fiskal ku deficiti buxhetor kishte shënuar rritje të vazhdueshme. Megjithatë, masat e ndërmarra për shtrëngimin e shpenzimeve buxhetore bënë që raporti ndërmjet deficitit buxhetor dhe PBB-së në vitin 2011 të zvogëlohet në 4.1 përqind që është për 2.1 pp më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Edhe pse ka pasur përmirësim në menaxhimin e financave publike, paqëndrueshmëria fiskale vazhdon të jetë një nga sfidat kyçe për disa nga vendet e eurozonës. Niveli i borxhit publik prej 8.2 trilion euro në vendet e eurozonës shënoi rritje prej 5.0 përqind krahasuar me vitin paraprak, duke arritur në 87.2 përqind të PBB-së (85.3 përqind e PBB-së në vitin 2010). Greqia, Portugalia dhe Irlanda vazhdojnë të jenë vendet me problemet më të theksuara në financimin e borxhit shtetëror.

Bazuar në të dhënat në dispozicion për vendet e Evropës Juglindore (EJL), rimëkëmbja e ekonomike gjatë vitit 2011 paraqitet e moderuar. Kosova shënoi normën më të lartë të rritjes me 5.0 përqind, pasuar nga Maqedonia me 3.2 përqind. Po ashtu, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, dhe Serbia regjistruan rritje të PBB-së me normë reale prej 3.0, 2.7, 2.4, dhe 1.6 përqind, respektivisht. Rritja e vazhdueshme e eksporteve vlerësohet të ketë qenë kontribuuesi kryesor në rritjen e aktivitetit ekonomik në këto vende. Edhe në vendet e EJL-së masat e ndërmarra për shtrëngimin e shpenzimeve buxhetore bënë që raporti ndërmjet deficitit buxhetor dhe PBB-së në vitin 2011 të shënojë rënie të lehtë, nga 3.4 përqind sa ishte në vitin 2010 në 3.0 përqind në vitin 2011. Përveç Shqipërisë dhe Serbisë që thelluan deficitin buxhetor për 0.4 respektivisht 0.1 pp, të gjitha vendet tjera të EJL-së e reduktuan atë. Edhe përkundër rënies së deficitit buxhetor, niveli i borxhit publik ka shënuar një rritje të lehtë prej 0.6 pp dhe ka arritur mesataren prej 33.5 përqind të PBB-së për vendet e EJL-së.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga FMN-ja, raporti ndërmjet deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe PBB-së në vendet e eurozonës është zvogëluar në 0.8 përqind që është për 0.4 pp më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Ky zvogëlim i deficitit ka ardhur si rezultat i rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve për 9.9 respektivisht 1.9 përqind. Ndërsa, bazuar në të dhënat e Komisionit Evropian, në vendet e EJL-së deficiti i llogarisë rrjedhëse në raport me PBB-në është rritur për 0.5 pp dhe ka arritur nivelin prej 11.3 përqind. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse ka ardhur si rezultat i rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve, të cilat në vitin 2011 arritën në 61.5 përqind të PBB-së (58.7 përqind në vitin 2010).

Shkalla e papunësisë në vendet e eurozonës në fund të vitit 2011 ishte 10.2 përqind, që paraqet një ngritje të lehtë prej 0.1 pp krahasuar me vitin paraprak. Norma e papunësisë në vendet e eurozonës ka shënuar rritje përkundër rritjes së aktivitetit ekonomik. Zhvillime të ngjashme kanë karakterizuar edhe tregun e punës në vendet e EJL-së. Në

[1] International Monetary Fund (2011): Regional Economic Outlook, European Central Bank (2011): Monthly Bulletin, European Commision (2011): EU Candidates and Pre-Accession Countries; Economic Quarterly, Business Monitor International (2011) Emerging Europe Monitor.

vitin 2011, shkalla e papunësisë në Kroaci arriti në 13.2 përqind (rritje vjetore prej 1.4 pp), në Serbi arriti në 24.4 përqind (rritje vjetore prej 4.4 pp), si dhe në Bosnje e Hercegovinë arriti në 27.6 përqind (rritje vjetore prej 0.4pp).

Sipas të dhënave të publikuara nga EUROSTAT-i, në dhjetor 2011, ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit në vendet e eurozonës ishte 2.7 përqind, që është për 0.5 pp më i lartë në krahasim me dhjetor 2010. Rritja e çmimeve të energjisë (11.9 përqind) dhe produkteve ushqimore (2.3 përqind) ishin kontribuuesit kryesor për rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Me qëllim të ruajtjes së stabiliteti të çmimeve, Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank: ECB) ngriti normën bazë të interesit në prill dhe korrik 2011 me nga 25 pikë bazë, pasi e kishte mbajtur atë në nivele shumë të ulëta për gati dy vjet. Mirëpo, gjatë tremujorit të katërt 2011 ECB sërish zvogëloi normën bazë të interesit për 50 pikë bazë. Së pari, në nëntor 2011, ECB-ja vendosi ta zvogëlojë normën bazë të interesit nga 1.50 përqind në 1.25 përqind, ndërsa, pastaj në dhjetor 2011 ndërmori edhe një hap tjetër të zvogëlimit të normës bazë të interesit duke sjellur atë nga 1.25 në 1.0 përqind. Ky zvogëlim i normës bazë të interesit erdhi për shkak të intensifikimit të tensioneve në tregjet financiare, të shtyra kryesisht nga zhvillimet e financave publike në disa vende të eurozonës. Rritja e çmimeve të energjisë dhe produkteve ushqimore u reflektua edhe në nivelin e çmimeve në vendet e EJL-së, ku norma mesatare e inflacionit në vitin 2011 arriti në 4.0 përqind (2.4 përqind në vitin 2010). Serbia dhe Kosova raportuan normën më të lartë të inflacionit (11.1 përkatësisht 7.3 përqind), ndërkaq Kroacia regjistroi normën më të ulët të inflacionit (2.3 përqind).

Rreziqet ndaj stabilitetit financiar të eurozonës janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2011, për shkak të përkeqësimit të krizës së borxheve dhe ndikimin që këto rreziqe kanë pasur në sistemin bankar. Ritmi i zgjerimit monetar ka vazhduar të jetë i moderuar gjatë vitit 2011. Rritja e agregatit monetar M3 ishte 1.5 përqind gjatë viti 2011 e që krahasuar me vitin 2010 ishte për 0.2 pp më i ulët. Rritja vjetore e kredive për ekonomitë familjare ishte 1.6 përqind e që krahasuar me vitin 2010 është për 1.3 pp më e ulët. Ndërsa, kishte përmirësim sa i përket kredive ndaj korporatave jofinanciare të cilat shënuan rritje vjetore prej 1.2 përqind krahasuar me vitin 2010 kur kishte ngecje në rritjen e këtyre kredive. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 2.3 përqind që është për 0.1 pp më e ulët krahasuar me vitin 2010. Edhe depozitat e korporatave jofinanciare shënuan rritje prej 0.1 përqind, mirëpo krahasuar me vitin 2010 kjo rritje ishte dukshëm më e ulët (3.7 pp). Zhvillime të ngjashme kanë karakterizuar edhe sektorin bankar në vendet e EJL-së. Rritja mesatare e kredive të sektorët bankar të vendeve të EJL-së ishte 6.4 përqind që është për 1.6 pp më e ulët krahasuar me vitin 2010. Kosova shënoi normën më të lartë të rritjes së kredive prej 16.4 përqind, pasuar nga Shqipëria dhe Maqedonia me 11.7 respektivisht 8.1 përqind. Mali i Zi sikurse edhe në vitin 2010 pati rënie të aktivitetit kreditor me 11.1 përqind. Sektorët bankar të vendeve të EJL-së regjistruan rritje më të ngadalësuar të depozitave gjatë vitit 2011, me një normë mesatare të rritjes prej 7.9 përqind (9.5% në vitin 2010). Shqipëria regjistroi normën më të lartë të rritjes së depozitave prej 14.5 përqind, pasuar nga Maqedonia (10.9 përqind), Serbia (9.2 përqind), Kosova (8.5 përqind), etj. Norma mesatare e kredive joperformuese në vendet e EJL-së është përkeqësuar dhe ka arritur në 13.1 përqind apo 1.6 pp më keq se sa në vitin paraprak. Serbia kryeson me shkallën më të lartë të kredive joperformuese (19.0 përqind), ndërsa Kosova ka nivelin më të ulët të kredive joperformuese me pjesëmarrje prej 5.8 përqind në gjithsej kreditë.

Gjatë vitit 2011, euro u zhvlerësua ndaj shumicës së valutave kryesore botërore, ku zhvlerësimin më të theksuar e regjistroi ndaj frankës zvicerane me 4.1 përqind (1.23 SFR/EUR), pastaj ndaj dollarit amerikan me 1.65 përqind (1.32 USD/EUR), si dhe ndaj funtës britanike me 0.7 përqind (0.84 GBR/EUR). Po ashtu, valuta euro u zhvlerësua edhe

ndaj pjesës më të madhe të valutave të vendeve të EJL-së. Gjatë vitit 2011, euro u zhvlerësua ndaj dinarit serb (1.4 përqind) dhe denarit maqedonas (0.7 përqind), ndërsa u vlerësua ndaj kunës kroate (1.8 përqind) dhe lekut shqiptar (1.2 përqind)

3. Ekonomia e Kosovës

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2011 vazhdoi të shënojë normë pozitive të rritjes ekonomike përkundër sfidave të shkaktuara nga luhatjet në ekonominë globale dhe sidomos në atë evropiane. Aktiviteti ekonomik në vend karakterizohet me stabilitet kur merren parasysh burimet kryesore të financimit shumica e të cilave kanë treguar performancë të mirë (Figura 1). Sidoqoftë, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në disa prej vendeve të eurozonës rezultoi në ngadalësim të eksporteve të mallrave, rritja e të cilave gjatë vitit 2011 ishte vetëm 6.3 përqind. Në anën tjetër, dërgesat e emigrantëve gjatë vitit 2011 u karakterizuan me stabilitet, duke vazhduar të jenë një ndër komponentët e rëndësishëm në financimin e konsumit në vend. Zgjerimi i vazhdueshëm i aktivitetit të sektorit bankar paraqet gjithashtu një burim shumë të rëndësishëm për financimin e aktivitetit ekonomik në Kosovë. Aktiviteti kredidhënës i sistemit bankar vazhdoi të ketë normë dyshifrore të rritjes. Rritja e vazhdueshme e kreditimit dhe depozitave vazhdon të paraqesë sinjal të favorshëm për sa i përket shkallës së stabilitetit të ekonomisë së vendit në përgjithësi dhe të sistemit bankar në veçanti. Sektori publik gjithashtu vazhdon të ketë rol pozitiv në stabilitetin e ekonomisë së vendit si në kuadër të të hyrave ashtu edhe në kuadër të shpenzimeve buxhetore.

Figura 1. Harta Makroekonomike



Burimi: BQK, MF, ASK (2012)

Ekonomia e Kosovës vazhdon të karakterizohet me normë të lartë të papunësisë e cila paraqet sfidën kryesore për stabilitetin ekonomik dhe social në vend. Normat e rritjes ekonomike në vitet e fundit nuk po arrijnë të absorbojnë fuqinë punëtore në vend e cila vazhdimisht karakterizohet me rritje si rezultat i strukturës së re të popullsisë. Mbështjetja e lartë e ekonomisë së Kosovës në importin e mallrave vazhdon të ketë kontribut negativ në normën e rritjes si dhe në deficitin e llogarisë rrjedhëse. Kjo sidomos vazhdon të shkaktohet nga rritja më e shpejtë e importeve krahasuar me rritjen e eksporteve. Presionet inflacioniste gjatë vitit 2011 vazhduan të jenë të pranishme në ekonominë e vendit. Presionet inflacioniste ishin më të shprehura në pjesën e parë të vitit, ndërsa ishin më të moderuara në pjesën e dytë të vitit 2011.

3.1. Sektori real

3.1.1. Produkti i brendshëm bruto[2]

Produktit i Brendshëm Bruto (PBB) i Kosovës shënoi rritje reale prej 5 përqind në vitin 2011 (4.0 përqind në vitin 2010). Në terma nominal, PBB tejkaloi shumën prej 4.7 miliardë euro. Rritja ekonomike gjatë vitit 2011 u nxit nga rritja e vazhdueshme e konsumit privat dhe rritja e investimeve, përfshirë investimet private edhe ato publike.

Figura 2. Rritja reale e PBB-së



Burimi: BQK dhe ASK (2012)

Gjatë vitit 2011 konsumi privat shënoi rritje vjetore prej mbi 10 përqind, ndërsa pjesëmarrja e tij vazhdon të jetë në mbi 90 përqind të PBB-së. Kreditë e sistemit bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë burim i rëndësishëm financimi për konsumin privat. Në vitin 2011, kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 17.7 përqind. Një burim tjetër i rëndësishëm i financimit për konsumin e ekonomive familjare vazhdojnë të jenë dërgesat e emigrantëve. Në vitin 2011, vlera e dërgesave të emigrantëve ishte 584.8 milionë euro, ndërsa, pjesa më e madhe e këtyre dërgesave përdoren për financim të konsumit të ekonomive familjare. Në anën tjetër, konsumi publik gjatë vitit 2011 nuk regjistroi ndonjë ndryshim të rëndësishëm krahasuar me vitin e kaluar, duke mbajtur pjesëmarrjen në PBB në rreth 15 përqind.

Investimet gjithashtu shënuan rritje si përqindje e PBB-së duke arritur në rreth 35 përqind, pjesa më e madhe e të cilave përbëhet nga investimet e sektorit privat që shënuan rritje prej mbi 20 përqind në vitin 2011. Ndër burimet kryesore të financimit të aktivitetit investiv në vend janë edhe kreditë e sistemit bankar dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD). IHD-të në vitin 2011 u karakterizuan me rritje relativisht të shpejtë duke arritur në 414.0 milionë euro, që paraqet një rritje prej 14.5 përqind krahasuar me vitin paraprak. Kreditë e sistemit bankar për ndërmarrjet shënuan rritje për 12.7 përqind në vitin 2011, duke i kontribuar kështu aktivitetit investiv të sektorit privat. Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve në vend gjatë vitit 2011 kishin edhe investimet e sektorit publik të cilat gjatë vitit 2011 u karakterizuan me trend pozitiv të rritjes, të orientuara në projekte infrastrukturore.

Kontribut negativ në rritjen e PBB-së në Kosovë vazhdon të ketë deficiti tregtar, i cili gjatë vitit 2011 u karakterizua me bilanc negativ prej -40 përqind të PBB-së. Tregtia në mallra vazhdimisht konsiderohet si shkaktar kryesor i këtij deficiti, marrë parasysh nivelin e lartë të importeve (prej 2.4 miliardë euro) dhe nivelin relativisht të ulët të eksporteve (312.5 milionë euro). Sidoqoftë, bilanci i tregtisë së shërbimeve e kompenson deri në një masë deficitin e lartë në tregtinë e mallrave, marrë parasysh se në tregtinë e shërbimeve Kosova ka bilanc pozitiv. Si rezultat i bilancit tregtar negativ, viti 2011 u karakterizua me nivelin më të thellë të deficitit të llogarisë rrjedhëse, i cili arriti në afër 25 përqind të PBB-së.

[2] Burimi i të dhënave për PBB-në është Fondi Monetar Ndërkombëtar, World Economic Outlook, shtator 2011.

PBB për kokë banori në Kosovë vazhdon të jetë në nivelin më të ulët krahasuar me vendet rajonale. PBB për kokë banori në Kosovë është rreth 2,700 euro, ndërsa para Kosovës radhiten Maqedonia me 3600 euro, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia me PBB për kokë banori prej mbi 4,000 euro. Sidoqoftë, dallimi në PBB nuk është kaq i lartë kur krahasohen të dhënat me PBB për kokë banori sipas paritetit të fuqisë blerëse (*angl. Purchasing Power Parity: PPP*). Në këtë aspekt, ekonomia e Kosovës nuk ka dallim të lartë me vendet tjera rajonale. PBB për kokë banori sipas PPP në Kosovë është mbi 7000 USD, që është në nivel të ngjashëm me vendet si Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina, por në nivel më të ulët në krahasim me vendet si Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia të cilat kanë PBB për kokë banori sipas PPP-së më të lartë se 10000 USD.[3]

3.1.2. Çmimet

Bazuar në indeksin e çmimeve të konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*), inflacioni në Kosovë shënoi një normë mesatare prej 7.3 përqind në vitin 2011. Krahasar dhjetorin e vitit 2011 me dhjetorin e vitit 2010, norma mesatare e inflacionit ishte 3.5 përqind. Kjo tregon se presionet inflacioniste në vend ishin më të theksuara gjatë pjesës së parë të vitit, sidomos në produktet ushqimore dhe çmimet e derivateve të naftës. Burim kryesor i presioneve inflacioniste vazhdojnë të jenë çmimet e produkteve të importuara të cilat reflektojnë çmimet në ekonominë globale.

Figura 3. Indeksi i çmimit të konsumit, importit dhe prodhimit



Burimi: ASK (2012)

Ndikimi i madh i çmimeve të produkteve ushqimore në nivelin e përgjithshëm të inflacionit vjen kryesisht si rezultat i peshës së madhe të këtyre produkteve në shportën e konsumatorit në Kosovë. Rreth 43 përqind e shportës së konsumatorit në Kosovë përbëhet nga produktet ushqimore dhe pijet. Sidoqoftë, pesha e kësaj kategorie në shportën e konsumatorit ka shënuar rënie të vazhdueshme. Në gjysmën e dytë të vitit, çmimet e produkteve ushqimore kontribuuan negativisht në gjithsej CPI-në si rezultat i rënies së çmimeve të kësaj kategorie. Ndër kontribuuesit më me peshë në gjysmën e dytë të vitit 2011 në CPI ishte kategoria që përfshinë banimin, energjinë elektrike, ujin, gazin dhe lëndët tjera djegëse (Figura 4).

Figura 4. Kontributi i komponentëve të CPI në inflacion vjetor



Burimi: ASK (2012); Kalkulimet e BQK-së

[3] Burimi i të dhënave është FMN, me kalkulime shtesë të BQK-së

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë në masë të madhe shkaktohen nga lëvizjet e çmimeve të mallrave të importuara si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së vendit në importin e mallrave nga jashtë. Në vitin 2011, norma mesatare vjetore e rritjes së Indeksit të Çmimeve të Importeve (*angl. Imports Price Index*: *IPI*) ishte mbi 10 përqind. Ndikimi i çmimeve të prodhimit (*angl. Producer Price Index: PPI*) në çmimet e konsumit mbetet më i ulët në krahasim me çmimet e importit. Rritja e çmimeve të prodhimit gjatë kësaj periudhe ishte 7.3 përqind.

3.1.3 Tregu i punës

Anketa e Fuqisë punëtore për herë të fundit është realizuar në vitin 2009 dhe, si pasojë e kësaj, nuk ka shifër zyrtare rreth normës së papunësisë për vitin 2010 dhe 2011. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të ESK-së, të vitit 2009, norma e papunësisë në Kosovë ishte 45 përqind[4] dhe si e tillë paraqet sfidën më të vështirë për ekonominë e Kosovës. Gjatë vitit 2011, punësimi në Kosovë mund të ketë shënuar rritje, mirëpo rritja e vazhdueshme e fuqisë punëtore e bënë më të vështirë zvogëlimin e normës së papunësisë. Rritja e fuqisë punëtore në Kosovë vjen si rezultat i strukturës së popullsisë marrë parasysh se grupmoshat e reja përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së vendit. Struktura e popullsisë në Kosovë dominohet në masë të madhe nga grupi të cilët janë në moshë pune. Grupmosha prej 15-64 vjet përbën 65 përqind të gjithsej popullsisë. Grupmoshat nën moshën 15 vjeçare përbëjnë 28 përqind të popullsisë ndërsa më të vjetër se 65 vjet janë 7 përqind e popullsisë.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), numri i punëkërkuesve aktiv të regjistruar në MPMS në fund të vitit 2011 ishte 325,261 punëkërkues të regjistruar. Kjo paraqet rënie prej 3 përqind në numrin e punëkërkuesve krahasuar me fundin e vitit 2010.

Numri i punëkërkuesve të rinjë të regjistruar në krahasim me vitin 2010 shënoi rritje të lehtë për 1 përqind apo 20,125 punëkërkues të rinj. Gjatë vitit 2011, është rritur numri i të punësuarve me ndërmjetësimin e MPMS-së. Vendet të lira të punës të paraqitura në MPMS gjatë vitit 2012 arritën në 9,776 që njëkohësisht paraqet nivelin më të lartë deri më tani. Përmbushja e këtyre vendeve të punës gjatë vitit 2011 ishte 76.5 përqind si rezultat i punësimit të 7,484 punëkërkuesve.

Struktura e punëkërkuesve dominohet nga punëkërkues të pakualifikuar (61.7 e gjithsej punëkërkuesve) përcjellë nga punëkërkuesit me kualifikim të mesëm (36.5 përqind), ndërsa pjesa tjetër prej 1.8 përqind janë me kualifikim të lartë.

Problematike për tregun e punës në Kosovë mbetet edhe karakteri afatgjatë i papunësisë. Mbi 90 përqind e të gjithë punëkërkuesve të regjistruar në Kosovë konsiderohet se janë të papunë për një periudhë më të gjatë kohore se 12 muaj. Efektet e papunësisë afatgjatë në kapitalin njerëzor konsiderohen negative kur merret parasysh se mund të ndikojnë negativisht në motivimin për kërkim të vendeve të punës por edhe në zhvlerësimin e kapitalit njerëzor dhe produktivitetit.

3.2. Sektori fiskal

Buxheti i Kosovës në vitin 2011 u përmbyll me deficit prej 84.5 milionë euro, krahasuar me 93.3 milionë euro deficit në vitin 2010 (9.4 përqind më i ulët se në vitin 2010). Raporti ndërmjet deficitit buxhetor dhe PBB-së ishte 1.8 përqind. Deficiti buxhetor në Kosovë gjatë

[4] Në mungesë të të dhënave për vitet 2010 dhe 2011, statistikat e tregut të punës janë paraqitur duke u bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore të vitit 2009.

vitit 2011 ishte në nivel më të ulët se niveli i planifikuar. Kjo për shkak se niveli i të hyrave rezultoi më i lartë se sa niveli i planifikuar (realizimi i të hyrave ishte 101.0 përqind e nivelit të planifikuar), përderisa shpenzimet nuk arritën të realizohen në nivelin e planifikuar (realizimi i shpenzimeve ishte 91.9 përqind e nivelit të planifikuar).

3.2.1 Të hyrat buxhetore

Të hyrat buxhetore, duke mos përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve dhe fondet në mirëbesim, ishin 1.30 miliardë euro, apo për 10.6 përqind më të larta se sa në vitin 2010. Raporti i të hyrave buxhetore dhe PBB-së arriti në 27.7 përqind, që paraqet nivel më të ulët se sa mesatarja e rajonit në vitin 2010 (37.0 përqind).

Figura 5. Burimet kryesore të të hyrave kufitare, në milionë euro



Burimi: Ministria e Financave (2012)

Të hyrat e mbledhura në kufi vazhdojnë të dominojnë strukturën e të hyrave buxhetore, të cilat përfaqësuan 63.4 përqind të gjithsej të hyrave në vitin 2011. Të hyrat të mbledhura nga tatimet në kufi arritën vlerën prej 826.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.2 përqind. Në rritjen e të hyrave kufitare ka ndikuar kryesisht rritja e importeve si dhe çmimeve të importit për disa produkte, sidomos ato ushqimore dhe karburantet. Norma nominale e rritjes së importeve në vitin 2011 ishte 15.6 përqind. Në kuadër të tatimeve të mbledhura në kufi, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) përbën kategorinë më të madhe (50.7 përqind), e cila arriti vlerën prej 418.8 milionë euro (Figura 5). TVSH-ja e mbledhur në kufi, edhe pse shënoi rritje vjetore prej 16.1 përqind, në strukturën e të hyrave kufitare u karakterizua me zvogëlim të pjesëmarrjes për 0.9pp. Kategoria e dytë për nga rëndësia e të hyrave kufitare janë të hyrat e mbledhura nga akciza (34.4 përqind), e cila arriti vlerën prej 284.4 milionë euro, që është për 22.4 përqind më e lartë krahasuar me vitin 2010. Të hyrat e mbledhura nga akciza në cigare u rritën për 9.0 milion euro duke kontribuuar me 3.9pp në rritjen e gjithsej të hyrave nga akciza. Një kategori tjetër e rëndësishme e të hyrave kufitare është taksa doganore, e cila arriti vlerën prej 121.0 milionë euro apo 14.6 përqind e gjithsej të hyrave të mbledhura në kufi. Krahasuar me vitin 2010, të hyrat nga taksa doganore shënuan rritje prej 16.5 përqind. Të hyrat tjera të cilat kryesisht vijnë nga shitja e mallrave të konfiskuara, kundërvajtjet, banderollat, etj. kishin nivel pothuajse të njëjtë me vitin 2010, prej 2.4 milion euro apo 0.3 përqind e gjithsej të hyrave kufitare.

Figura 6. Burimet kryesore të të hyrave nga tatimet vendore, në milionë euro



Burimi: Ministria e Financave (2012)

Të hyrat nga tatimet vendore arritën vlerën prej 231.4 milionë euro (rritje vjetore prej 19.1 përqind). Në kuadër të tatimeve vendore, pjesa më e madhe përbëhet nga TVSH e mbledhur brenda vendit (40.8 përqind e gjithsej të hyrave nga tatimet vendore), që në vitin

2011 arriti vlerën neto prej 94.3 milionë euro (Figura 6). Në krahasim me vitin 2010, të hyrat nga TVSH e mbledhur brenda vendit shënuan rritje vjetore prej 38.7 përqind. Kategori tjetër e rëndësishme në kuadër të tatimeve vendore janë të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale (kryesisht tatimi në paga) të cilat arritën vlerën neto prej 55.5 milionë euro (24.0 përqind e gjithsej të hyrave vendore), duke shënuar rritje vjetore prej 25.4 përqind. Të hyrat nga tatimi i korporatave arritën vlerën neto prej 52.4 milionë euro (22.7 përqind e gjithsej të hyrave vendore), duke shënuar rritje vjetore prej 1.0 përqind. Të hyrat nga bizneset individuale arritën vlerën prej 23.4 milionë euro (10.1 përqind e gjithsej të hyrave vendore), duke shënuar kështu rënie vjetore prej 8.1 përqind. Kategoritë tjera të tatimeve vendore me pjesëmarrje më të ulët në gjithsej të hyrat vendore, si: tatimi i paragjykuar, tatimi në fitim, tatimi në interes, dividentë, të drejta pronësore, qira, dhe lojëra të fatit, të hyrat nga gjobat e ATK-së, licenca për lojëra, arritën vlerën prej 5.7 milion euro nga 4.6 milionë euro sa ishin në vitin 2010.

Të hyrat vetanake shënuan vlerën prej 115.5 milionë euro (8.9 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore), që paraqet një rritje vjetore prej 15.0 përqind. Struktura e të hyrave vetanake përbëhet nga të hyrat në nivel qendror dhe të hyrat në komuna. Në vitin 2011, nga niveli qendror u mblodhën 59.9 milionë euro ndërsa nga komunat u mblodhën 55.6 milionë euro në buxhetin e Kosovës. Sa i përket të hyrave të njëhershme, respektivisht transferimit të dividentës në buxhetin e Kosovës, në vitin 2011 shuma e këtyre të hyrave ishte 60.0 milionë euro (dividenta e PTK-së 55.0 milionë euro dhe dividenta e Aeroportit 5.0 milionë euro), krahasuar me 85.0 milionë euro të transferuara në vitin 2010. Të hyrat tjera[5] ishin 69.8 milionë eruo, duke shënuar rënje vjetore prej 29.8 përqind.

3.2.2 Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet buxhetore në vitin 2011, duke mos përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet në mirëbesim, ishin 1.39 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind, që paraqet një rritje më të lartë në krahasim me rritjen e vitit paraprak (3.2 përqind). Shpenzimet buxhetore përbënin 29.5 përqind të PBB-së, që paraqet pjesëmarrje më të ulët në krahasim me mesataren e rajonit (41.0 përqind të PBB-së në vitin 2010). Shpenzimet buxhetore të dedikuara për konsum ishin 11.5 përqind e PBB-së, ndërsa investimet kapitale ishin 11.2 përqind e PBB-së.[6]

Në vitin 2011 shpenzimet kapitale absorbuan pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 38.1 përqind në gjithsej shpenzimet. Shpenzimet kapitale arritën vlerën prej 528.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 16.0 përqind (Figura 7). Pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale gjatë vitit 2011 kishte për destinim investimet në infrastrukturë (65.4 përqind të shpenzimeve kapitale), të cilat në masën më të madhe përbëhen prej investimeve në autostradën Morinë-Merdarë, që filloi të ndërtohet në prill të

Figura 7. Struktura e kategorive kryesore të shpenzimeve buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF (2012)

[5] Grantet për mbështetjen e buxhetit, interesi bankar, huamarrjet, etj.

[6] Në shpenzimet për konsum bëjnë pjesë pagat e mëditjet dhe mallrat e shërbimet, ndërsa në investime bëjnë pjesë shpenzimet kapitale.

vitit 2010. Kategoria e dytë për nga madhësia ishin pagat dhe mëditjet, të cilat arritën vlerën prej 385.0 milionë euro (27.7 përqind të gjithsej shpenzimeve). Pagat dhe mëditjet përfaqësojnë kategorinë që ka shënuar rritjen më të lartë në kuadër të shpenzimeve buxhetore, duke shënuar normë vjetore të rritjes prej 23.6 përqind. Subvencionet dhe transferet ishin kategoria e tretë me radhë për nga madhësia, me pjesëmarrje prej 18.5 përqind në gjithsej shpenzimet buxhetore. Subvencionet dhe transferet në vitin 2011 arritën vlerën prej 256.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 1.4 përqind, ndërsa në vitin 2010 kjo kategori e shpenzimeve ishte zvogëluar për 1.6 përqind. Disa nga kategoritë krysore në kuadër të subvencioneve dhe transfereve që shënuan rritje janë subvencionet për ndërmarrjet publike të cilat u rritën nga 56.4 milionë euro sa ishin në vitin 2010, në 60.5 milionë euro në vitin 2011, pagesat për invalidët e luftës dhe familjet e viktimave të luftës të cilat arritën vlerën prej 29.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 24.3 përqind. Ndërsa, pensionet bazë, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të subvencioneve dhe transfereve, u zvogëluan nga 95.0 milionë euro sa ishin në vitin 2010, në 93.5 milionë euro në vitin 2011.

Kategoria me pjesëmarrjen më të vogël në kuadër të shpenzimeve buxhetore ishte kategoria e mallrave dhe shërbimeve, e cila shënoi vlerën prej 156.6 milionë euro (11.3 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore) dhe shënoi rënie vjetore prej 3.7 përqind. Rënia e shpenzimeve për mallra dhe shërbime erdhi kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes e riparimit[7], shërbimeve kontraktuese[8], dhe shpenzimeve të marketingut. Në kuadër të shpenzimeve tjera, huazimet për KEK-un ishin 30.0 milionë euro, shërbimet komunale 20.4 milionë euro, dhe pagesat për borxhin e jashtëm ishin 11.5 milionë euro.

3.3. Sektori financiar

3.3.1 Karakteristikat e përgjithshme

Sektori financiar i Kosovës gjatë vitit 2011 vazhdoi të zgjerojë aktivitetin dhe në të njëjtën kohë vazhdoi të ruaj qëndrueshmërinë në të gjithë sistemet përbërës të tij. Vlera e gjithsej aseteve të sektorit financiar në fund të vitit 2011 arriti në 3.5 miliard euro, që paraqet një rritje prej vjetore prej 9.3 përqind. Krahasuar me rritjen vjetore prej 15.1 përqind të realizuar në vitin 2010, vërehet se asetet e sektorit financiar gjatë vitit 2011 kanë ndjekur një ritëm më të ngadalshëm të rritjes.

Rritja më e ngadalshme e sektorit financiar kryesisht është rezultat i rritjes më të ngadalshme të aseteve të sistemit bankar (8.3 përqind krahasuar me rritjen prej 11.4 përqind të vitit 2010), i cili paraqet komponentin kryesor të sektorit financiar të Kosovës. Në ngadalësimin e rritjes së gjithsej aseteve të sektorit ka kontribuuar edhe zvogëlimi i aseteve të institucioneve tjera financiare (institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë). Vlera e aseteve të institucioneve tjera financiare zbriti në 128.3 milionë euro në vitin 2011, nga 145 milionë euro sa ishte në vitin 2010. Kjo rënie në asete kryesisht u shkaktua nga ngadalësimi i aktivitetit kredidhënës të këtyre institucioneve që për shkak kryesor kishte vështirësimin e kushteve të financimit nga tregjet e jashtme të cilat paraqesin burimin kryesor të financimit të tyre. Ndërsa, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimit vazhduan të zgjerojnë aktivitetin e tyre, duke kontribuar kështu edhe në rritjen e gjithsej aseteve të sektorit financiar. Në vitin 2011, vlera e aseteve të fondeve pensionale

[7] Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore, mirëmbajtja e TI-së, mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve, etj.

[8] Shërbimet e arsimimit dhe trajnimit, avokaturës, shërbimet e ndryshme shëndetësore, shërbimet kështilldhënëse, shërbimet për shtypje, mirëmbajtje e softëverit, kompansimi për vendimet gjyqësore, etj.

shënoi një rritje vjetore prej 20.2 përqind dhe arriti në 593.3 milionë euro, përderisa vlera e aseteve të kompanive të sigurimit arriti në 106 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.4 përqind.

Aktiviteti i institucioneve financiare në Kosovë vazhdon të mbështetet kryesisht në ofrimin e shërbimeve financiare tradicionale, përderisa instrumentet më të sofistikuara financiare ende nuk kanë zënë vend në sektorin financiar të vendit. Bankat komerciale vazhdojnë të kenë kreditimin e ekonomisë vendore si aktivitetin e tyre kryesor, i cili aktivitet financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda vendit. Në industrinë e sigurimeve, sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së tretë (angl. Third Party Liability: TPL) mbetet veprimtaria kryesore, prej së cilës edhe gjenerohet pjesa më e madhe e primeve të pranuara. Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të kenë kredidhënien si aktivitetin e tyre kryesor, të financuar kryesisht prej fondeve të huazuara nga institucione financiare që operojnë jashtë Kosovës, përderisa nuk e kanë të drejtën e pranimit të depozitave.

Figura 8. Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2012)

Struktura e aseteve të sistemit financiar të Kosovës në vitin 2011 nuk regjistroi ndonjë ndryshim të rëndësishëm për sa i përket pjesëmarrjes së sektorëve përbërës të këtij sistemi. Bankat komerciale vazhduan të përfaqësojnë pjesëmarrësin kryesor në sektorin financiar, duke menaxhuar 76.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Vërehet një rritje e pjesëmarrjes së fondeve pensionale, të cilat në fund të vitit 2011 menaxhuan 17.0 përqind të aseteve të sektorit financiar, krahasuar me 15.4 përqind në 2010. Ndërsa, është regjistruar zvogëlim i pjesëmarrjes së institucioneve tjera financiare dhe ndihmësve financiar (Figura 8). Rënie e theksuar vërehet posaçërisht në pjesëmarrjen e ndihmësve financiar, të cilët nga një normë edhe ashtu të ulët të pjesëmarrjes prej 0.2 përqind në vitin 2010, zbritën në vetëm 0.02 përqind në vitin 2011.

Ndryshime nuk vërehen as për sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë. Sektori financiar i Kosovës numëron gjithsej 101 institucione financiare, numrin më të madh të të cilave e përbëjnë institucionet mikrofinanciare (20) dhe ndihmësit financiarë (58), por që pesha e tyre në tërësinë e aseteve të sektorit financiar është mjaft e ulët (Figura 8). Numri i bankave komerciale që operojnë në Kosovë edhe në vitin 2011 ishte tetë (8) dhe poashtu i pandryshuar mbeti edhe numri i fondeve pensionale që vazhdoi të jetë dy (2). Lëvizje për sa i përket numrit të institucioneve financiare gjatë vitit 2011 janë vërejtur në industrinë e sigurimeve, ku në fund të vitit 2011 kanë filluar të operojnë edhe dy kompani të sigurimeve, duke ngritur numrin e kompanive të sigurimeve që operojnë në Kosovë në 13. Marrë në përgjithësi, vërehet se përkundër performancës së mirë të treguar në vazhdimësi nga sektori financiar i Kosovës, hyrja e institucioneve të reja financiare në vitet e fundit ka qenë mjaft e pakët. Kësaj situate sigurisht se në masë të madhe i kanë kontribuar vështirësitë ekonomike dhe financiare që po vazhdojnë të jenë të pranishme në shtetet e zhvilluara e posaçërisht ato evropiane. Këto vështirësi janë reflektuar edhe në performancën e investitorëve potencial, duke ndikuar kështu kapacitetet dhe interesimin e tyre për të shtrirë aktivitetin në tregje të reja.

Sektori financiar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të ulët të shfrytëzimit të financimit nga jashtë Kosovës, përderisa një pjesë e konsiderueshme e aseteve të këtij sektori vazhdon të jetë e investuar në tregjet e jashtme.[9] Vlera e Aseteve të Jashtme Neto (AJN) vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2011, mirëpo rritja ishte më e ngadalshme krahasuar me vitin 2010. Në fund të 2011, vlera e AJN-ve ishte 2.08 miliardë euro (Figura 9), që paraqet një rritje vjetore prej 6.2 përqind (15.1 përqind në vitin 2010). Pjesa më e madhe e AJN-ve të sektorit financiar janë asetet e BQK-së (52.8 përqind e gjithsej AJN-ve), përderisa pjesa tjetër ndahet mes bankave komerciale (25.0 përqind) dhe institucioneve tjera financiare (22.2 përqind) (Figura 10). Të vetmet institucione të cilat kanë shënuar bilanc negativ të AJN-ve janë institucionet mikrofinanciare, që do të thotë se më tepër huazojnë mjete nga jashtë se sa që plasojnë mjete në institucionet financiare jashtë vendit. Kjo për shkak se burimi kryesor i financimit për këto institucione janë linjat kreditore nga institucione financiare që operojnë jashtë Kosovës.

Figura 9. Kërkesat neto të sektorit financiar, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Rritja më e ngadalshme e AJN-ve të sektorit financiar është kryesisht rezultat i normës më të ulët të rritjes së kërkesave që kanë institucionet financiare që operojnë në Kosovë ndaj sektorit të jashtëm. Në vitin 2011, kërkesat ndaj sektorit të jashtëm shënuan rritje vjetore prej vetëm 2.7 përqin, (krahasuar me rritjen vjetore prej 17.3 përqind në vitin 2010. Prej 2.45 miliardë euro sa është vlera e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm, pjesa më e madhe janë të investuara në depozita (55.8 përqind), aksione dhe ekuitete tjera (21.7 përqind) dhe letra me vlerë (9.4 përqind). Nga figura 11 vërehet se gjatë vitit 2011 ka ndodhur një zhvendosje e investimeve nga letrat me vlerë drejtë aksioneve dhe ekuiteteve tjera. Kjo zhvendosje e mjeteve është bërë nga fondet pensionale që operojnë në Kosovë, të cilat investimet në sektorin e jashtëm në tërësi i koncentruan në aksione dhe ekuitete tjera. Ngjashëm, edhe BQK gjatë vitit 2011 ka zhvendosur një pjesë të theksuar të investimeve nga letrat me vlerë drejt investimeve në depozita, duke ndikuar që pjesëmarrja e investimeve në letra me vlerë të zvogëlohet dukshëm (Figura 11). Në vitin 2011, 85.9 përqind e kërkesave të BQK-së ndaj sektorit të jashtëm u përbënë nga investimet në depozita (68.5 përqind në dhjetor 2010) dhe vetëm 2.0 përqind u përbënë nga investimet në letra me vlerë (16.0 përqind në vitin 2010). Vetëm bankat komerciale ishin ato që zhvendosën një pjesë të vogël të mjeteve

Figura 10. Asetet e jashtme neto, sipas institucioneve (në milionë euro)



Burimi: BQK(2012)

[9] Në këtë rast, sektori financiar përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet financiare që operojnë në Republikën e Kosovës.

nga investimet në depozita në investime në letra me vlerë. Në vitin 2011, investimet në letra me vlerë përbënë 30 përqind të gjithsej mjeteve të inestuara jashtë vendit nga bankat komerciale që operojnë Kosovë (24.4 përqind në dhjetor 2010), përderisa investimet në depozita vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe me një pjesëmarrje prej 46 përqind (56.8 përqind në dhjetor 2010).

Figura 11. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm



Burimi: BQK (2012)

Detyrimet e sektorit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm në vitin 2011 shënuan rënie vjetore prej 13.1 përqind krahasuar me vitin 2010. Në vitin 2011, vlera e këtyre detyrimeve zbriti në 374 milionë euro nga 430.2 milionë euro një vit më herët. Kjo kryesisht për shkak të nivelit më të ulët të dy përbërësve kryesorë të këtyre detyrimeve, gjegjësisht kredive që institucionet financiare në Kosovë i pranojnë nga institucionet financiare që operojnë jashtë vendit (172.2 milionë euro në 2011 krahasuar me 205.8 milionë euro në 2010) dhe depozitave të jorezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë (65.6 milionë euro në 2011 krahasuar me 87.1 milionë euro në 2010). Struktura e detyrimeve të sektorit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm mbeti e ngjashme me vitin e kaluar (Figura 12). Kategoritë kryesore të këtyre detyrimeve mbeten kreditë e pranuara nga jashtë (46 përqind e gjithsej detyrimeve) dhe depozitat e jo-rezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë (17.5 përqind e detyrimeve). Llogaria e FMN-së dhe alokimi i të Drejtave Speciale të Tirazhit (DST) mbetën pothuajse të pandryshuara që nga viti 2009 kur edhe u nënshkrua marrëveshja e anëtarisimit në FMN. Bartësit kryesorë të detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm vazhdojnë të jenë bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare, si përfituesit e kredive të marra nga jashtë dhe si mbajtës të depozitave të jorezidentëve (jo institucionet mikrofinanciare).

Kërkesat e sektorit financiar ndaj sektorit të brendshëm vazhduan të rriten, duke arritur vlerën prej 990.6 milionë euro, apo rritje prej 33.4 përqind krahasuar me vitin 2010. Rritjes së kërkesave ndaj sektorit të brendshëm kryesisht i kontribuoi rritja e theksuar e kërkesave ndaj sektorit real (14.15 përqind) dhe niveli më i ulët i depozitave të qeverisë (për 3.2 përqind) – si përbërësit kryesorë të neto kërkesave. Neto kërkesat ndaj sektorit real vazhdojnë të kenë bilanc negativ (Figura 9), meqë detyrimet ndaj sektorit real (të cilat përbëhen nga depozitat në bankat komerciale, si dhe nga rezervat teknike të sigurimit) vazhdojnë të jenë më të larta se kërkesat e këtij sektori që kryesisht përbëhen nga kreditë e lëshuara nga institucionet

Figura 12. Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm



Burimi: BQK (2012)

financiare.

3.3.2. Sistemi bankar

Sistemi bankar i Kosovës edhe gjatë vitit 2011 vazhdoi të përbëhet nga tetë banka komerciale, prej të cilave gjashtë janë me pronësi të huaj dhe dy me pronësi vendore. Pjesëmarrja e lartë bankave të huaja reflektohet edhe në strukturën e gjithsej aseteve të sistemit bankar, ku 89 përqind e gjithsej aseteve përbëhet nga asetet e bankave të huaja, ndërsa pjesa e mbetur i takon dy bankave vendore. Edhe pse nuk ka pasur hyrje të bankave të reja në tregun bankar të Kosovës, në vitin 2011 megjithatë është regjistruar hyrje e kapitalit të ri nga jashtë në sistemin bankar të vendit, me ç'rast Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka blerë rreth 10 përqind të aksioneve në Bankën për Biznes (BPB), bankë kjo e cila dominohet nga pronësia vendore.

Struktura e tregut të sistemit bankar të Kosovës vazhdon të karakterizohet nga shkalla e lartë e koncentrimit, ku tri bankat më të mëdha menaxhojnë rreth 73 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar. Megjithatë, pjesëmarrja e tri bankave më të mëdha ka shënuar rënie krahasuar me vitin 2010 kur menaxhonin 77.4 përqind të gjithsej aseteve. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut bankar paraqitet edhe nga Indeksi Herfindahl-Hirschman (IHH), i cili paraqet një tregues të shkallës së koncentrimit të tregut. Në vitet e fundit vërehet rënie e vazhdueshme e vlerës së këtij indeksi si për asetet ashtu edhe për kreditë dhe depozitat e sistemit bankar. Në vitin 2011, shkalla e koncentrimit në të tri pozicionet ka shënuar nivel të barabartë prej rreth 2090 pikë të indeksit HHI (Figura 13). Koncentrimi i bankave tani më është i njëjtë në të tri pozicionet, përderisa në vitet e mëparshme vërehej një koncentrim më i madh i kredive dhe depozitave në krahasim me asetet. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut tregon për një intensifikim të aktivitetit të bankave më të vogla, duke bërë që të rriten presionet konkurruese në tregun bankar.

Figura 13. HHI për asete, kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2012)

Sa i përket infrastrukturës së sistemit bankar, numri i njësive operacionale (përfshirë zyrat kryesore, degët dhe nëndegët) në vitin 2011 ishte 310, një më pak se në fund të vitit 2010. Është evidente se bankat ekzistuese tani më kanë konsoliduar mjaft mirë rrjetin e njësive operacionale, meqë zgjerimi i theksuar i degëve dhe nëndegëve gjatë viteve të kaluara ka stagnuar gjatë vitit 2011. Ndërsa, numri i punëtorëve ka vazhduar të rritet, duke arritur në 3,728 punëtorë nga 3,610 sa ishin një vit më herët. Në të njëjtën kohë, ka vazhduar edhe trendi i zgjerimit të rrjetit të pikave të shitëse (angl. Point of Sales: POS), terminaleve,, bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe numrit të shfrytëzuesve të llogarive e-banking. Përpos zgjerimit të infrastrukturës fizike, edhe vlera e pagesave elektronike të kryera duke shfrytëzuar format e lartpërmendura është në rritje e sipër (Tabela 1). Përderisa gjatë vitit 2010 vlera e pagesa të kryera përmes e-banking shënoi shumën prej 782 milionë euro, gjatë vitit 2011 vlera e këtyre pagesave ishte 1.19 miliardë euro. Gjithashtu, shfrytëzimi i POS terminaleve (pikave të shitjes) ishte dukshëm më i lartë gjatë vitit 2011, kur vlera e pagesave të kryera përmes tyre ishte 142 milionë euro,

krahasuar me gjithsej 94 milionë euro në vitin 2010. Të gjithë këta indikatorë sygjerojnë se pagesat përmes parasë së gatshme janë duke u zvogëluar, duke i dhënë kështu përparësi pagesave elektronike.

Tabela 1. Pagesat elektronike, në miliona euro

Përshkrimi	2009	2010	2011
Tërheqjet e klientëve të bankave përmes ATM-ve	582.4	639.8	790.0
Pagesat e klientëve të bankave përmes POS-ve	68.4	94.3	142.4
Pagesat përmes e-banking	607.3	782.4	1191.8

Burimi: BQK (2012)

3.3.2.1 Bilanci i gjendjes i sistemit bankar

i. Asetet

Vlera e gjithsej aseteve të sistemit bankar të Kosovës në vitin 2011 arriti në 2.65 miliardë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 8.3 përqind (9.3 përqind në vitin 2010). Në raport me PBB-në, asetet e sistemit bankar arritën normën prej 57.2 përqind, krahasuar me normën prej 58.2 përqind në vitin 2010.

Figura 14. Kontributi në rritjen e aseteve të sistemit bankar sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Zgjerimi i aktivitetit të sistemit bankar, i shprehur nga rritja e aseteve, u realizua kryesisht përmes rritjes së kredidhënies dhe investimeve në letra me vlerë. Rritja e kredive dhe investimeve në letra me vlerë kontribuan me 9.8 përkatësisht 1.2pp në rritjen e gjithsej aseteve të sistemit bankar. Ndërsa, kontribut negativ në rritjen e gjithsej aseteve kishte bilanci me bankat komerciale, i cili kontribuoi me -4.1pp (Figura 14). Kontributi negativ i bilancit me bankat komerciale në rritjen e gjithsej aseteve vjen si rrjedhojë e zvogëlimit të plasmaneve të bankave që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit. Një pjesë e këtyre mjeteve mund të jetë orientuar drejt aktivitetit kredidhënës në vend si dhe investimeve në letra me vlerë jashtë vendit, kategori këto që kanë shënuar rritje gjatë vitit 2011. Kreditimi i ekonomisë vazhdon të jetë aktiviteti kryesor i sistemit bankar në vend. Kreditë, si kategoria dominuese në strukturën e aseteve të bankave komerciale, në vitin 2011, përfaqësuan 68.3 përqind të gjithsej aseteve të sistemt bankar, duke arritur vlerën prej 1.69 miliardë euro (1.45 miliardë në 2010). Në dy vitet e fundit, kreditimi i ekonomisë nga ana e bankave ka shënuar trend të përshpejtuar të rritjes krahasuar me vitin 2009 kur rritja e kredisë ishte ngadalësuar ndjeshëm. Kështu, norma vjetore e rritjes së kredive të sistemit bankar në vitet 2010 dhe 2011 ishte 13.3 përkatësisht 16.4 përqind, krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 8.9 përqind të shënuar në vitin 2009. Rritja e vazhdueshme e kreditimit nga

sistemi bankar mund të jetë indikator i rritjes së vazhdueshme ekonomike në vend si dhe rritjes së besimit të sistemit bankar kundrejt sektorit privat në ekonominë e Kosovës. Gjithashtu, bankat që operojnë në Kosovë kanë raportuar se gjatë vitit 2011 është rritur kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare, veçanërisht kërkesa e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.[10] Rritja e vazhdueshme e kreditimit nga bankat në Kosovë sigurisht që është edhe rezultat i strukturës së favorshme të financimit të bankave, ku burimi kryesor i financimit vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhura në Kosovë, të cilat po vazhdojnë të rriten.

Tabela 2. Struktura e aseteve të sistemit bankar

Përshkrimi	2008		2009		2010		2011	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	218.2	12.1%	322.7	14.6%	307.5	12.5%	331.5	12.5%
Bilanci me bankat komerciale	283.9	15.7%	405.6	18.4%	439.0	17.9%	339.4	12.8%
Letrat me vlerë	39.7	2.2%	97.0	4.4%	173.4	7.1%	202.0	7.6%
Kreditë dhe lizingu (bruto)	1,183.4	65.4%	1,289.0	58.5%	1,458.7	59.4%	1,698.1	63.8%
Asetet fikse	39.0	2.2%	43.1	2.0%	44.0	1.8%	47.4	1.8%
Asetet tjera	43.1	2.4%	46.7	2.1%	32.3	1.3%	41.4	1.6%
Gjithsej	1,808	100%	2,205	100%	2,455	100%	2,660	100%

Burimi: BQK (2011)

Figura 15. Rritja e aseteve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Gjatë vitit 2011 vërehet ngadalësim i trendit të investimeve të bankave kosovare në tregjet jashtë vendit. Rënie më e theksuar vërehet në bilancin e bankave komerciale që operojnë në Kosovë me bankat tjera jashtë vendit, që në vitin 2011 u zvogëlua për 22.7 përqind duke shënuar vlerën prej 339.4 milionë euro. Po ashtu, gjatë vitit 2011 vërehet një shkallë hezitimi te bankat komerciale për sa i përket zgjerimit të investimeve në letrat me vlerë në tregjet e jashtme. Në vitin 2011, investimet në letra me vlerë shënuan vlerën prej 202 milionë euro, duke shënuar një normë të rritjes prej 16.5 përqind e cila është dukshëm më e ulët se norma vjetore e rritjes prej 78.8 përqind që u regjistrua në vitin 2010 (Figura 15). Zvogëlimi i bilancit me bankat tjera si dhe ngadalësimi i rritjes së investimeve në letra me vlerë mund të ketë ndodhur si pasojë e rritjes së pasigurisë në disa ekonomi të Eurozonës si dhe rritjes së kreditimit të bankave në ekonominë vendore. Megjithë ngadalësimin e rritjes, pjesëmarrja e investimeve në letra me vlerë në gjithsej asetet e sistemit bankar u rrit në 7.6 përqind nga 7.1 përqind sa ishte në vitin 2010. Ndërsa, pjesëmarrja e bilancit me bankat komerciale në vitin 2011 u zvogëlua në 12.8 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar, krahasuar me 17.9 përqind sa ishte në vitin 2010.

[10] Anketa mbi Kreditimin Bankar e realizuar në baza tremujore nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

ii. Struktura e kredive

Kreditë për ekonomitë familjare vazhduan trendin rritës edhe gjatë vitit 2011, megjithatë me një normë më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar. Në vitin 2011, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 17.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 24.6 përqind në vitin 2010 (Figura 16). Në anën tjetër, trendi i kredive për ndërmarrjet tregon për një përshpejtim të rritjes së këtyre kredive në dy vitet e fundit (12.5 përqind në 2011 dhe 7.9 përqind në 2010, krahasuar me 4.8 përqind në 2009). Përkundër përshpejtimit të rritjes, norma e rritjes së kreditimit për ndërmarrjet vazhdon të jetë më e ulët se norma e rritjes së kredive për ekonomitë familjare. Kjo reflektohet edhe në strukturën e gjithsej kredive, ku vërehet një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së kredive për ekonomitë familjare dhe rënie e pjesëmarrjes së kredive për ndërmarrjet (Figura 17). Pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare në gjithsej kreditë e lëshuara nga sistemi bankar arriti në 30.1 përqind në fund të vitit 2011. Me gjithë këtë, kreditë për ndërmarrjet vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive, me një pjesëmarrje prej 69.9 përqind.

Figura 16. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 17. Struktura e kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik në vitin 2011 mbeti e ngjashme me vitet paraprake, ku 71.7 përqind e gjithsej kredive për ndërmarrjet u lëshuan për sektorin e shërbimeve. Nga gjithsej kreditë e lëshuara për ndërmarrjet, kreditë për ndërmarrjet tregtare, të cilat kategorizohen në kuadër të sektorit të shërbimeve, përfaqësuan 52.7 përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar. Kreditë për sektorin e industrisë, ku bëjnë pjesë minierat, prodhimtaria dhe ndërtimtaria, u përfaqësuan me 24.8 përqind në strukturën e gjithsej kredive (Figura 18).

Figura 18. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burmi: BQK (2012)

Ndërsa, kreditë për sektorin e bujqësisë ishin kreditë me pjesëmarrjen më të ulët prej 3.5 përqind në gjithsej kreditë. Pjesëmarrja e ulët e sektorit të bujqësisë në kreditë e lëshuara nga sistemi bankar ka qenë tradicionalisht e ulët që nga fillimi i operimit të sistemit bankar të Kosovës. Duke pasur parasysh vëllimin relativisht të ulët të kredive për këtë sektor dhe po ashtu normat më të larta të interesit për kreditë bujqësore mund të vlerësojmë se bankat kanë një dozë më të madhe pasigurie për sa i përket kreditimit të këtij sektori. Në anën tjetër, normat më të larta të interesit për këto kredi sigurisht se mund të dekurajojnë kërkesën për kredi bujqësore, duke parandaluar edhe më tej zgjerimin e këtyre kredive. Hezitimi i bankave për të zgjeruar kreditimin e sektorit të bujqësisë vërehet edhe nga fakti që rreth 90 përqind e gjithsej kredive për sektorin e bujqësisë në Kosovë është lëshuar vetëm nga njëra prej bankave që operojnë në vendin tonë.

Sa i përket trendit të rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, gjatë vitit 2011, përveç kredive për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime tjera, kreditë e të gjithë sektorëve tjerë shënuan rritje (Figura 19). Në vitin 2011, vlera e kredive për sektorin e tregtisë arriti në 606.2 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 16.3 përqind (13.6 përqind në vitin 2010). Në anën tjetër, kreditë për sektorin e ndërtimtarisë në vitin 2011 shënuan vlerën prej 116.3 milionë euro dhe u zvogëluan për 6.6 përqind (22.5 përqind rritje vjetore në vitin 2010). Kreditë për sektorin e bujqësisë arritën vlerën prej 40.5 milionë euro dhe kaluan nga rënia prej -0.1 përqind në vitin 2010, në rritje vjetore prej 6.1 përqind në vitin 2011. Ndërsa, kreditë e lëshuara për shërbimet tjera ishin kategoria e vetme nga gjithsej kreditë e lëshuara për ndërmarrje që shënuan rënie (rënie vjetore prej 12.1 përqind).

Figura 19. Norma vjetore e rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2012)

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku pjesën më të madhe e përbëjnë kreditë me afat më të gjatë maturimi. Në vitin 2011, kreditë me afat maturimi mbi dy vite deri në pesë vite përfaqësuan 41.98 përqind të gjithsej kredive, ndërsa kreditë me afat maturimi mbi pesë vite deri në dhjetë vite përfaqësuan 25.62 përqind të gjithsej kredive (Figura 20). Pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej kreditë kishin edhe kreditë me maturitet deri në një vit, të cilat përfaqësuan 21.09 përqind të gjithsej kredive. Ndërsa, pjesën e mbetur prej 7.19 përqind e përfaqësuan kreditë me maturitet mbi një vit deri në dy vite. Në vitin 2011 është vënë re rritje më e theksuar e kredive me maturitet deri në një vit (21.09 përqind) përderisa vërehet ngadalësim i rritjes së kredive me afat

Figura 20. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

maturimi mbi dy vite (Figura 21). Pjesëmarrje më të ulët në gjithsej kreditë vazhdimisht kanë përfaqësuar kreditë me afat maturimi mbi dhjetë vite, të cilat në vitin 2011 përbënin 3.69 përqind të gjithsej kredive. Pjesa e mbetur prej 0.43 përqind të gjithsej kredive janë kreditë në valuta joeuro. Norma vjetore e rritjes së kredive me afat maturimi mbi dy vite në vitin 2011 ishte 13.6 përqind, krahasuar me normën prej 19.3 përqind në vitin 2010. Nga kjo vërehet se mund të jetë e pranishme një shkallë hezitimi në anën e bankave për të zgjeruar kredidhënien me afat më të gjatë maturimi. Duke pasur parasysh që kreditë me afat më të gjatë maturimi mund të shfrytëzohen më tepër nga ndërmarrjet, atëhere e tërë kjo mund të flet për një shkallë pasigurie që mund të jetë e pranishme te bankat në raport me zhvillimet në sektorin real të ekonomisë. Kësaj pasigurie mund ti kenë kontribuar problemet ekonomike me të cilat po ballafaqohen disa nga vendet e eurozonës e të cilat në forma të ndryshme do të mund të reflektoheshin edhe në ekonomitë e vendeve tjera.

Figura 21. Norma e rritjes së kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

iii. Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sistemit bankar në vitin 2011 vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat njëherit paraqesin edhe burimin kryesor të financimit për bankat. Depozitat në vitin 2011 përfaqësuan 79 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar, pjesëmarrje kjo e ngjashme me atë të tri viteve paraprake (Tabela 3).

Tabela 3. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar

Përshkrimi	2008		2009		2010		2011	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	34.8	1.9%	58.5	2.7%	94.0	3.8%	40.0	1.5%
Depozitat	1,444.1	79.9%	1,744.8	79.2%	1,936.9	78.9%	2,102.3	79.0%
Huazimet tjera	0.0	0.0%	0.0	0.0%	0.0	0.0%	30.4	1.1%
Detyrimet tjera	140.2	7.8%	171.0	7.8%	160.0	6.5%	200.5	7.5%
Borxhi i ndërvarur	7.0	0.4%	24.4	1.1%	33.5	1.4%	31.0	1.2%
Mjetet vetanake	182.3	10.1%	205.6	9.3%	230.5	9.4%	255.3	9.6%
Gjithsej	1,808	100%	2,204	100%	2,455	100%	2,660	100%

Burimi: BQK (2012)

Në dhjetor të vitit 2011, vlera e depozitave arriti në 2.1 miliardë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 8.5 përqind, e cila megjithatë paraqet një normë më të ulët të rritjes krahasuar me normën vjetore prej 11 përqind të regjistruar në vitin 2010. Ngadalësimi i rritjes së depozitave në vitin 2011 kryesisht erdhi si pasojë e zvogëlimit të depozitave të korporatave publike jofinanciare si dhe rënies së depozitave të jorezidentëve.

Përveç depozitave, burim tjetër i rëndësishëm i financimit të bankave komerciale janë edhe mjetet vetanake të bankave, të cilat në vitin 2011 përfaqësuan 9.6 përqind të gjithsej detyrimeve. Mjetet vetanake në fund të vitit 2011 arritën vlerën prej 255.3 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 10.4 përqind. Borxhi i ndërvarur (angl. subordinated debt)

dhe bilanci nga bankat tjera, që për bankat që operojnë në Kosovë paraqesin burime të financimit nga tregjet e jashtme, në vitin 2011 shënuan rënie pas rritjes së vazhdueshme që patën shënuar në tri vitet paraprake. Borxhi i ndërvarur në vitin 2011 shënoi vlerën prej 31 milionë euro, duke u zvogëluar për 7.2 përqind krahasuar me vitin 2010, ndërsa bilanci nga bankat tjera jashtë vendit shënoi vlerën prej 40 milionë euro dhe u përgjysmua në krahasim me vitin 2010. Në anën tjetër, për herë të parë pas tri viteve vërehet se bankat si burim financimi kanë shfrytëzuar edhe huazimet tjera (linja kreditore nga institucione ndërkombëtare si EBRD, KfW, etj.), të cilat në vitin 2011 shënuan vlerën prej 30.4 milionë euro. Shfrytëzimi i këtij burimi të financimit deri diku mund të ketë shërbyer si zëvendësues i borxhit të ndërvarur dhe bilancit nga bankat tjera që shënuan rënie gjatë këtij viti. Borxhi i ndërvarur njihet si burim financimi me kosto më të lartë, andaj mund të jetë zëvendësuar me hua tjera të cilat mund të kenë kosto më të lirë për bankat. Po ashtu, një rritje mjaft e theksuar vërehet edhe në kategorinë e detyrimeve tjera, vlera e të cilave në vitin 2011 arriti në 200.5 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 25.3 përqind.

iv. Struktura e depozitave

Depozitat në sistemin bankar të Kosovës edhe në vitin 2011 u gjeneruan kryesisht nga ekonomitë familjare, depozitat e të cilave përbënë 71 përqind të gjithsej depozitave në sistemin bankar, duke rritur kështu pjesëmarrjen për 4pp krahasuar me vitin e kaluar (Figura 22). Depozitat e ekonomive familjare në vitin 2011 arritën vlerën prej 1.5 miliardë euro dhe shënuan një normë vjetore të rritjes prej 14.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 25 përqind në vitin 2010. Siç vërehet, depozitat e ekonomive familjare kanë rritur pjesëmarrjen në gjithsej depozitat përkundër rritjes me normë më të ulët në vitin 2011. Kjo rritje e pjesëmarrjes i atribuohet kryesisht zvogëlimit të disa nga kategoritë tjera të depozitave.

Figura 22. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Duke arritur shumën prej 509.3 milionë euro, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore prej 0.2 përqind. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve, në fund të vitit 2011, u dominua nga depozitat e ndërmarrjeve private (74.7 përqind të gjithsej depozitave të ndërmarrjeve). Depozitat e ndërmarrjeve private kaluan nga rritja prej 17.8 përqind në vitin 2010, në rënie prej 4.8 përqind në vitin 2011. Depozitat e ndërmarrjeve publike arritën vlerën prej 128.6 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 1.6 përqind. Ndërsa, si pjesëmarrje, depozitat e ndërmarrjeve publike nuk ndryshuan shumë në krahasim me vitin e kaluar (6.1 përqind të gjithsej depozitave), (Figura 22). Depozitat e qeverisë u zvogëluan nga 11.7 milionë në vitin 2010, në 2.7 milionë në vitin 2011. Po ashtu, depozitat e qeverisë zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat për 0.5pp (0.1 përqind e gjithsej depozitave në vitin 2011). Me rënie u karakterizuan edhe depozitat e jorezidentëve, të cilat në vitin 2011 përfaqësuan 3.1 përqind të gjithsej depozitave në sistemin bankar të Kosovës, krahasuar me 4.4 përqind në vitin 2010. Vlera e depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar të Kosovës në vitin 2011 ishte 64.2 milionë euro krahasuar me 84.8 milionë euro në vitin 2010.

Sa i përket afatit të maturimit, depozitat e sistemit bankar të Kosovës në vitin 2011 patën strukturë të ngjashme me vitet paraprake. Pjesëmarrjen më të lartë vazhdojnë ta kenë depozitat e afatizuara, të cilat në vitin 2011 përfaqësuan 50.3 përqind të gjithsej depozitave. Pjesa e mbetur e depozitave përbëhet nga depozitat e transferueshme dhe depozitat e kursimeve, të cilat në fund të vitit 2011 kishin pjesëmarrje prej 33.2 përqind, përkatësisht 16.6 përqind të gjithsej depozitave.

Figura 23. Struktura e depozitave të afatizuara sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Në vitin 2011, struktura e depozitave të afatizuara vazhdoi të dominohet nga depozitat me afat më të shkurtër maturimi, gjegjësisht prej depozitave me afat maturimi deri në një vit dhe depozitave me afat maturimi prej 1 deri në 2 vite. Megjithatë, ndryshe nga tri vitet e fundit kur depozitat me afat maturimi deri në një vit kishin pjesëmarrje prej rreth 80 përqind, në vitin 2011 pjesëmarrja e këtyre depozitave u zvogëlua në mënyrë të theksuar për 22pp (Figura 23). Depozitat me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite përfaqësuan 28 përqind të gjithsej depozitave dhe në krahasim me vitin e kaluar rritën pjesëmarrjen për 20pp. Rritja e pjesëmarrjes së këtyre depozitave erdhi si pasojë e riafatizimit të një pjese të depozitave të ekonomive familjare me afat maturimi deri në një vit në depozita me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite. Pjesa e mbetur e depozitave të sistemit bankar përbëhet nga depozitat me afat maturimi mbi dy vite, të cilat në vitin 2011 kishin pjesëmarrje prej 18 përqind (16 përqind në vitin 2010). Në përgjithësi, vërehet rritje e depozitave me afat më të gjatë maturimi e cila, mes tjerash, reflekton edhe rritjen e vazhdueshme të besimit të publikut në sistemin bankar të Kosovës. Rritjes së besimit të publikut në një masë mund ti ketë kontribuar edhe miratimi i ligjit dhe funksionalizimi i skemës për sigurimin e depozitave në korrik të vitit 2011.

Shikuar sipas valutës, depozitat në sistemin bankar të Kosovës dominohen nga depozitat në valutën euro, të cilat përfaqësojnë rreth 94 përqind të gjithsej depozitave. Duke pasur parasysh faktin se si asetet ashtu edhe detyrimet e sistemit bankar të Kosovës në masën dërmuese janë të denominuara në euro, mund të konsiderohet se bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë të ekspozuara minimalisht ndaj rrezikut nga norma e këmbimit.

3.3.2.2 Normat e interesit

Figura 24. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Viti 2011 u karakterizua me zvogëlim të normave të interesit si në depozita ashtu edhe në kredi. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita u zvogëlua nga 10.9pp sa ishtë në vitin 2010, në 10.6pp në vitin 2011. Me përmirësimin e mëtutjeshëm të ambientit të përgjithshëm për biznes dhe rritjes

së efikasitetit të bankave, pritet që normat e interesit në kreditë bankare të vazhdojnë të zvogëlohen. Norma mesatare e interesit në depozita për periudhën janar-dhjetor 2011 u zvogëlua në 3.5 përqind, krahasuar me 3.7 përqind sa ishte në periudhën janar-dhjetor 2010 (Figura 24). Ndërsa, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua nga 14.6 përqind sa ishte në periudhën janar-dhjetor 2010, në 14.1 përqind për periudhën janar-dhjetor 2011.

Në vitin 2011, norma mesatare e interesit për depozitat e ekonomive familjare dhe ato të ndërmarrjeve ishte e ngjashme. Norma mesatare më e lartë për depozitat e ndërmarrjeve në dhjetor 2011 ishte 5.25 përqind, dhe atë në depozitat me vlerë mbi 250 mijë euro dhe me afat maturimi mbi gjashtë muaj deri në një vit. Ndërsa, norma mesatare më e lartë në depozitat e ekonomive familjare në dhjetor të vitit 2011 ishte 5.36 përqind (depozitat me afat maturimi mbi dy vite). Në anën tjetër, norma mesatare më e lartë e interesit në kredi për ndërmarrje në dhjetor të vitit 2011 ishte 17.1 përqind, ndërsa norma më e lartë e interesit në kredi për ekonomi familjare ishte 16.4 përqind. Në kuadër të kredive për ndërmarrje, norma mesatare e interesit në kreditë investive u zvogëlua në 14.3 përqind krahasuar me mesataren prej 15.6 përqind në vitin 2010. Po ashtu, norma mesatare e interesit në kreditë tjera biznesore u zvogëlua në 16.5 përqind, krahasuar me normën mesatare të interesit prej 17.5 përqind në vitin 2010. Ndërsa, norma mesatare e interesit në mbitërheqje dhe linja kreditore mbeti e ngjashme me normat e vitit të kaluar, përkatësisht 12.1 përqind dhe 13.2 përqind.

3.3.2.3 Performanca e sistemit bankar

Sistemi bankar i Kosovës përmbylli vitin 2011 me profit neto prej 37.0 milionë euro, që është për 12.8 përqind më i lartë se sa profiti i regjistruar gjatë vitit 2010 (Figura 25). Rritja e nivelit të profitit kryesisht ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të hyrave të përgjithshme në krahasim me shpenzimet e përgjithshme të sistemit bankar. Në vitin 2011 norma e vjetore e rritjes së të hyrave të përgjithshme ishte 10.5 përqind, ndërsa norma e rritjes së shpenzimeve ishte 10.3 përqind (Figura 26).

Në dhjetor të vitit 2011, të hyrat e sistemit bankar shënuan vlerën prej 240 milionë euro, krahasuar me 217.2 milionë euro në dhjetor të vitit 2010. Norma më e lartë e rritjes së kreditimit të ekonomisë nga sistemit bankar u reflektua edhe në përshpejtimin e rritjes së të hyrave nga interesi, që njëherazi

Figura 25. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 26. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve



Burimi: BQK (2012)

përbëjnë edhe burimin kryesor të të hyrave për sistemin bankar (Figura 27). Të hyrat e përgjithshme nga interesi arritën në 195.0 milionë euro në vitin 2011, duke shënuar një rritje vjetore prej 11 përqind.

Figura 27. Struktura e të hyrave, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Struktura e të hyrave të përgjithshme të sistemit bankar vazhdon të dominohet prej të hyrave nga interesi në kredi edhe përkundër zvogëlimit të pjesëmarrjes në gjithsej të hyrat në 77.6 përqind nga 78.1 përqind sa ishin në dhjetor 2010 (Figura 28). Dominimi i vazhdueshëm i kësaj kategorie të të hyrave shpjegohet me faktin se sistemi financiar i Kosovës ende nuk është zhvilluar në nivel të mjaftueshëm sa për të ofruar instrumente financiare që do të mund të ndikonin në diversifikimin e strukturës së investimeve nga bankat dhe, rrjedhimisht, strukturën e të hyrave të tyre.

Figura 28. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Rritja e gjithsej të hyrave po ashtu u ndikua edhe nga niveli më i lartë i të hyrave nga interesi në plasmanet e bankave që operojnë në Kosovë te bankat jashtë vendit. Edhe pse vëllimi i plasmanëve jashtë vendit shënoi rënie në krahasim me vitin 2010, ngritja e vazhdueshme e normave të interesit në pjesën e parë të vitit 2011 u reflektua edhe në rritjen e të hyrave nga interesi në këto plasmane. Në dhjetor 2011, të hyrat nga kjo kategori arritën në 4.1 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 53.5 përqind krahasuar me vitin paraprak (Figura 29).

Figura 29. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2012)

Të hyrat e sistemit bankar gjatë vitit 2011 janë ndikuar pozitivisht edhe prej të hyrave nga investimet në letra me vlerë. Kjo kategori e të hyrave vazhdoi trendin rritës edhe gjatë periudhës në fjalë, duke arritur në 4.2 milionë euro apo një rritje prej 35.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Perfomanca më e mirë e e të hyrave nga investimet në letra me vlerë u ndikua së pari nga

rritja e vazhdueshme e mjeteve të investuara në letra me vlerë dhe, së dyti, rritja e kostos së financimit të borxhit shtetëror si dhe ngritja e premiumeve në letrat me vlerë si rezultat i krizës në eurozonë që ndikuan në rritjen e kthimit në këto investime.

Në kuadër të të hyrave të sistemit bankar zënë vend edhe të hyrat nga jo-interesi, të cilat në vitin 2011 shënuan vlerën prej 45.0 milionë euro (41.4 milionë euro në dhjetor 2010) dhe përfaqësuan 18.7 përqind të gjithsej të hyrave të sistemit bankar (Figura 29). Në kuadër të këtyre të hyrava, kategoria kryesore përbëhet nga tarifat dhe komisionet në produktet bankare. Në dhjetor 2011, të hyrat nga tarifat dhe komisionet përfaqësuan 17.4 përqind të gjithsej të hyrave, që paraqet një ngritje të lehtë prej 0.1 pp krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Figura 29). Kjo kategori e të hyrave në vitet e fundit ka shënuar rritje të pjesëmarrjes në gjithsej të hyrat e sistemit bankar si rrjedhojë e rritjes së gamës së shërbimeve nga ana e bankave.

Në dhjetor 2011, shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën prej 197.8 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.3 përqind. Trendi i rritjes së shpenzimeve të sistemit bankar u përshpejtua dukshëm në vitin 2011 në krahasim me normën e rritjes në vitin 2010 (4.3 përqind rritje vjetore). Përshpejtimi i rritjes ishte i pranishëm në pothuajse të gjithë zërat e shpenzimeve bankare. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme u ndikua edhe nga rritja aktivitetit të bankave gjatë vitit 2011. Prej kategorive kryesore të shpenzimeve mund të veçojmë rritjen e shpenzimeve për provizione për mbulimin e humbjeve potenciale nga kreditë. Rritja e shpenzimeve për provizione ishte si rrjedhojë e përkeqësimit të cilësisë së portofolit kreditor gjatë pjesës së parë të vitit 2011. Deri në qershor 2011, shpenzimet për provizione arritën në 19.7 milionë euro duke regjistruar një rritje të konsiderueshme prej 107.8 përqind krahasuar me qershorin e vitit 2010 (Figura 30). Mirëpo, në pjesën e dytë të vitit 2011 bankat u treguan më të kujdesshme në menaxhimin e rrezikut kreditor, ku si rrjedhojë norma e rritjes së shpenzimeve për provizione dukshëm u ngadalësua si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolit kreditor. Në fund të vitit 2011, shpenzimet për provizione arritën në 34.2 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 20.8 përqind. Shpenzimet për provizione raportohen në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, të cilat në vitin 2011 arritën vlerën prej 42.7 milionë euro apo për 18.3 përqind më të larta se sa në dhjetor të vitit 2010 (Figura 31).

Figura 30. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 31. Struktura e shpenzimeve e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Po ashtu, me rritje u karakterizuan edhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të sistemit bankar. Në fund të vitit 2011, siç shihet në figurën 31, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të sistemit bankar arritën në 96.7 milionë euro duke regjistruar një rritje vjetore prej 9.9 përqind. Rritja e kësaj kategorie të shpenzimeve kryesisht u bazua në rritjen e shpenzimeve për personel, të cilat shënuan vlerën prej 40.7 milionë euro apo për 7.7 përqind më të larta krahasuar me vitin paraprak. Rritja e shpenzimeve të personelit reflekton rritjen e numrit të punësuarëve në sistemin bankar gjatë vitit 2011. Gjithashtu, shpenzimet e tjera të jo-interesit shënuan rritje të theksuar, duke arritur në 22.5 milionë euro apo një rritje prej 78.4 përqind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, e vetmja kategori që regjistroi rënie në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative ishin shpenzimet për qiranë, të cilat u zvogëluan për 10.9 përqind dhe shënuan vlerën prej 33.5 milionë euro. Në figurën 31 janë paraqitur edhe shpenzimet e interesit të cilat shënuan një rritje vjetore prej 5.9 përqind, duke arritur në 58.4 milionë euro. Në kuadër të këtyre shpenzimeve mund të veçohet rritja e shpenzimeve për interesin në depozita dhe për interesin e paguar në huamarrje, të cilat u ngritën në 51.3 milion euro (49.4 milionë euro në dhjetor 2010) përkatësisht 5.6 milionë euro (4.8 milionë euro në dhjetor 2010).

Figura 32. Struktura e shpenzimeve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative vazhdojnë të jenë kategoria dominuese në kuadër të gjithsej shpenzimeve të sistemit bankar me pjesëmarrje prej 48.9 përqind (Figura 32). Kategoria e dytë e shpenzimeve të sistemit bankar për nga madhësia janë shpenzimet e interesit, të cilat gjatë kësaj periudhe zvogëluan pjesëmarrjen në 29.5 përqind të gjithsej shpenzimeve (30.8 përqind në dhjetor 2011). Ndërsa, pjesëmarrja e shpenzimeve të jo-interesit u ngrit në 21.6 përqind të gjithsej shpenzimeve (20.1 përqind në dhjetor 2011).

3.3.2.3.1 Profitabiliteti dhe Efikasiteti i sistemit bankar

Figura 33. Treguesit e profitabilitetit



Burimi: BQK (2012)

Ritja e profitit neto u reflektua edhe në përmirësimin e treguesit të profitabilitetit të sistemit bankar, siç është Kthimi Mesatar në Kapital (*angl. Return on Average Equity: ROAE*). Në vitin 2011, ROAE arriti në 15.3 përqind krahasuar me 14.8 përqind sa ishte në vitin 2010. Ndërsa, treguesi tjetër i profitbalitetit Kthimi Mesatar në Asete (*angl. Return on Average Assets: ROAA*), edhe përkundër rritjes së profitit neto, mbeti në nivelin e njëjtë me vitin e kaluar prej 1.5 përqind (Figura 33).

Rritja më e shpejtë e të hyrave krahasuar me shpenzimet ka rezultuar në një përmirësim të lehtë të treguesit të efikasitetit të sistemit bankar, që matet si raport ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave (Figura 34). Në dhjetor 2011, raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave u zvogëlua në 82.4 përqind nga 82.5 përqind sa ishte në dhjetor 2010. Trendi rënës i këtij indikatori ka filluar që nga viti 2010, kur ky tregues u zvogëlua në 82.5 përqind, nga niveli prej 84.6 përqind sa ishte në vitin 2009.

Figura 34. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

3.3.2.4 Rreziqet e sistemit bankar

i. Rreziku i likuiditetit

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me shkallë të kënaqëshme të likuiditetit, e cila bënë që detyrimet e bankave komerciale ndaj depozituesve dhe huadhënësve tjerë të kryhen me kohë dhe pa vështirësi. Shkalla e kënaqshme e likuiditetit në bankat komerciale që operojnë në vend është rezultat i menaxhimit të kujdesshëm të bilancit të gjendjes së bankave komerciale si në aspektin e aseteve ashtu edhe të detyrimeve.

Struktura e financimit të operacioneve për sistemin bankar të Kosovës në vitin 2011 ishte e ngjashme me atë të vitit të kaluar, ku depozitat e mbledhura brenda vendit vazhduan të përfaqësojnë kategorinë dominuese të detyrimeve si dhe burimin kryesor i financimit për aktivitetin e sistemit bankar në Kosovë. Në dhjetor 2011, depozitat përfaqësuan 79 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar. Koncentrimi i lartë i financimit të operacioneve bankare në depozita mund të paraqes një rrezik potencial për sistemin bankar të Kosovës, sepse një përkeqësim i situatës ekonomike në vend do të ndikonte negativisht në aftësinë e qytetarëve për të kursyer dhe, rrjedhimisht, bankat do të mund të hasnin vështirësi në sigurimin e fondeve për financimin e aktivitetit të tyre. Prandaj, është e rëndësisë së veçantë që bankat të mund të shfrytëzojnë edhe burime të tjera financimi, ku mund të theksohet nevoja e funksionalizmit të tregut ndërbankar të depozitave si dhe qasja në burimet e financimit jashtë vendit.

Figura 35. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Një indikator i rëndësishëm i shkallës së likuiditetit në sistemin bankar është raporti ndërmjet kredive dhe depozitave. Në dhjetor 2011, raporti kredi-depozita qëndroi në 80.8 përqind, përderisa në dhjetor 2010 ky raport ishte 75.3 përqind (Figura 35). Rritja e këtij treguesi reflekton rritjen më

të shpejtë të kredive në krahasim me rritjen e depozitave. Përkundër rritjes, raporti aktual ndërmjet kredive dhe depozitave mbetet në linjë me rekomandimet e BQK-së, që sugjerojnë që bankat komerciale që operojnë në Kosovë të mbajnë raportin kredi-depozita në mesatarisht 80 përqind.

Një tjetër tregues i rëndësishëm për shkallën e likuiditetit në sistemin bankar është raporti ndërmjet aseteve likuide dhe gjithsej aseteve. Në bazë të definicioneve të përdorura nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, asetet likuide ndahen në asete likuide "themelore" dhe asete likuide "gjithëpërfshirëse" (angl. core liquid assets dhe broad liquid assets).[11] Rritja më e shpejtë e nivelit të kredive është reflektuar edhe në zvogëlimin e pjesëmarrjes së aseteve likuide, si 'core' ashtu edhe 'broad', në gjithsej asetet. Në dhjetor 2011, pjesëmarrja e aseteve likuide 'core' në gjithsej asetet e sistemit bankar qëndroi në 26.6 përqind, krahasuar me 32.3 përqind sa ishin në dhjetor 2010. Ndërsa, pjesëmarrja e aseteve likuide 'broad' në gjithsej asetet arriti në 31.3 përqind krahasuar me 36.8 përqind sa ishin në dhjetor 2011. Rënia e këtyre dy indikatorëve kryesisht është reflektim i zvogëlimit nga ana e bankave e mjeteve të cilat investohen në formë të plasmanëve jashtë vendit, mjete të cilat në dhjetor 2011 ishin për rreth 100 milionë euro më të ulëta në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Me gjithë rënien, raporti aktual ndërmjet aseteve likuide dhe gjithsej aseteve siguron një pozicion të kënaqshëm të likuiditetit në sistemin bankar, mirëpo natyrisht bankat duhet të tregojnë kujdes të vazhdueshëm në parandalimin e devijimit të këtyre treguesve.

Tregues tjetër i rëndësishëm për shkallën e likuiditetit është raporti ndërmjet aseteve likuide dhe detyrimeve afatshkurtëra. Përmes këtij treguesi mund të vlerësohet aftësia e bankave për të plotësuar detyrimet që maturojnë brenda një afati të shkurtër kohor, me fjalë të tjera, për të plotësuar kërkesat për tërheqje të depozitave apo për të paguar borxhet tjera që kanë afat të shkurtër maturimi. Në dhjetor 2011, raporti ndërmjet aseteve likuide 'core' dhe detyrimeve afatshkurta qëndroi në 33.7 përqind që paraqet një rënie prej 6.9 pp krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë së njëjtës periudhë, raporti ndërmjet aseteve likuide 'broad' dhe detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 39.6 përqind, që po ashtu paraqet një rënie prej 6.6 pp krahasuar me vitin paraprak (Figura 36). Sidoqoftë, krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2011, në gjysmën e dytë të vitit të dy këta tregues kanë shënuar ngritje, duke pasur parasysh që në qershor 2011 raporti ndërmjet aseteve likuide 'core' dhe detyrimeve afatshkurta ishte 31.1 përqind, ndërsa raporti ndërmjet aseteve likuide 'broad' dhe detyrimeve afatshkurta ishte 38.1 përqind. Kjo tregon se zvogëlimi i këtyre treguesve të likuiditetit ka ndodhur kryesisht në gjysmën e parë të vitit 2011, ndërsa gjysma e dytë e vitit është karakterizuar me përmirësim të këtyre treguesve.

Figura 36. Raporti asete likuide "broad"/detyrime afatshkurtëra



Burimi: BQK (2012)

[11] Asetet likuide 'core' përfshijnë paranë e gatshme dhe gjendjen(bilancin) në BQK, si dhe llogaritë rrjedhëse në bankat tjera dhe plasmanet në bankat tjera me maturitet deri në 90 ditë. Asetet likuide broad' përfshijnë asetet likuide 'core' si dhe asetet e tregtueshme dhe letrat me vlerë me maturitet deri në 90 ditë.

Sistemi bankar i Kosovës në vaz hdimësi ka mirëmbajtur rezervat e likuiditetit në nivel më të lartë se sa niveli minimal i kërkuar nga Banka Qendrore. Bazuar në rregullat në fuqi, në dhjetor 2011 bankat komerciale që operojnë në Kosovë ishin të obliguara të mbanin mjete rezervë në shumën prej 177.4 milionë euro. Ndërsa, në fund të vitit 2011, rezervat e likuiditetit tejkalonin për 94.5 milion euro nivelin e rezervës së detyrueshme, duke qëndruar në 271.9 milionë euro (Figura 37). Krahasuar me vitin e kaluar, shuma e rezervave të sistemit bankar që tejkalon nivelin e rezervës së detyrueshme ka shënuar rritje. Ky nivel i likuiditetit bënë që sistemi bankar i Kosovës të ketë nivel mjaft të lartë të qëndrueshmërisë kundrejt tronditjeve të ndryshme potenciale në tregjet e fondeve financiare ose kundrejt tronditjeve të natyrës së tërheqjeve më të mëdha të depozitave, gjë e cila sugjerohet edhe nga rezultatet e stres-testit mbi rrezikun e likuiditetit (Seksioni 3.3.2.4.1).

Figure 37. Rezervat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

ii. Rreziku kreditor

Gjatë vitit 2011 performanca më e mirë e ekonomisë u reflektua edhe në performancën më të mirë të sistemit bankar, si për nga rritja e vëllimit të kreditimit, po ashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së portofolit kreditor.

Struktura e kredive sipas klasifikimit[12] në bazë të cilësisë vazhdoi të jetë e ngjashme me vitin e kaluar, madje kishte një zhvendosje të lehtë të kredive nga kategoritë me cilësi më të dobët drejtë kategorisë standarde (kategoria standarde përfshinë kreditë të cilat nuk kanë probleme të kthimit). Në figurën 38 mund të vërehet se pjesëmarrja e kredive që bëjnë pjesë në kategorinë standarde shënoi një rritje të lehtë krahasuar më vitin paraprak dhe qëndroi në 90.0 përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar (89.7 përqind në dhjetor 2011).

Figura 38. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2011)

Në dhjetor 2011, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara si vrojtuese në gjithsej kreditë shënoi rënie prej 0.1 pp krahasuar me vitin paraprak kur ishte 1.8 përqind. Ndërsa, kategoria e kredive nënstandarde mbeti e pandryshuar dhe qëndroi në 2.6 përqind të gjithsej portofolit kreditor. Në përgjithësi, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara në gjithsej portofolin kreditor shënoi rënie në vitin 2011, duke sugjeruar për një përmirësim të lehtë të cilësisë së kredive. Gjatë periudhës në fjalë, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara u

[12] Bazuar në rregulloret e BQK, kreditë në sektorin bankar të Kosovës klasifikohen në pesë kategori kryesore: standarde, vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë e klasifikuara përfshijnë kategoritë: vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë me probleme përfshijnë kategoritë: nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë joperformuese përfshijnë kategoritë: të dyshimta dhe të humbura.

zvogëlua në 10.0 përqind nga 10.3 përqind sa ishte në dhjetor të vitit 2010 (10.4 përqind në dhjetor 2009). Rënie të pjesëmarrjes ka shënuar edhe grupi i kredive me probleme, që në dhjetor 2011 përfaqësoi 8.3 përqind të gjithsej kredive, krahasuar me 8.5 përqind në dhjetor 2010.

Figura 39. Struktura e kredive joperformuese, në perqindje



Burimi: BQK (2012)

Rritje më të theksuar kanë shënuar kreditë e klasifikuara në kategoritë si 'të humbura', ndërsa kategoria e kredive të klasifikuara si 'të dyshimta' ka shënuar rënie. Këto dy kategori së bashku përbëjmë portofolion e Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL). Në dhjetor 2011, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej portofolin kreditor të sistemit bankar të Kosovës ishte 5.7 përqind, që paraqet një rënie prej 0.2 pp krahasuar me dhjetorin e vitit 2010. Struktura e NPL-ve vazhdon të dominohet nga kreditë e klasifikuara si të humbura, të cilat në dhjetor 2011 ngritën pjesëmarrjen në 64.5 përqind të gjithsej NPL-ve nga 59.5 përqind sa ishin në dhjetor 2010. Pjesa e mbetur e NPL-ve përbëhet nga kreditë e kategorizuara si të dyshimta (Figura 39). Gjatë kësaj periudhe, vlera e kredive të humbura shënoi rritje vjetore prej 23.1 përqind (11.6 milionë euro), ndërsa kreditë e dyshimta u zvogëluan për 0.4 përqind (130 mijë euro), krahasuar me vitin paraprak.

Figura 40. Raporti NPL/gjithsej kreditë, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Në figurën 40 mund të shihet se gjatë vitit 2011 norma e NPL-ve ka ndjekur një trend mjaft të luhatshëm. Në tremujorin e parë të vitit 2011, NPL-të arritën në 6.2 përqind, që njëherit paraqet nivelin më të lartë të NPL-ve që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar të Kosovës. Mirëpo, gjatë pjesës tjetër të vitit 2011, niveli i NPL-ve ishte mjaft i luhatshëm duke regjistruar rënie në tremujorin e dytë, ndërsa prapë u përkeqësua në tremujorin e tretë duke arritur në 6.0 përqind. Në fund të vitit 2011, norma e NPL-ve u zvogëlua në 5.7 përqind të gjithsej portofolit kreditor.

Figura 41. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve



Burimi: BQK (2012)

Vlera e përgjithshme e NPL-ve në dhjetor 2011 arriti në 96.2 milionë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 13.6 përqind. Gjatë periudhës 2009-2011, norma mesatare e rritjes vjetore të NPL-ve ishte 36.5 përqind, përderisa norma mesatare e rritjes së nivelit të përgjithshëm të kredisë ishte 12.8 përqind (Figura 41).

Nga gjithsej tetë banka sa operojnë në Kosovë, në vitin 2011, pesë prej tyre shënuan përkeqësim në cilësinë e portofolit kreditor (rritje e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej portofolin kreditor), ndërsa tri banka raportuan përmirësim në cilësinë e portofolit kreditor.

Sistemi bankar i Kosovës në vazhdimësi është treguar mjaft konzervativ sa i përket mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë, duke mbajtur provizionet në vazhdimësi në nivel më të lartë se NPL-të. Në dhjetor 2011, shkalla e mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë u rrit në 116.7 përqind, nga 114.4 përqind në dhjetor 2010 (Figura 42). Mesatarja e shkallës së mbulueshmërisë gjatë 4 viteve të fundit ishte 127 përqind. Në dhjetor 2011 shuma e përgjithshme e provizioneve ishte rreth 113.2 milionë euro krahasuar me 96.8 milionë euro në dhjetor 2010.

Figura 42. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2012)

ii. Rreziku i solvencës

Treguesi i mjaftushmërisë së kapitalit

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR) [13] në sistemin bankar të Kosovës në dhjetor 2011 qëndroi në 17.5 përqind, krahasuar me 18.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 43). Niveli aktual i kapitalizimit (mbulueshmëria me kapital) të sistemit bankar të Kosovës, shprehur përmes CAR-së, është mjaft i kënaqshëm duke marrë parasysh se dukshëm tejkalon normën minimale prej 12 përqind të përcaktuar nga BQK-ja. Prandaj, edhe pse kemi rënie në nivelin e përgjithshëm të CAR-së, sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me një shkallë e lartë të kapitalizimit, që në vazhdimësi ka tejkaluar minimumin e kërkuar

Figura 43. Kapitalizimi i sistemit bankar



Burimi: BQK (2011)

[13] Sipas rregullës perkatëse të BQK-së, bankat janë të obliguara të mbajnë raportin ndërmjet kapitalit dhe aseteve të peshuara ndaj rrezikut në nivelin prej së paku 12%.

rregullativ. Po ashtu, struktura e kapitalit të sistemit bankar dominohet nga kapitali i klasit të parë, gjë që paraqet një cilësi mjaft të mirë të kapitalit të sistemit bankar.

Figura 44. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Treguesi i mjaftushmërisë së kapitalit shprehet si raport në mes të nivelit të përgjithshëm të kapitalit në sistemin bankar dhe aseteve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA). Rënia e nivelit të CAR-së gjatë vitit 2011 ishte si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të RWA-ve në krahasim me normën e rritjes së kapitalit. Gjatë vitit 2011, RWA-të shënuan rritje vjetore prej 17.1 përqind, ndërsa norma vjetore e rritjes së kapitalit ishte 10.5 përqind. Në fund të vitit 2011, pesë banka raportuan për zvogëlim të nivelit të CAR-së, ndërsa dy banka raportuan për rritje. Sidoqoftë, është i rendësishëm fakti se të gjitha bankat që operojnë në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe dhe të gjitha kanë përmbushur kriterin prej 12 përqind për normën e CAR-së.

Bankat komerciale që operojnë në Kosovë në vazhdimësi kanë mbajtur nivele më të larta të kapitalit se që u është kërkuar me rregulloren perkatëse të BQK-së. Gjatë vitit 2011, gjithsej kapitali i sistemit bankar arriti në 300 milionë euro, përderisa kapitali rregullator i kërkuar bazuar në rregulloren e BQK-së ishte 205.2 milionë euro (Figura 44). Kjo do të thotë se në vitin 2011 kapitali i mbajtur nga bankat ishte për 94.7 milionë euro më i lartë se niveli i kërkuar në bazë të rregullores në fuqi.

Kapitali

Figura 45. Gjithsej kapitali dhe norma vjetore e rritjes, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Në dhjetor 2011, kapitali i sistemit bankar arriti vlerën prej 300 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.5 përqind, përderisa norma mesatare e rritjes vjetore të kapitalit gjatë periudhës 2008-2010 ishte 20.8 përqind. Figura 45 tregon se si gjatë katër viteve të fundit kapitali i sistemit bankar ka shënuar rritje të vazhdueshme, mirëpo norma e rritjes ka ndjekur trend rënës. Kapitali i sistemit bankar të Kosovës, përveç që ka shënuar rritje të vazhdueshme, poashtu në vazhdimësi është karakterizuar me cilësi të mirë. Cilësia e kapitalit të një banke kryesisht i referohet madhësisë së pjesëmarrjes së kapitalit aksionar në gjithsej kapitalin e bankës, ku sa më e madhe pjesëmarrja e kapitalit aksionar aq më cilësore vlerësohet të jetë struktura e kapitalit.

Prandaj duke marrë parasysh që kapitali i sistemit bankar të Kosovës kryesisht përbëhet nga kapitali aksionar (59 përqind e gjithsej kapitalit), atëherë mund të konsiderohet se

kapitali i bankave që oprojnë në Kosovë karakterizohet me cilësi mjaft të mirë. Po ashtu, bankat gjatë viteve të fundit kanë filluar të shfrytëzojnë edhe forma të financimit nga jashtë për të ngritur kapitalin, ku mund të veçohet rritja e përdorimit të borxhit të ndërvarur (angl. subordinated debt), që kategorizohet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë.

Figura 46. Struktura e kapitalit të sistemit bankar



Burimi: BQK (2012)

Struktura e kapitalit të sistemit bankar vazhdoi të dominohet nga kapitali i klasit të parë që arriti vlerën 252.0 milionë euro (në dhjetor 2010 ishte 227.4 milionë euro) apo, shprehur në pjesëmarrje, përfaqësoi rreth 84 përqind të gjithsej kapitalit (Figura 46). Ndërsa, kapitali i klasit të dytë shënoi vlerën prej 48 milionë euro (44.1 milionë euro në dhjetor 2010).

Kapitali i klasit të parë

Figura 47. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Në fund të vitit 2011, shuma e përgjithshme e kapitalit të klasit të parë në sistemin bankar arriti në 252 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.8 përqind (në vitin 2010 ishte 12.6 përqind). Struktura e kapitalit të klasit të parë vazhdon të dominohet nga kapitali aksionar, që në dhjetor 2011 përfaqësoi 70.1 përqind të kësaj kategorie të kapitalit (në dhjetor 2010 ishte 75 përqind). Ndërsa, kategoria e dytë për nga madhësia përbëhet nga fitimi i pashpërndarë i cili në këtë periudhë përfaqësoi 31.4 përqind të gjithsej kapitalit të klasit të parë (në dhjetor 2010 ishte 26.2 përqind). Mjetet jomateriale (angl. intangible assets) dhe vlera e emrit të mirë (angl. goodwill) morën pjesë me 1.5 përqind në gjithsej kapitalin e klasit të parë (1.4 përqind në dhjetor 2010) (Figura 47).

Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Në fund të vitit 2011, gjithsej vlera e aseteve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA) në sistemin bankar arriti në 1.71 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.1 përqind. Struktura e RWA-ve dominohet nga asetet me peshë të rrezikut prej 100 përqind, pjesëmarrja e të cilave arriti në 76.9 përqind nga 65.1 përqind sa ishte në dhjetor 2011 (Figura 48). Rritja e kësaj kategorie mund ti atribuohet normës më të lartë të rritjes së zërave jashtëbilancorë dhe në veçanti i atribuohet normës më të lartë të rritjes së kredive, të cilat paraqesin komponentin kryesor të aseteve me peshë të rrezikut prej 100 përqind. Pjesa tjetër e aseteve me peshë të rrezikut prej 100 përqind përbëhet nga mjetet fikse edhe patundshmëria në pronësi të bankave. Pjesëmarrja e aseteve me peshë të

rrezikut prej 75 përqind në gjithsej RWA-të u zvogëlua në 16.1 përqind nga 25.8 përqind sa ishte në fund të vitit 2010. Kjo kategori përbëhet nga kreditë e garantuara me hipotekën e parë në pasuri të patundshme dhe që kanë vonesë kthimi prej më pak se 30 ditë.

Figura 48. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2012)

Kategoria me pjesëmarrjen më të ulët në strukturën e RWA-ve përbëhet nga asetet me peshë të rrezikut prej 50 përqind, pjesëmarrja e të cilave u zvogëlua në 1.1 përqind të gjithsej RWA-ve nga 1.9 përqind sa ishte në dhjetor 2010.[14]

3.3.2.4.1 Analiza stres-test

Analiza stres-test paraqet një vegël shtesë përmes së cilës vlerësohet qëndrueshmëria e sistemit bankar. Me anë të skenarëve të ndryshëm përmes së cilëve simulohen tronditje potenciale si në portofolin kreditor ashtu edhe në asetet likuide testohet qëndrueshmëria e sistemit si në nivel të përgjithshëm ashtu edhe në nivel të bankave individuale. Analiza e shtjelluar në këtë publikim ka për bazë të dhënat e fundit të vitit 2011. Fokusi kryesor i analizës janë rreziku kreditor dhe rreziku i likuiditetit. Në sistemin bankar të Kosovës, rreziku nga norma e interesit dhe rreziku nga norma e këmbimit janë më pak të rëndësishëm, megjithatë skenarët për rrezikun kreditor janë kombinuar edhe me skenarë për këto dy rreziqe.[15] Në përgjithësi, rezultatet e analizës stres-test tregojnë për një gjendje të kënaqshme të qëndrueshmërisë së sistemit bankar të Kosovës, si për nga rreziku kreditor ashtu edhe për nga rreziku i likuiditetit.

Rreziku kreditor. Për të vlerësuar ndjeshmërinë e sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor është supozuar se pjesëmarrja e kredive joperformuese (*angl. Non-Performing Loans: NPL*) në gjithsej kreditë e sistemit bankar do të rritet për 4.8pp, nga niveli aktual i NPL-ve prej 5.7 përqind në dhjetor 2011.[16] Përveç rritjes së pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë, në këtë skenar po ashtu është supozuar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për 20 përqind si dhe zvogëlimi i normave të interesit për 2.0 pp. Rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve, zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon humbjet/fitimet në të hyrat neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave. Krahas supozimeve për tronditjet e lartpërmendura, po ashtu është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje.

Me kombinimin e këtyre tre skenarëve, u vlerësua ndikimi në nivelin e kapitalit rregullativ të sistemit bankar, aseteve të peshuara me rrezik, dhe rrjedhimisht në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR). Rezultatet tregojnë se

[14] Kjo kategori përbëhet nga kërkesat me maturim prej 1 viti ose më pak në bankat që veprojnë në vendet e OECD-së, por që nuk janë të klasifikuara ose që janë rankuar nga Standard & Poor's me B ose me gradë më të ulët apo që janë klasifikuar nga Moody's me P-3 ose me gradë më të ulët.

[15] Për detaje më të hollësishme mbi metodologjinë e stres-testit sygjeroheni të konsultoni Raportin e Stabilitetit Financiar Nr. 1, faqe 53 – 54, BQK (2010) dhe Raportin e Stabilitetit Financiar Nr. 2, faqe 69 – 72, BQK (2011).

[16] Norma e supozuar e rritjes së NPL-ve është përcaktuar duke marrë për bazë normën mesatare të rritjes ekonomike në Kosovë në vitet e fundit, supozimin për rënien ekonomike dhe koeficientin e elasticitetit të NPL-ve ndaj hendekut të prodhimit, që është bazuar në një analizë të papublikuar të FMN-së "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", Korrik 2010.

katër nga bankat që operojnë në Kosovë do të ballafaqoheshin me probleme në përmbushjen e nivelit rregullativ të kapitalit, me që në këtë rast treguesi i kapitalizimit të tyre do të ishte më i ulët se sa niveli prej 12 përqind i kërkuar nga Banka Qendrore. Shuma e nevojshme për rikapitalizimin e këtyre bankave do të arrinte në 19.7 milionë euro, apo 0.4 përqind e PBB-së. Në nivel të gjithsej sistemit bankar, tronditjet e supozuara do të shkaktonin një rënie të CAR-së në 16.2 përqind nga 17.5 përqind sa ishte niveli i CAR-së në dhjetor 2011. Si do që të jetë, niveli i CAR-së prej 16.2 përqind prap do të paraqiste nivel të kënaqshëm të kapitalizimit me që tejkalon minimumin e kërkuar nga rregullatori. Pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sistemit bankar do të arrinte në 10.5 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale pjesëmarrja e NPL-ve do të sillej brenda intervalit 4.9 përqind deri në 12.7 përqind.

Rreziku i likuiditetit. Për të vlerësuar ndjeshmërinë e sistemit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit është supozuar tërheqje e një vlere më të theksuar të depozitave nga sistemi bankar. Është konsideruar tërheqja e depozitave përgjatë një periudhe pesë ditore, duke mos marrë parasysh mundësinë e qasjes së bankave në financim nga jashtë. Sa i përket mjeteve likuide në dispozicion të bankave gjatë kësaj periudhe, është supozuar se mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind brenda ditës, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide do të ishte vetëm 1 përqind.

Nën supozimin e tërheqjes së depozitave me një normë prej 10 përqind të gjithsej depozitave në baza ditore në secilën nga bankat, vlera totale e depozitave të tërhequra pas 5 ditësh arrin në afër 41 përqind të gjithsej depozitave në sistemin bankar. Bazuar në rezultatet e analizës stres-test, nën këtë skenar hipotetik, mungesa e mjeteve likuide do të fillonte të paraqitej në ditën e dytë, mirëpo do të ishte e izoluar vetëm në njërën nga bankat që operojnë në vend. Shuma e nevojshme për mbulimin e nevojave të likuiditetit në këtë rast do të kapte vlerën prej 4.2 milionë euro. Pas ditës së tretë, problemet me likuiditet do të shfaqeshin edhe në një bankë tjetër, dhe deri në fund të ditës së pestë problemet me likuiditetin do të paraqiteshin në katër nga bankat (Tabela 4). Shuma e përgjithshme e aseteve likuide të nevojshme për përballimin e këtyre problemeve, në fund të ditës së pestë, do të kapte vlerën prej 71 milionë euro. Në këtë rast raporti kredi/depozita në nivel të sistemit bankat do të arrinte në 135.9 përqind, duke supozuar se vlera e kredive mbetet e pandryshuar gjatë kësaj periudhe.

Tabela 4. Përmbledhje e rezultateve të analizës stres-test: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti kredi/depozita (në përqindje)
Pas ditës së parë	0	0	89.2
Pas ditës së dytë	1	4,156	99.1
Pas ditës së tretë	2	21,566	110.1
Pas ditës së katërt	2	38,856	122.3
Pas ditës së pestë	4	71,063	135.9

Shënim: 1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Në kuadër të analizës stres-test, gjithashtu është testuar se sa do të ishte norma maksimale e tërheqjes të depozitave nga depozitorët, të cilën bankat që operojnë në Kosovë do të mund të përballonin me mjetet likuide që aktualisht i kanë në dispozicion. Në nivel të sistemit bankar në tërësi, problemet me likuiditetin do të fillonin të paraqiteshin kur norma e tërheqjes së depozitave do të arrinte në rreth 31 përqind të gjithsej depozitave në sistemin bankar. Sidoqoftë, kjo normë dallon ndërmjet bankave individuale, ku te disa bankat është më e ulët ndërsa te disa është më e lartë. Edhe në këtë skenar është

konsideruar se mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide do të ishte vetëm 1 përqind.

3.3.3. Fondet pensionale

Sistemi pensional paraqet një komponent mjaft të rëndësishëm të sektorit financiar të Kosovës, me një pjesmarrje prej 14 përqind në gjithsej asetet e sektorit financiar. Në vitin 2011, vlera e aseteve të sistemit pensional të Kosovës arriti në 593.3 milionë euro (12.7 përqind e PBB-së). Rreth 99.4 përqind e gjithsej aseteve të sistemit pensional në vend menaxhohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), ndërsa pjesa e mbetur prej 0.6 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

Performanca e aseteve të TKPK-së gjatë vitit 2011 u karakterizua me ndryshime në çmimin e aksionit, sidomos gjatë muajit shtator kur çmimi për njësi shënoi rënie në 1 euro, nivelin më të ulët gjatë vitit. Sidoqoftë, deri në fund të vitit, rikuperimi i tregjeve financiare u reflektua edhe në asetet nën menaxhim të TKPK-së duke bërë që çmimi për njësisë të arrijë në 1.034 euro, që nënkupton kthim prej 3.3 milionë euro për vitin 2011. Performanca e trustit ka një sjellje të ngjashme me indikatorët kryesor që paraqesin performancën e tregjeve. Siç është paraqitur në figurën 49, ekziston nje korelacion mjaft i lartë ndërmjet indeksit Dow Jones dhe performancës së investimeve të TKPK-së. Investimet e TKPK-së vazhdojnë të jenë të koncentruara në tregun e aksioneve. Poashtu, një pjesë e konsiderueshme e investimeve të TKPK-së është e koncentruar në fonde investive që diversifikojnë portfolion në instrumente dhe shtete të ndryshme (Figura 50, kategoria diversifikime tjera). Me pjesëmarrje relativisht të lartë marrin pjesë edhe bonot, bonot e lidhura me inflacion si dhe tregu i parave. Në ekonominë e Kosovës deri në fund të vitit 2011 janë investuar 5.9 përqind të gjithsej aseteve të TKPK-së, të cilat janë investuar në formë të depozitave bankare.

Figura 49. Çmimi i aksionit tëTKPK-së dhe indeksi DJI



Burimi: Trusti (2012), DJI (2012)

Figura 50. Struktura e investimeve të Trustit



Burimi: Trusti (2012)

Me performancë pozitive gjatë vitit 2011 u karakterizua edhe FSKP. Vlera e aksionit të FSKP-së në vitin 2011 shënoi rritje prej 4.1 përqind, ndërsa struktura e investimeve të FSKP-së dominohet nga mjetet e investuara në obligacione (rreth 75 përqind). Pjesa tjetër prej mbi 20 përqind janë investime në depozita bankare. Një pjesë relativisht e vogël e

mjeteve nën menaxhimin e FSKP-së janë investuar në tregje të aksioneve dhe para të gatshme.

3.3.4 Kompanitë e sigurimit

Sistemi i kompanive të sigurimit vazhdoi të zgjerojë aktivitetin edhe gjatë vitit 2011. Ndryshe nga viti i kaluar kur në industrinë e sigurimeve operonin gjithsej 11 kompani të sigurimit, gjatë vitit 2011 pjesë e kësaj industrie u bënë edhe dy kompani të reja, gjegjësisht 'Sigal Life' dhe 'Grawe Kosova' të cilat ofrojnë polica të sigurimit të jetës. Rrjedhimisht, numri i kompanive të sigurimit që ofrojnë sigurim jetësor në Kosovë arriti në tri kompani. Bashkë me 10 kompani tjera të sigurimit, të cilat ofrojnë polica për sigurimin jo jetësor, në vitin 2011 në Kosovë operuan gjithsej 13 kompani të sigurimit.

Sa i përket strukturës së pronësisë, nëntë kompani të sigurimit janë me pronësi të huaj, ndërsa katër kompani tjera janë me pronësi vendore. Struktura e pronësisë së aseteve të kompanive të sigurimit mbetet e ngjashme me vitet e kaluara. Pas bashkangjitjes së kompanisë së sigurimit me pronësi vendore 'Sigal Life', pjesëmarrja e aseteve me pronësi vendore në vitin 2011 u rrit në 32.7 përqind (28.9 përqind në vitin 2010), ndërsa pjesëmarrja e aseteve të kompanive të sigurimit me pronësi të huaj u zvogëlua në 75.3 përqind (77.1 përqind ën vitin 2010). Gjithsej asetet e sistemit të kompanive të sigurimit në fund të vitit 2011 arritën vlerën prej 106 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 9.4 përqind që paraqet trend të ngjashëm të rritjes me vitin e kaluar.

Raporti ndërmjet kapitalit dhe gjithsej aseteve, i cili shprehë nivelin e kapitalizimit të kompanive të sigurimit, në vitin 2011 arriti në 41.2 përqind, krahasuar me 41.8 përqind në vitin 2010. Ndërsa, raporti ndërmjet kapitalit dhe rezervave teknike, i cili tregon aftësinë e kompanive të sigurimit për të përballuar humbjet potenciale, në vitin 2011 ishte 79.8 përqind krahasuar me 84 përqind në vitin 2010.

Fitimi neto i kompanive të sigurimit në vitin 2011 u rrit në 5.7 milionë euro, krahasuar me 3.8 milionë euro sa ishte në vitin 2010. Përmirësimi i rezultatit financiar gjatë vitit 2011, u reflektua edhe në ecurinë e dy indikatorëve të performancës së kompanive të sigurimit, siç janë Kthimin Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) dhe Kthimin Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE). Indikatori ROAA, në vitin 2011 u ngrit në 1 përqind, krahasuar me 0.9 përqind sa ishte në vitin 2010, ndërsa ROAE u rrit në 2.5 përqind, ndërsa në vitin 2010 ishte 2.2 përqind.

Figura 51. Primet e shitura dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Gjatë vitit 2011, numri i policave të shitura arriti në 605.2 mijë, që paraqet një rritje vjetore prej 11.9 përqind (Figura 51). Po ashtu, gjatë vitit 2011 rritje më të përshpejtuar prej 9.6 përqind shënoi edhe vlera e primeve të pranuara nga kompanitë e sigurimit, të cilat arritën vlerën prej 78.1 milionë euro (5.1 përqind rrije në vitin 2010). Kjo rritje kryesisht reflekton rritjen e policave të shitura për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palsës së tretë (angl. Third Party Liability: TPL), si dhe rritjen e policave për sigurim vullnetar.

Veprimtaria e kompanive të sigurimit kryesisht është e orientuar drejt ofrimit të policave TPL, të cilat gjenerojnë pjesën më të madhe të primeve të pranuara (rreth 59 përqind të gjithsej primeve të shitura). Vlera e TPL-ve në vitin 2011 arriti në 45.8 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 12.6 përqind (11.8 përqind rritje vjetore në vitin 2010). Pjesa tjetër e primeve të shitura përbëhet nga policat për sigurim vullnetar (29 përqind) dhe policat e sigurimit kufitar (12 përqind). Policat për sigurim vullnetar në vitin 2011 treguan trend më të shpejtuar të rritjes prej 13.3 përqind krahasuar me rritjen prej 6.8 përqind në vitin 2010, dhe arritën vlerën prej 22.7 milionë euro.

Si kategori me pjesëmarrje më të vogël në gjithsej primet e shitura janë policat e sigurimit kufitar, të cilat në vitin 2011 arritën vlerën prej 9.6 milionë euro dhe u zvogëluan për 9.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Zvogëlimi i vlerës së policave të shitura për sigurim kufitar mund të ketë ardhur si pasojë e zvogëlimit të tarifës së këtyre policave që nga gjysma e dytë e vitit 2011.

Dëmet e paguara nga ana e kompanive të sigurimit shënuan rritje vjetore prej 1.1 përqind në vitin 2011 dhe arritën vlerën prej 26.8 milionë euro. Megjithatë, rritja e primeve të paguara u ngadalësua në krahasim me vitin e kaluar kur rritja vjetore ishte rreth 40 përqind. Ngadalësimi rritjes së dëmeve të paguara gjatë vitit 2011 kryesisht erdhi si pasojë e rënies së dëmeve të paguara për mbajtësit e policave TPL si dhe të sigurimit kufitar. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara nga ana e kompanive të sigurimit përbëhet nga pagesat për mbajtësit e policave TPL, të cilat përfaqësojnë 67 përqind të gjithsej dëmeve të paguara. Pjesëmarrja e pagesave për mbajtësit e TPL-ve në vitin 2011 zvogëlua për 5pp. Pagesat për mbajtësit e TPL-ve arritën vlerën prej 18 milionë euro dhe shënuan rënie prej 6.2 përqind në vitin 2011, krahasuar me rritjen prej 39 përqind në vitin 2010. Pjesa e mbetur e dëmeve të paguara nga ana e kompanive të sigurimit përbëhet nga pagesat për mbajtësit e policave tjera, pagesa këto që në vitin 2011 arritën vlerën prej 7.9 milionë euro (6.3 milionë euro në vitin 2010).

3.3.5. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar

Në vitin 2011, në Kosovë operuan gjithsej 20 institucione mikrofinanciare (IMF) dhe 32 ndihmës financiarë. Gjatë vitit 2011, u licencuan edhe dy IMF të reja, gjegjësisht 'Timi Invest' dhe 'Agro Invest'.

Figura 52. Asetet e IMF-ve, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e IMF-ve të shënojë rënie edhe gjatë vitit 2011. Pjesëmarrja e aseteve të tri IMF-ve më të mëdha në vitin 2011 u zvogëlua në 49 përqind nga 59 përqind sa ishte në vitin 2010 (Figura 52). Rënia e shkallës së koncentrimit në tregun e IMF-ve tregohet edhe përmes indeksit Herfindahl-Hirschman për asetet, sipas të cilit shkalla e koncentrimit në vitin 2011 ka rënë në 1,293 pikë, krahasuar me 2,097 pikë në vitin 2010.

Aktiviteti i IMF-ve vazhdon të jetë i përqendruar në financimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Numri i kredive të lëshuara nga këto institucione deri në fund të vitit

2011 arriti në 57, 536 kredi, që paraqet një rënie vjetore prej 8.2 përqind. Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga IMF-të në vitin 2011 u zvogëlua për 9.8 përqind dhe shënoi vlerën prej 104.7 milionë euro. Zvogëlimi i kredive të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare kryesisht është pasojë e vështirësimit të kushteve të financimit për këto institucione nga tregjet e jashtme. Institucionet mikrofinanciare që operojnë në Kosovë për burim kryesor të financimit kanë linjat kreditore nga tregjet e jashtme me që nuk e kanë të drejtën e pranimit të depozitave. Vlera mesatare e një kredie të lëshuar nga IMF-të në vitin 2011 ishte 1,819.7 euro, e cila paraqet një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2010 kur ishte 1,852.2 euro.

Në vitin 2011, performanca e IMF-ve tregoi përmirësim krahasuar me performancën e vitit 2010. Një ndër treguesit e performancës së IMF-ve përfaqësohet nga neto profiti, i cili në vitin 2011 u rrit në 0.9 milionë euro krahasuar me neto profitin prej 0.8 milionë euro në vitin 2010. Rrjedhimisht, treguesi i Kthimit Mesatar në Kapital (ROAE) në vitin 2011 arriti në 2.5 përqind nga 2.2 përqind sa ishte në vitin 2010. Ndërsa, Kthimi Mesatar në Asete (ROAA) u zvogëlua në 0.9 përqind nga 1 përqind sa ishte në vitin 2010.

Ndihmësit financiarë në Kosovë përbëhen nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Gjatë vitit 2011, përmes ndihmësve financiarë janë transferuar gjithsej 246.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.3 përqind. Nga kjo shumë, 220 milionë euro ishin transfere hyrëse në Kosovë, ndërsa 26.1 milionë euro ishin transfere dalëse. Transferet e realizuara përmes ATP-ve në vitin 2011 përbënin 3.8 përqind të gjithsej transefereve, kurse pjesa më e madhe e transfereve vazhdon të transferohet përmes bankave komerciale (rreth 80.9 përqind e gjithsej transfereve).

3.4. Sektori i jashtëm

Ekonomia e Kosovës vazhdoi të karakterizohet me nivel të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse edhe gjatë vitit 2011. Në këtë vit, kryesisht si pasojë e rritjes së bilancit negativ të tregtisë së mallrave, deficiti në llogarinë rrjedhëse shënoi një rritje vjetore prej 20.5 përqind. Përderisa në vitin 2010, si rezultat i rimëkëmbjes së kërkesës në nivel global e cila ndikoj në masë të madhe shitjet e industrisë së metaleve, përkatësisht të xeheve të nikelit, eksportet shënuan një normë mjaft të lartë të rritjes, në vitin 2011 trendi i eksporteve ishte më i ngadalshëm. Norma e rritjes së importeve ishte dukshëm më e lartë krahasuar me rritjen e eksporteve. Për këtë arsye, si dhe për shkak të peshës së lartë që kanë importet në strukturën e përgjithshme të tregtisë së Kosovës, efekti i rritjes së eksporteve është neutralizuar. Si rrjedhojë, deficiti tregtar ishte më i lartë për 17.5 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Llogaritë e shërbimeve, të ardhurave, dhe transfereve rrjedhëse vazhduan të kontribuojnë pozitivisht në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, bilancet pozitive të të cilave u karakterizuan me rritje vjetore prej 95.3, 70.8, përkatësisht 0.8 përqind në vitin 2011. Në të njëjtën kohë, llogaria kapitale dhe financiare (që përfshinë llogarinë kapitale, IHD-të, portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë) u përmbyll me bilanc pozitiv prej 419.6 milion euro, që paraqet rritje vjetore prej 41.2 përqind dhe ishte rezultat i rritjes së bilancit të llogarisë financiare prej 36.9 përqind dhe llogarisë kapitale prej 97.3 përqind.

3.4.1 Llogaria rrjedhëse

Deficiti i llogarisë rrjedhëse arriti në 672.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 20.5 përqind. Raporti ndërmjet deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe PBB-së arriti në 14.4 përqind krahasuar me 13.2 përqind në vitin 2010. Deficiti tregtar i cili ka shënuar rritje vjetore prej

17.5 përqind, vazhdon të jetë shkaktari kryesor për nivelin e lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse (Figura 53).

Në anën tjetër, bilancet pozitive të llogarive si tregtia e shërbimeve, të ardhurave, e në veçanti transfereve rrjedhëse deri diku kanë mënjanuar efektet negative të deficiti tregtar. Llogaria e shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 95.3 përqind (-25.9 përqind në vitin 2010). Gjithashtu, edhe llogaria e të ardhurave shënoi rritje vjetore prej 70.8 përqind (8.5 përqind në vitin 2010). Ndërsa, llogaria e transfereve rrjedhëse u karakterizua me rritje të lehtë vjetore prej 0.8 përqind (-0.1 përqind në vitin 2010). Transferet rrjedhëse paraqesin kategorinë kryesore në kuadër të pranimeve në llogarinë rrjedhëse, të cilat në vitin 2011 përbënin 47.9 përqind të gjithsej pranimeve në këtë llogari. Ndërsa, pagesat nga llogaria rrjedhëse kryesisht janë të destinuara për blerjen e mallrave dhe përbëjnë 80.1 përqind të gjithsej pagesave.

Figura 53. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

3.4.1.1 Mallrat dhe shërbimet

Ekonomia e Kosovës po vazhdon me zgjerim të aktivitetit tregtar, që reflektohet në shkallën e hapjes tregtare e cila në vitin 2011 arriti në 65.6 përqind të PBB-së, krahasuar me 57.9 përqind të PBB-së në vitin 2010. Rritja e theksuar e importeve, gjatë vitit 2011 ka rezultuar në shkallë më të ulët të mbulueshmërisë së importeve me eksporte, përkatësisht ka shënuar shkallën e mbulueshmërisë prej 12.6 përqind, krahasuar me 13.7 përqind në vitin paraprak (Tabela 5).

Tabela 5. Bilanci tregtar i Kosovës, në milionë euro

Përshkrimi	2008	2009	2010	2011
Eksportet	198.5	165.3	294.0	312.5
Importet	1,928.2	1,935.5	2,144.9	2,479.3
Bilanci tregtar	-1,729.7	-1,770.2	-1,850.9	-2,166.8
Raporti eksport/import (%)	10.3	8.5	13.7	12.6
Hapja tregtare (% e PBB-së)	55.2	53.7	57.9	65.6

Burimi: BQK (2012)

Duke shënuar vlerën prej 2.17 miliard euro, deficiti tregtar i Kosovës në vitin 2011 ishte më i lartë për 17.5 përqind krahasuar me vitin 2010. Në raport me PBB-në, deficiti tregtar shënoi rritje të theksuar në krahasim me vitin e kaluar, përkatësisht nga 43.9 përqind të PBB-së në vitin 2010 në 50.9 përqind e PBB-së në vitin 2011.

Importet e Kosovës shënuan rritje vjetore prej 15.6 përqind, duke arritur vlerën prej 2.48 miliardë euro. Rritja vjetore e çmimeve të produkteve të naftës për rreth 17.0 përqind gjatë

vitit 2011 ndikoi deri në një masë në rritjen e vlerës nominale të importeve, kur kemi parasysh që produktet minerale paraqesin një ndër kategoritë kryesore të importeve në vend. Në anën tjetër, eksportet e Kosovës shënuan rritje vjetore prej vetëm 6.3 përqind, duke arritur vlerën prej 312.5 milionë euro.

Edhe pse ngritja e çmimeve gjatë vitit 2011 ishte kryesisht me karakter global, ekonomia e Kosovës u përball me nivel më të lartë të çmimeve krahasuar me mesataren e vendeve të BE-së dhe të vendeve anëtare të CEFTA-s. Shkalla më e lartë e inflacionit në Kosovë për rreth 6.2pp krahasuar me vendet e CEFTA-s dhe vendet në BE, ndikoi që norma reale efektive e këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate: REER) të vlerësohet (revalvohet). Të dhënat në vitin 2011 tregojnë se REER ka shënuar një revalvim mesatar vjetor ndaj vendeve të BE-së për 3.3 përqind si dhe ndaj vendeve të CEFTA-s për 4.1 përqind. Revalvimi i REER-it ndaj valutave të partnerëve kryesor tregtar vazhdon paraqet një faktorë të rëndësishëm i cili dekurajon eksportet dhe inkurajon importet në Kosovë si rezultat i çmimit më të lartë për eksporte dhe më të ulët për importe.

Struktura e importeve ishte ngjashme me vitin paraprak (Figura 54). Produktet e importuara që në vitin 2010 shënuan rritje, vazhduan me trendin e tyre edhe në vitin 2011, me përjashtim të kategorisë së makinerive dhe pajisjeve që shënuan rënie vjetore prej 7.2 përqind duke rënë nga 288.2 milionë euro sa ishin në vitin 2010 në 267.6 milionë euro në vitin 2011. Importi i produkteve minerale shënoi rritje vjetore prej 28.4 përqind duke kontribuuar kështu me rreth 3.4pp në rritjen e gjithsej importeve. Produktet minerale paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej importet ndërsa vlera e tyre në vitin 2011 arriti në 538.1 milionë euro. Importet e produkteve ushqimore, pijeve, dhe duhanit edhe pse shënuan rritje vjetore prej 16.2 përqind, duke arritur kështu vlerën prej 303.9 milion euro, kishin një pjesëmarrje në strukturën e importeve pothuajse të njëjtë me vitin 2010 (12.3 përqind). Kategoria e metaleve bazë në vitin 2011 arriti vlerë e 228.0 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 20.0 përqind. Pjesmarrja e kësaj kategorie në gjithsej importet arriti në 9.2 përqind krahasuar me 8.9 sa ishte në vitin 2010. Kategori të rëndësishme në importet e Kosovës mbeten edhe produktet kemikale dhe produktet e plastikës dhe gomës të cilat rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej importet në 7.2, përkatësisht 5.5 përqind në vitin 2011.

Figura 54. Kategoritë kryesore të strukturës së importeve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 55. Kategoritë kryesore të strukturës së eksporteve, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Struktura e eksporteve vazhdon të dominohet nga metalet bazë, të cilat kishin një pjesëmarrje prej 60.8 përqind në gjithsej eksportet, krahasuar me 63.0 përqind në dhjetor 2010 (Figura 55). Eksportet e këtyre produkteve në vitin 2011 shënuan rritje vjetore prej 2.6 përqind dhe arritën vlerën 190.1 milion euro (185.2 milionë euro në vitin 2010). Rritja e eksporteve në kategorinë e makinerive dhe pajisjeve (që kryesisht paraqet eksport të energjisë elektrike) prej 40.6 përqind përfaqëson një kontribuues të rëndësishëm në në gjithsej eksportet e Kosovës. Vlera e eksportit të kësaj kategorie në vitin 2011 ishte 15.1 milionë euro (4.8 përqind e gjithsej eksporteve). Kategori tjetër me pjesëmarrje prej 4.0 përqind në gjithsej eksportet janë edhe produktet e plastikës dhe gomës që shënuan rritje prej 54.1 përqind duke arritur vlerës në 12.4 milionë euro. Në anën tjetër, për dallim nga viti i kaluar kur eksporti i produkteve minerale shënoi rritje vjetore prej 55.3 përqind, në vitin 2011 eksportet e këtyre produkteve shënuan rënie vjetore prej 0.4 përqind. Vlera e eksporteve të produkteve minerale arriti në 38.6 milionë euro ndërsa pjesëmarrja e kësaj kategorie në gjithsej eksportet është 12.4 përqind.

Figura 56. Importet sipas BEC-it, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Struktura e klasifikimit të produkteve të importuara sipas qëllimit të përdorimit të tyre apo sipas Kategorive Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories: BEC) ishte relativisht e ngjashme me vitet paraprake. Vërehet një shtim i pjesëmarrjes në gjithsej importet për 6.0pp e kategorisë së mallrave të ndërmjetëm. Kjo kategori ka një pjesëmarrje rreth 53.8 përqind në gjithsej importet, pasuar nga mallrat e konsumit me pjesëmarrje prej 30.9 përqind në gjithsej importet (Figura 56). Pjesëmarrja e lartë e importit të mallrave të ndërmjetme tregon se aktiviteti prodhues në ekonominë e Kosovës mbështetet në masë të madhe nga importi i lëndës së parë nga jashtë. Gjithashtu, pjesëmarrja e lartë e mallrave të konsumit në gjithsej importet tregon për një nivel ende të ulët të prodhimit vendor. Pjesëmarrja e mallrave kapitale në gjithsej importet është zvogëluar në 8.2 përqind nga 10.2 përqind sa ishte në vitin 2010, përkundër rritjes së investimeve në vend.

Figura 57. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Struktura e partnerëve tregtarë të Kosovës ishte e ngjashme me vitet e kaluara. Në vitin 2011, Kosova realizoi rreth 73.8 përqind të gjithsej shkëmbimeve tregtare me vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe vendet anëtare të CEFTA-s. Niveli i përgjithshëm i shkëmbimeve tregtare në vitin 2011, me vendet e BE-së dhe vendet e CEFTA-s u rrit për 13.2 përkatësisht 12.9 përqind.

Vlera e eksporteve të Kosovës në BE arriti në 136.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej vetëm 3.7 përqind. Sidoqoftë, pjesëmarrja e produkteve të eksportuara në BE në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit u zvogëlua për 1.1pp (Figura 57). Në kuadër të vendeve të BE-së, Italia paraqet destinacionin kryesor për eksportet e Kosovës, me një pjesëmarrje prej 26.8 përqind në gjithsej eksportet. Pjesa më e madhe e eksporteve në Itali përbëhen nga xehet e nikelit. Rritja e eksporteve drejt Gjermanisë, për 52.0 përqind, paraqet kontributin kryesor në rritjen e eksporteve drejt vendeve të BE-së. Rritje të pjesëmarrjes në gjithsej eksportet e Kosovës kanë shënuar edhe eksportet drejtë disa vendeve tjera, si: Austria, Holanda, Franca, etj.

Eksportet drejtë vendeve të CEFTA-s arritën vlerën prej 82.4 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 16.2 përqind. Në kuadër të vendeve të CEFTA-s, Kosova vazhdon të eksportojë pjesën më të madhe të produkteve në Shqipëri dhe Maqedoni (10.6 përkatësisht 9.8 përqind të gjithsej eksporteve të vendit). Në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë u eksportuan mallra në vlerë prej vetëm 8.3 përkatësisht 0.6 milionë euro. Përderisa eksportet në Serbi shënuan rritje vjetore prej 116.9 përqind, eksportet në Bosnje dhe Hercegovinë shënuan rënie vjetore prej 67.6 përqind.

Edhe sa i përket importeve, vendet e BE-së dhe CEFTA-s mbeten partnerë kryesorë tregtarë për Kosovën. Importet nga vendet e BE-së arritën në 941.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 14.7 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Importi nga vendet e BE-së përbën rreth 38.0 përqind e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë (Figura 58). Pjesa më e madhe e mallrave të importuara nga BE vijnë nga Gjermania (11.8 përqind e gjithsej importeve) dhe Italia (6.3 përqind të importeve). Prej vendeve të CEFTA-s, pjesa më e madhe e mallrave të importuara janë nga Maqedonia dhe Serbia, që kanë një pjesëmarrje prej 14.7 përkatësisht 10.9 përqind në gjithsej importet e Kosovës.

Figura 58. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtarë, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Figura 59. Llogaria e shërbimeve - kategoritë kryesore, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Llogaria e tregtisë së shërbimeve u karakterizua me bilanc pozitiv prej 281.3 milion euro, krahasuar me 144.0 milionë euro në vitin 2010 (Figura 59). Bilanci pozitiv i kësaj llogarie reflekton më shumë të hyrave nga shitja e shërbimeve për jorezidentët, krahasuar me pagesat për shërbime ndaj jorezidentëve. Më konkretisht, të hyrat në llogarinë e shërbimeve shënuan rritje vjetore prej 19.6 përqind duke arritur vlerën në 634.0 milionë euro, ndërsa pagesat për shërbime ndaj jorezidentëve arritën vlerën prej 352.8 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej -8.6 përqind.

Kjo rritje e theksuar e bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve reflekton në radhë të parë rritjen e të hyrave nga shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet tjera biznesore, të cilat shënuan rritje vjetore prej 24.3, përkatësisht 78.3 përqind. Gjithashtu, edhe pagesat për këto shërbime shënuan rënie vjetore prej 3.0, përkatësisht 5.7 përqind, gjë që i ka kontribuar pozitivisht bilancit të llogarisë së shërbimeve. Rritja më e shpejtë e të hyrave të shërbimeve të udhëtimit dhe shërbimeve tjera biznesore si dhe zvogëlimi i pagesave për këto shërbime bëri që bilanci të arrijë në 251.2 përkatësisht -22.0 milionë euro (179.2 përkatësisht -60.6 milionë euro në 2010). Gjithashtu, edhe të hyrat nga shërbimet e komunikimit shënuan rritje vjetore prej 22.7 përqind, ndërsa pagesat për këto shërbime u zvogëluan për 37.5 përqind. Si rrjedhojë, kjo kategori shënoj bilanc pozitiv prej 77.0 milionë euro dhe përfaqëson rreth 27.4 përqind të bilancit të shërbimeve. Të hyrat nga shërbimet e ndërtimit arritën vlerën prej 13.7 milionë euro (6.4 milionë euro në vitin 2010), përderisa pagesat për shërbimet e ndërtimit arritën vlerën 19.0 milionë euro (26.6 milionë në vitin 2010). Shërbimet tjera që shënuan bilanc pozitiv gjatë vitit 2011 ishin edhe shërbimet qeveritare (shërbimet e ofruara për ambasada dhe pranisë ushtarake të NATO-s) dhe shërbimet kulturore e rekreative. Në anën tjetër, të gjitha kategoritë tjera të shërbimeve, si shërbimet e sigurimit, shërbimet financiare, etj. përmbyllën këtë vit me bilanc negativ.

3.4.1.2 Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse

Llogaria e të ardhurave regjistroi bilanc pozitiv në vlerë prej 113.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 69.7 përqind. Në kuadër të llogarisë së të ardhurave, të hyrat ishin 241.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 36.4 përqind. Në të njëjtën kohë, pagesat arritën vlerën prej 127.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 16.1 përqind. Rritja e të hyrave në këtë llogari rezultoi kryesisht nënkategoria e kompenzimit të punëtorëve[17] kosovarë jashtë vendit për 25.6 përqind gjatë vitit 2011, krahasuar me 3.8 përqind rritje në vitin 2010 (Figura 60). Njëherit, të hyrat nga kompenzimi i punëtorëve paraqesin edhe kategorinë dominuese në kuadër të të hyrave në llogarinë e të ardhurave (91.7 përqind), duke shënuar vlerën prej 221.2 milionë euro në vitin 2011 (176.1 milionë euro në vitin 2010). Pjesa më e madhe e të hyrave nga kompenzimi i punëtorëve në vitin 2011 përbëhet nga të ardhurat e punëtorëve kosovarë në Afganistan e Irak, si dhe nga personeli vendor i punësuar në KFOR. Në të njëjtën kohë, edhe pagesat për kompenzimin e punëtorëve (punëtorët jorezident të angazhuar në Kosovë për periudha afat shkurtra – më pak se një vit) arritën vlerën 13.1 milionë euro në vitin 2011 krahasuar me 4.5 milionë euro sa ishin në vitin 2010. Në anën tjetër, kategoria e të ardhurave nga investimet në vazhdimësi ka shënuar bilanc negativ, mirëpo në vitin 2011 vlera -94.3 milion euro ishte për 9.8 përqind më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat në kuadër të kësaj llogarie arritën në 20.1 milionë euro ndërsa pagesat arritën në 114.4 milionë euro. Të hyrat nga investimet përbëhen

Figure 60. Llogaria e të ardhurave, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

[17] Kompenzimi i punëtorëve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet tjera ekonomike të pranuara nga punëtorët kosovarë jashtë për punë sezonale ose afat-shkrute (deri në një vit).

kryesisht nga të ardhurat që janë realizuar nga investimet e institucioneve vendore në letra me vlerë në tregjet e jashtme, përderisa të pagesat kryesisht përbëhen nga të ardhurat e realizuara nga investimet e kompanive të huaja që veprojnë në vend si bankat komerciale dhe ndërmarrjet e huaja që operojnë në vend.

Figura 61. Transferet rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Një nga kategoritë më të rëndësishme të bilancit të pagesave, e cila në vazhdimësi ka kontribuuar në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, janë edhe transferet rrjedhëse. Kjo për arsye se llogaria e transfereve rrjedhëse në vazhdimësi është karakterizuar me bilanc pozitiv. Bilanci i llogarisë së transfereve rrjedhëse arriti vlerën prej 990.4 milionë euro, që paraqet një rritje të lehtë vjetore prej 0.8 përqind (Figura 61). Transferet rrjedhëse përbëhen nga transferet qeveritare (32.5 përqind) dhe transferet e sektorit privat (67.5 përqind). Transferet e qeverisë qendrore arritën vlerën prej 322.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 0.8 përqind. Në kuadër të transfereve rrjedhëse qeveritare kryesisht hyjnë transferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut.

Transferet rrjedhëse të sektorit privat dominohen nga dërgesat e emigrantëve, që përfaqësojnë rreth 74.9 përqind të gjithsej pranimeve në kuadër të kësaj llogarie. Gjatë vitit 2011 dërgesave e emigrantëve arritën vlerën e 584.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 0.08 përqind. Në anën tjetër dërgesat e jorezidentë që drejtë vendeve tjera shënuan vlerën prej 95.5 milionë euro (91.4 milionë euro në vitin 2010), (Figura 62). Pjesa më e madhe e dërgesave të emigrantëve të pranuara në Kosovë vijnë nga vendet anëtare të BE-së, si Gjermania (33.2 përqind), Zvicra (23.1 përqind), Italia (7.0 përqind), Austria (5.5 përqind), dhe në një përqindje më të vogël nga Sllovenia, SHBA-të, Suedia, etj. Edhe përkundër rritjes së papunësisë dhe përkeqësimit të kushteve të punësimit në vendet e BE-së vërehet një stabilitet i të hyrave nga dërgesat e emigrantëve në Kosovë.

Figura 62. Dërgesat e emigrantëve të pranuara në Kosovë



Burimi: BQK (2012)

3.4.2 Llogaria kapitale dhe financiare

Llogaria kapitale dhe financiare gjatë vitit 2011 u karakterizua vazhdon të karakterizohet me bilanc pozitiv prej 419.6 milionë euro (rritje prej 50.8 përqind krahasuar me vitit 2010). Bilanci i llogarisë kapitale në vitin 2011 arriti në 42.0 milionë euro krahasuar me 21.3 milionë euro në vitin 2010, e përbërë nga donacionet për qeverinë. Llogaria financiare e cila përbëhet nga Investimet e Huaja Direkte (IHD), portfolio investimet, investimet e tjera si dhe asetet rezervë kishte bilanc prej 377.5 milionë euro. Siç është paraqitur në figurën 63, kontribuuesi kryesor në kuadër të llogarisë financiare vazhdojnë të jenë Investimet e huaja direkte, ndërsa kategoritë tjera kanë ndikim më të ulët. Portfolio investimet në tri vitet e fundit karakterizohen me ndikim negativ, ndërsa asetet rezervë gjatë vitit të fundit kishin reflektim pozitiv në llogarinë financiare. Investimet tjera gjatë vitit 2011 nuk reflektuan në ndryshime efekt substancial në llogarinë financiare.

Figure 63. Llogaria Financiare neto, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

3.4.2.1 Investimet e Huaja Direkte

Investimet e Huaja Direkte, si njëra ndër burimet më të rëndësishme të financimit në Kosovë, gjatë vitit 2011 arritën vlerën neto 378.9 milionë euro. Rritja e IHD-ve gjatë vitit 2011 ishte dyshifrore duke arritur normën prej 14.4 përqind. Bilanci i prej 378.9 milionë eurove përbëhet nga 394.6 milionë euro investime të jo rezidentëve në ekonominë e Kosovës si dhe 15.7 milionë euro investime të rezidentëve Kosovarë në vendet tjera.

IHD-të në Kosovë gjatë viteve të fundit kanë pasur pjesëmarrje prej mesatarisht 9 përqind të PBB-së. Vitet 2007 dhe 2008 regjistruar niveli relativisht të lartë të IHD-ve që kryesisht është rezultat i licencimit të kompanisë së dytë të telefonisë mobile në Kosovë si dhe investimet e ndërmarra nga kjo kompani. Niveli më i ulët i IHD-ve ishte gjatë vitit 2009, që reflekton ndikimin e krizës globale në ekonominë e Kosovës nëpërmjet këtij kanali. Kjo pasi që IHD-të në Kosovë vazhdojnë të jenë mjaft të ndjeshme ndaj zhvillimeve në ekonomitë e vendeve të Eurozonës, të cilat njëkohësisht paraqesin burimin kryesor të tyre. IHD-të filluan të shënojnë rikuperim gjatë vitit 2010, ndërsa rritje e theksuar e IHD-ve u regjistrua edhe në vitin 2011.

Figura 64. Investimet e Huaja Direkte si përqindje e PBB-së



Burimi: BQK (2012)

Investimet e jo rezidentëve në Kosovë në masën më të madhe i takojnë formës së investimeve kapitale që përfaqësojnë 72.8 përqind të gjithsej IHD-ve (70.5 përqind në vitin 2010). Formë tjetër e rëndësishme në kuadër të IHD-ve në vend janë edhe investimi i fitimeve të pashpërndara me pjesëmarrje prej 14.7 përqind (20.0 përqind në vitin 2010) si dhe format tjera të IHD-ve me pjesëmarrje prej 12.5 përqind (9.5 përqind në vitin 2010). Në anën tjetër investimet e rezidentëve kosovarë jashtë vendit i takojnë formës së investimeve kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve përbëhen prej blerjes së patundshmërive jashtë vendit.

Figure 65. Investimet e huaja direkte sipas sektorit ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

IHD-të në Kosovë kryesisht janë përqendruar në sektorët e ekonomisë si ndërtimtaria me 32.8 përqind, prodhimtaria me 12.6 përqind, sektori financiar me 11.7 përqind, patundshmëria me 16.0 përqind, përcjellë nga sektori i transportit dhe telekomunikacionit me një pjesëmarrje prej 5.9 përqind të gjithsej IHD-ve. Siç është paraqitur edhe në figurën 65, viti 2011 ishte kryesisht i ngjashëm me vitin 2010 për sa i përket strukturës së IHD-ve. Industria e procesimit ka shënuar një rënie të theksuar gjatë kësaj priudhe, ndërsa rritja më e lartë vërehet në sektorin e ndërtimtarisë si dhe sektorin e transportit dhe telekomunikacionit.

Vendet e BE-së vazhdojnë të paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë. Për dallim nga viti i kaluar, kur pjesa më e madhe e IHD-ve kishte për vend të origjinës Gjermaninë (25 përqind të gjithsej IHD-ve), në periudhën janar-shtator 2011, Britania e Madhe paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në Kosovë (29.6 përqind të gjithsej IHD-ve). Rritje të theksuar të IHD-ve ka pasur edhe nga Turqia, që gjatë kësaj periudhe paraqet vendin e tretë për nga shuma e IHD-ve. Përveç këtyre, Zvicra, Austria, Sllovenia dhe SHBA, vazhdojnë të jenë vende me nivel të konsiderueshëm të IHD-ve në Kosovë (Figura 66).

Figura 66. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

3.4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë

Portfolio investimet jashtë vendit gjatë vitit 2011 shënuan rritje në krahasim me vitin paraprak. Vlera e portfolio investimeve arriti në 57.8 milionë euro në vitin 2011 (49.2 milionë euro vitin 2010). Portfolio investimet në masë të konsiderueshme duket se reflektojnë perceptimet e institucioneve financiare vendore mbi ambientin e përgjithshëm në tregjet globale financiare. Pjesa më e madhe e portfolio investimeve janë mjete të

fondeve pensionale të cilat investohen në instrumente të tregjeve financiare jashtë vendit, ndërsa pjesë më e vogël e kësaj kategorie janë investime të bankave lokale në vendet tjera. Në kuadër të bilancit prej 57.8 milionë euro, 96.5 milionë euro paraqesin investime të reja në tregje të kapitalit, ndërsa 38.7 milionë euro janë kthim i mjeteve në ekonominë e Kosovës.

Kategoria e investimeve tjera karakterizohet me lëvizje të kapitalit po thuaj se të balancuar. Kjo pasi që investimet jashtë vendit në kuadër të kësaj kategorie kanë bilanc prej 5.7 milionë euro prej të cilave, 81.7 milionë euro janë investime jashtë ekonomisë së Kosovës, ndërsa 76.0 milionë euro janë investime të jorezidentëve në ekonominë e Kosovës. Investimet jashtë ekonomisë së Kosovës kryesisht janë plasmanë të depozitave jashtë vendit si dhe kthimet e kredive ndaj institucioneve jorezidente. Në anën tjetër, investimet në Kosovë janë kryesisht në formë të kredive tregtare nga kompanitë jorezidente ndaj kompanive në Kosovë.

3.4.3 Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm

Pozicioni i investimeve ndërkombëtare paraqet vlerën e aseteve dhe detyrimeve të Kosovës ndaj vendeve tjera. Bilanci kreditor i Kosovës në kuadër të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) në vitin 2011 ishte 104.5 milionë euro, ose 2.2 përqind e PBB-së. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare gjatë viteve u ngushtua kur merret parasysh se Kosova ishte kreditor neto me 10.5 përqind të PBB-së gjatë vitit 2010. Faktorët që ndikuan që bilanci kreditor i Kosovës të ngushtohet në vitin 2011 ishin rritja e theksuar e stokut të IHD-ve në Kosovë, por gjithashtu edhe zvogëlimi i konsiderueshëm i aseteve rezervë si dhe zvogëlimi i investimeve në letra me vlerë.

Figura 67. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

3.4.3.1 Asetet dhe Detyrimet në Pozicionin e Investimeve ndërkombëtare

Në asetet e Kosovës jashtë vendit, forma kryesore e investimeve është kategoria e investimeve tjera (57.3 përqind e gjithsej aseteve) e cila përfshinë depozitat në banka jashtë vendit. Pjesëmarrje të konsiderueshme në stokun e aseteve jasthë vendit kanë edhe investimet portfolio (22.3 përqind) si dhe asetet rezervë (17.3 përqind). Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithsej asetet e Kosovës

Figura 68. Asetet sipas formës së investimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

jashtë vendit paraqiten investimet e huaja direkte (investimet e rezidentëve Kosovar në vendet tjera) të cilat kanë pjesëmarrje prej 3.1 përqind në gjithsej asetet jashtë vendit. Sipas sektorëve, pronarë kryesor të aseteve të Kosovës jashtë vendit janë sektorët tjerë (fondet pensionale, organizatat joqeveritare dhe sektori privat) me 44.2 përqind, Banka Qendrore me 35.5 përqind dhe bankat komerciale me 20.3 përqind.

Figura 69. Detyrimet sipas formës së investimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Detyrimet e ekonomisë së Kosovës sipas formës së investimit janë të dominuara nga investimet e huaja direkte me një pjesëmarrje prej 73.2 përqind dhe investimet tjera me pjesëmarrje prej 26.8 përqind (kryesisht kreditë tregtare dhe kreditë tjera). Investimet e huaja direkte si një ndër komponentët më të rëndësishme të PIN në kuadër të detyrimeve gjatë viteve në Kosovë kanë arritur vlerën prej 2.36 miliardë euro.

3.4.3.2 Borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm i Kosovës, i cili përfshinë borxhin privat dhe borxhin publik në fund të vitit 2011 arriti në 1.4 miliardë euro. Në anën tjetër, borxhi ndaj ekonomisë së Kosovës arriti në 2.9 miliardë euro. Ky pozicion në kuadër të borxhit të jashtëm bënë që Kosova të jetë net kreditor për 1.5 miliardë euro.

Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm i takon formës së kredive ndërmjet kompanive në kuadër të investimeve të huaja direkte. Rrjedhimisht, kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë i detyrohen sektorit të jashtëm me një vlerë prej 565.4 milionë euro apo 39.6 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm. Me pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës janë edhe sektorët tjerë borxh ky i cili rrjedhë nga kreditë tregtare të pranuara nga firmat vendore si dhe kreditë tjera. Pjesa dërmuese (75.3 përqind) e borxhit të sektorëve tjerë përbëhet nga borxhi afatshkurtër, ndërsa 24.7 përqind përbëhet nga borxhi afatgjatë. Borxhi i bankave komerciale ndaj sektorit të jashtëm është 13.8 përqind, borxh ky i cili është afatshkurtër dhe përbëhet nga kreditë dhe depozitat nga jashtë vendit. Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm është Banka Qendrore (66.4 milionë euro apo 4.7 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm.

Pjesëmarrës në borxhin e jashtëm është edhe sektori publik, mirëpo, pjesëmarrja e sektorit publik në gjithsej borxhin është 253.6 milionë euro (apo 17.8 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm), që si përqindje e PBB-së është 5.5 përqind.

Borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës deri në fund të vitit 2011 arriti në 2.9 miliardë euro. Sektori i jashtëm më së shumti i detyrohet Bankës Qendrore, në vlerë prej 40.3 përqind të gjithsej detyrimeve (1.2 miliardë euro). Sektori i jashtëm i ekonomisë i detyrohet gjithashtu edhe sektorëve tjerë të ekonomisë së Kosovës si fondeve pensionale por edhe sektorit privat në shumën prej 1.1 miliardë euro apo 36.6 përqind të gjithsej borxhit. Nga 1.1 miliardë të detyrimeve ndaj sektorëve tjerë të ekonomisë së Kosovës, 1.0 miliardë është borxh afatgjatë. Bankave vendore, sektori i jashtëm i detyrohet në vlerë prej

675.5 milionë euro apo 23.1 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës.

4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare

Duke zbatuar parimet më të mira të standardeve ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar, BQKsynon një mbikëqyrje financiare dhe një proces rregullativ efikas, fleksibil dhe që promovon një sektor financiar konkurrues të bazuar në ekonominë e tregut..
Rrjedhimisht, një ndër funksionet kryesore të BQK-së është që të sigurojë mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, me qëllim të krijimit të një sektori financiar të shëndoshë, të arritshëm dhe konkurrues – një sektor financiar të besueshëm dhe me ofertë të gjerë të shërbimeve financiare. Departamentet si ai i licencimit dhe rregullimit, pastaji mbikëqyrjes së bankave, të sigurimeve si dhe divizioni i mbikëqyerjes së pensioneve dhe tregut të letrave me vlerë janë njësi përgjegjëse organizative që sigurojnë realizimin e këtij synimi dhe funksioni të BQK-së.

4.1. Licencimi dhe Rregullativa

4.1.1. Licencimi

Vizioni i BQK-se për sektorin financiar është që sektori financiar të jetë i qëndrueshëm dhe i drejtuar nga forcat e tregut, por që vepron brenda rregullativës prudente dhe kornizës së politikës së mbikqëyjres të harmonizuar në bazë të direktivave të BE-së dhe KE-së. Kriteret dhe kushtet për të marrë licencë për kryerjen e veprimtarive bankare dhe veprimtarive tjera financiare në Republikën e Kosovës janë të përcaktuara në Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës Nr. 03/ L-209 dhe në aktet tjera nënligjore të nxjerra nga BQK-ja. Në përputhje me legjislacionin që drejton funksionin e saj statusor, BQK-ja ka autoritetin për të vendosur kriteret për licencimin e institucioneve financiare dhe për të refuzuar ato të cilat nuk i përmbushin këto standarde.

Kriteret e licencimit të përcaktuara me legjislacion, synojnë sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar,veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore.

Strategjia e BQK-së në fushën e licencimit të institucioneve financiare përqendrohet në tërheqjen e investitorëve të cilët kanë gjendje të mirë financiare, përmbushin kriteret etike dhe profesionale të nevojshme dhe të përshtatshem për aksionarë dhe menaxhment, janë të aftë të drejtojnë një qasje në zhvillimin e matur të biznesit për të mbrojtur interesat e klientëve, duke ndihmuar në këtë mënyrë forcimin e sektorit financiar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.
Departamenti i Licensimit dhe Rregullimit ka për detyrë kompletimin e kornizës ligjore për mbikëqyrje financiare në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikat e mira ndërkombëtare ashtu siq janë të prezentuara në "Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive Bankare" të publikuara nga Banka për Rregullim Ndërkombëtar (anglisht: Bank for International Settlement-BIS), si dhe "Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive të Sigurimeve" të publikuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikqyrësve të Sigurimeve (anglisht: International Association of Insurance Supervisors - IAIS). Në kryerjen e këtij misioni Departamenti i licencimit është përgjegjës për pranimin,

shqyrtimin dhe rekomandimin për aplikacione të institucioneve që kërkojnë licencim respektivisht regjistrim për të operuar në Kosovë, siç janë bankat komerciale, kompanitë esigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve, fondet pensionale dhe të gjitha institucionet tjera financiare jo bankare.

Aktiviteti i licensimit të mbikëqyrjes financiare gjatë vitit 2011 kryesisht ka përfshirë:

- Aprovimine tetëdhjetë (80) kërkesave për hapje tëdegëve të reja dhe zhvendosje të degëve të bankave, të kompanive të sigurimit, si dhe institucioneve tjera financiare në Kosovë;
- Aprovimin paraprak të kërkesës së një banke në ndryshimin e strukturës së aksionarëve ;
- Aprovimin epesë (5) kërkesave në shtimin e veprimtarive dhe të produkteve të sigurimeve;
- Aprovimin e pesëdhjetë e një (51) kërkesave të agjentëve të kompanive të sigurimit
-
- Aprovimin eshtatë (7) kërkesave të bankës në ndryshimin e aktit të themelimit dhe statutit;
- Aprovimin e dy (2) kërkesave për shpërndarjes të dividendës;
- Aprovimin tridhjetë e shtatë (37) kërkesave për emërime të administratorëve dhe menaxhmentit të lartë të bankave, të kompanive të sigurimeve dhe institucioneve financiare jo bankare;
- Aprovimin elicensimit të kompanive të sigurimit të jetës,të regjistrimit të institucioneve mikro financiare dhe jo bankare, si dhe zyrave të këmbimit të valutave.

Në rastet e miratuara të administratorëve të bankave, njëmbëdhjetë (11) prej tyre janë për anëtarë të bordit drejtues të bankës, katër (4) raste janë për anëtarë të komitetit të auditimit , dhe gjashtë (6) raste janë për drejtor dhe zëvendës drejtor të përgjithshëm të bankave dhe institucioneve mikrofinanciare. Ndërsa, tek sigurimet, shtatë (7) prej tyre janë për anëtarë të bordeve drejtuese të kompanive të sigurimit, gjashtë (6) raste janë për drejtor dhe zëvendësdrejtor të përgjithshëm të kompanive dhe ndërmjetësuesve të sigurimit dhe tre (3) raste për auditorë të brendshëm.

Bankat dhe kompanitë e sigurimeve kanë punuar vazhdimisht në zgjerimin e aktivitetit të tyre në drejtim të diversifikimit të produkteve bankare dhe siguruese duke ofruar më shumë mundësi investimi dhe zgjedhje të shumta për klientët e tyre. Gjatë vitit 2011 është pranuar vetëm një aplikacion për themelim të bankës, mirëpo ka pasur edhe interesim nga investitorë tëjashtëm për të aplikuar për bankë ose degë bankare, kryesisht nga Turqia. Në tregun bankar gjatë vitit 2011 kishim 8 banka me 311 degë dhe nën degë bankare, ndërsa në tregun e sigurimeve njëmbëdhjetë (13) kompani të sigurimeve - dhjetë (10) kompani të sigurimit jo jetë dhe tre (3) kompani të sigurimit të jetës.

Bordi Ekzekutiv i BQK-së gjate vitit 2011 ka aprovuar licencën finale të kompanisë së sigurimeve " Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a " për sigurim të jetës.

Në fushën e pensioneve kanë vazhduar së operuari dy fonde pensionale: fondi pensional i detyrueshëm – Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës ("Trusti") dhe fondi i pensioneve individuale - Fondi Slloveno Kosovar.

Tabela 6. Aktiviteti i licencimit të bankave, të kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale sipas viteve , 2009 – 2011

Intitucionet financiare	2009	2010	2011
Banka	8	8	8
Kompani të Sigurimit	11	12	13
Fondet pensionale të detyrueshme dhe individuale	2	2	2

Burimi: BQK (2011)

Institucionet mikro financiare dhe jo bankare financiare.Në fund të vitit 2011, në Kosovë, kanë operuar pesëmbëdhjetë (15) institucione mikro financiare dhe pesë (5) institucione jo bankare financiare me aktivitet të kredidhënies. Bordi Ekzekutiv ka miratuar regjistrimin e dy institucioneve mikrofinanciare dhe një institucioni financiar jo bankar për kredidhënie: "Timi Invest" (Prishtinë) , "Agro Invest" (Krushë e Vogël, Prizren) dhe "Fundway Mortgage" (Prishtinë).

Ndërmjetësuesit e sigurimeve. Në fund të vitit 2011 kanë operuar 3 ndërmjetësues të sigurimeve. Për arsye të shkeljes së rregullativës ligjore Bordi Ekzekutiv ka tërhequr licensën e ndërmjetësuesit të sigurimeve "ENB sh.p.k "në Prishtinë**.**

Zyret e Këmbimit të Valutave dhe Zyret e Transferit të Parave. Gjatë vitit 2011 Bordi Ekzekutiv i BQK-së aprovoi aktivitetin shtesë të transferit të parave për institucionin financiar jo bankar "Vllesa CO" , si dhe regjistrimin e pesë zyreve të këmbimit:"Ismeti dhe Safeti" (Gjakovë), "Kemi" (Pejë), "Yllka" (Gjilan) dhe "Mani" (Rahovec) . Në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi është tërhequr regjistrimi i Zyrës së Këmbimit "Pëllumbi" (Rahovec).Në fund të vitit 2011 , në Kosovë kanë operuar tridhjetë (30) zyre të këmbimit të valutave dhe katër zyre të transferit të parave.

Tabela 7. Aktiviteti i regjistrimit të institucioneve mikro financiare, jo bankare financiare, zyreve të transferit të parave dhe zyreve të këmbimit të valutave sipas viteve , 2009– 2011

Përshkrimi	2009	2010	2011
Institucionet Mikro Financiare	14	13	15
Institucionet Financiare jo Bankare -kredidhënje	5	4	5
Zyret e Transferit të Parave	3	3	4
Zyret e Këmbimit të Valutave	23	26	30

Burimi: BQK (2012)

Tabela 8. Aktiviteti licencues i ndërmjetësuesve të sigurimit sipas viteve, 2009-2011

Përshkrimi	2009	2010	2011
Agjentët/operatorët	528	679	744
Brokerët e Sigurimit	4	3	2
Trajtuesit e dëmeve	4	1	1

Burimi: BQK (2012)

4.1.2 .Rregullativa

a) Kuadri ligjor

Korniza ligjore në fushën e rregullimit të mbikëqyrjes financiare është në proces të rishikimit dhe freskimit, për të siguruar një mbikëqyrje efektive financiare. Me qëllim të avancimit dhe konsolidimit të bazës ligjore për sektorin financiar në Kosovë është hartuar draft projektligji i ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare i cili tashmë ka hyrë në fuqi.Ky ligj është hartuar në bashkëpunim me asistencën teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Departamentit të Thesarit Amerikan dhe në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, standardet dhe direktivat e BE-së, në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, si dhe në përputhje me parimet bazë të Bazelit për Mbikëqyrje Bankare Efektive. Ligji i sipërpermendur ofron një sfond më të gjerë dhe gjithëpërfshirës në rregullimin dhe mbikëqyrjen financiare, ndër tjera duke përfshirë:

- Forcimin e kritereve të qeverisjes;
- Përfshirjen e të drejtës së Mbikëqyrjes së Konsoliduar të grupeve bankare dhe konglomerateve financiare;
- Dispozitat për procedurat e 'Zgjidhjes së Bankave Problematike dhe Strategjitë Dalëse' janë korrigjuar dhe plotësuar;
- Trajtimi më i kujdesshëm i ekspozimeve të mëdha;
- Kreditimin e palëve të ndërlidhura me bankën;
- Zgjerimi i së drejtës së imponimit të gjobave administrative për shkeljet e ndryshme të ligjit bankar; si dhe
- Promovimin e Bankingut Islam.

Poashtu, ky ligjpërfshin një avancim më të lartë të bazës ligjore për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciare. Në bashkëpunim me asistencën e Bankës Botërore është draftuar ligji i përgjithshëm i sigurimeve dhe ligji për fondet pensionale të Kosovës. Në vazhdën e zhvillimeve domethënëse që e karakterizuan vitin 2011 ishte edhe hyrja ne fuqi e Ligjit Nr. 04/L-018 Mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë i cili ligj u fuqizua në korrik të vitit 2011.Me hyrjen në fuqi të Ligjit, në shtator të vitit 2011, BQK-ja në bashkëpunim me industrinë e sigurimeve dhe akterët tjerë relevant themeluan Byronë Kosovare të Sigurimeve (BKS). Themelimit të BKS i parapriu edhe vizita dy ditore e delegacionit te Këshillit te Byrove të Kartonit të Gjelbër– me seli ne Bruksel, vizitë e cila u realizua për herë të parë në Kosovë, përkatësisht në BQK e që kontribuoi drejt nxitjes së mundësisë se anëtarësimit në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër me seli nëBruksel. Ne vazhdën e këtyre zhvillimeve, në nëntor të vitit 2011, me ndihmesë edhe të BQK-se, Byroja Kosovare e Sigurimeve përgatiti dhe dorëzoi aplikacionin për anëtarësim ne Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër me seli në Bruksel.

b) Rregulloret

Qëllimi i plotësimit të rregulloreve përkatëse për mbikëqyrje financiare është sigurimi dhe krijimi i një mjedisi të rregulluar mirë, pa vendosur ngarkesa të panevojshme për përdoruesit e shërbimeve financiare.

Në pajtueshmëri me ligjin e ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe në bashkëpunim me asistencën teknike të Fondit Monetar

Ndërkombëtar është bërë rishikimi dhe draftimi i rregulloreve të reja bankare. Komisionet përkatëse të themeluarapër rishikimin e kornizës rregullative dhe përgaditjen e rregulloreve të reja mbikëqyrëse sipas kërkesave të nxjerrame ligjin e ri dhe standardet ereja ndërkombëtare për mbikëqyrje bankare kanë fianlizuar draftimin e rregulloreve të reja dhe politikave e procedurave të brendshme për mbikëqyrje financiare.

Viti 2012 do të jetë vit i vazhdimësisë së konsolidimit të kornizës ligjore për mbikëqyrjen e bankave në përputhje me ligjin e ri për banka dhe njëkohësisht krijimin e një kornize rregullative që reflekton në nevojat dhe kërkesat e identifikuara gjatë një periudhe dymbëdhjetë vjeçare të ekzistimit të mbikëqyrjes bankare në Kosovë.

c) Lista e institucioneve financiare

Tabela 9. Bankat Komerciale

Bankat komerciale		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	ProCredit Bank	64
2	Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.	52
3	NLB Prishtina sh.a	53
4	Banka për Biznes	43
5	Banka Ekonomike	46
6	TEB sh.a	22
7	Banka Kombetare Tregtare – Dega Kosovë	23
8	Komercijalna Banka – Dega Mitrovicë	8
	Gjithsej	311

Burimi: BQK (2012)

Tabela 10. Fondet pensionale

Fondet pensionale		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Trusti i kursimeve pensionale te Kosoves – Shtylla e II'të	1
2	Fondi Slloven Kosovar – Shtylla e III'të	1
	Gjithsej	2

Burimi: BQK (2012)

Tabela 11. Zyrat per transferin e parave

Zyrat për transferin e parave		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	UFP (nën-agjentët)	175
2	DMTH (nën-agjentët)	87
3	Vllesa Co	24
4	KLM Enterprise	1
	Gjithsej	287

Burimi: BQK (2012)

Tabela 12. Institucionet mikrofinanciare

Institucionet mikrofinanciare		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Finca	21
2	KEP	35
3	KGMAMF-Grameen	4
4	AFK	12
5	Besëlidhja	11
6	KRK	13
7	Mështekna	1
8	Qelim Kosovë	1
9	KosInvest	6
10	Start	2
11	Perspektiva 4	1
12	KAD	1
13	ACP	1
14	Agro Invest	1
15	Timi Invest	1
	Gjithsej	111

Burimi: BQK (2012)

Tabela 13. Institucionet financiare jobankare

Institucionet financiare jobankare		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Crimson Finance Fund	1
2	Lesna	9
3	Raiffeisen Leasing	1
4	Factor Leasing	1
5	Fundway Mortgage	1
	Gjithsej	13

Burimi: BQK (2012)

Tabela 14. Kompanitë e sigurimeve

Kompanitë e sigurimeve		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Dardania	31
2	Illyria	48
3	Kosova e Re	34
4	Siguria	37
5	Insig	32
6	Sigma	39
7	Sigal	44
8	Croatia Sigurimi	23
9	Sigkos	25
10	Graw e Elsig	38
11	Illyria Life	1
12	Graw e Kosova	1
13	Sigal Life Uniqa Group Austria	1
	Gjithsej	354

Burimi: BQK (2012)

Tablea 15. Ndërmjetësuesit e sigurimeve

Ndërmjetësuesit e sigurimeve		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	WVP Sh.p.k	1
2	Risk Sh.p.k	1
3	Ansiia Sh.p.k	1
	Gjithsej	3

Burimi: BQK (2012)

Tabela 16. Zyrat e këmbimit të valutave

Zyrat e këmbimit të valutave		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	ZK Euro Cufa	1
2	ZK NBS	1
3	ZK Monedha	1
4	ZK Euro	1
5	ZK Euro Këmbimi	1
6	ZK Euro Eki	1
7	ZK Gipa	1
8	Zk Xeni	1
9	ZK Agimi	1
10	ZK Indriti	1
11	ZK Agoni	1
12	ZK Ximi	1
13	ZK Beni	1
14	ZK Prizreni	1
15	ZK Valuta	1
16	ZK Edona	1
17	ZK Ebani	1
18	ZK Te Gazi	1
19	ZK Hamza	1
20	ZK Veli	1
21	ZK Mena	1
22	ZK Sara	1
23	ZK Kujtimi	1
24	ZK Adis	1
25	ZK Aral	1
26	ZK Ismeti	1
27	ZK Kemi	1
28	ZK Safeti	1
29	ZK Yllka	1
30	ZK Mani	1
	Gjithsej	30

Burimi: BQK (2012)

4.2. Mbikëqyrja Bankare

4.2.1. Sektori Bankar – Karaktersistika e përgjithëshme

Përgjatë vitit 2011, sektori bankar i Kosovës vazhdoi të rritet si dhe të ruaj qëndrueshmërinë e komponentëve përbërës të likuiditetit, profitabilitetit dhe kapitalit. Vlera e gjithsej mjeteve të sektorit bankar arriti në 2.515 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore me rreth 187.9 milion euro ose 8.1 për qind për dallim nga niveli i rritjes së vitit të kaluar prej 231.2 milion euro ose 11.0 për qind. Struktura e mjeteve vazhdoi të financohet kryesisht nga depozitat dhe të jetë e përqendruar në aktivitetin kredidhënës. Në fund të vitit 2011, portofoli kreditorë përbënte rreth 62.2 për qind të gjithsej mjeteve të sistemit bankar.

Dinamika e rritjes u karakterizua me konsolidimin e vazhduar të sistemit, përkatësisht rritjes së peshës së bankave të vogla dhe degëve të bankave të huaja dhe rënies së lehtë të peshës së bankave të mëdha, përderisa nuk kishte ndryshime në numrin e përgjithshëm të bankave. Si në vitin paraprak edhe gjatë 2011 sistemi bankar përfaqësohej nga tetë (8) banka, prej të cilave katër (4) banka me kapital të huaj, dy (2) në pronësi të kapitalit vendor me disa prurje të reja edhe të kapitalit të huaj, dhe dy (2) degë të bankave të huaja.

Bankat e vogla (G2)[18] shfaqën rritje të gjithsej mjeteve me rreth 92.4 milion euro ose 4.0 për qind, pasuar nga degët e bankave të huaja (G3)[19] për të cilat kjo rritje përllogaritet në rreth 51.6 milion euro ose 2.2 për qind dhe bankat e mëdha (G1)[20] me rritje rreth 43.9 milion euro ose 1.9 për qind. Pas këtyre ndryshimeve, pjesëmarrja e bankave të vogla (G2) dhe degëve të bankave të huaja (G3) në kuadër të sistemit bankar është rritur në 19.5 respektivisht 7.1 për qind në vitin 2011 nga 17.1 dhe 5.5 për qind sa ishte në vitin 2010, ndërsa pjesëmarrja e bankave të mëdha ka rënë në 73.4 për qind nga 77.4 për qind.

Ndryshimet e lartpërmendura janë në funksion të nxitjes së konkurrencës ndër-bankare duke shtuar peshën e bankave të vogla dhe degëve të bankave të huaja që veprojnë në Kosovë. Këtyre ndryshimeve gjatë vitit i është adaptuar edhe aktiviteti mbikëqyrës duke shtuar fokusin e monitorimit të përformancës financiare dhe ekzaminimeve më të shpeshta në grup-bankat me ritëm më të shpejt të rritjes dhe profilizimin më gjithëpërfshirës të bankave të mëdha duke u bazuar edhe në analizën e qëndrueshmërisë së konsoliduar financiare të grupit të cilit i takojnë.

Mjetet dhe Depozitat – Zhvillimet dhe Trendet

Gjatë vitit 2011, sistemi bankar ka shënuarrritje të gjithsej mjeteve me 8.1 për qind, duke treguar një ngadalësim të ritmit të rritjes gjatë këtij viti kundrejt rritjes prej 10.2 për qind gjatë vitit 2010.

Figura 70. Trendi i mjeteve në sektorin bankar - gjithsej mjetet, në mijëra euro



Burimi: BQK (2012)

Struktura e mjeteve të sistemitbankar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar karakterizohet mekëto zhvillime kryesore :

"Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK" shënoi rritje me rreth 24.5 milion euro ose 8.0 për qind, përkatësisht paraja e gatshme u rritë për 7.9 milion euro ose 7.7 për qind, ndërsa gjendja me BQK për 16.6 milion euro ose 8.1 për qind. Megjithatë, pjesëmarrja e zërit "Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK" në kuadër të gjithsej mjeteve të sistemitbankar ka mbetur e njëjtë sikurse në vitin e kaluar, respektivisht 13.2 për qind. Ky pozicion përbën fondet më likuide të sistemit bankar duke ritheksuar kështu ruajtjen e nivelit të likuiditetit të sistemit me gjithë nivelin e rritjes së mjeteve tjera, sidomos mjeteve të peshuara me rrezik.

[18] Bankat me pjesëmarrje në treg prej <10% të gjithsej mjeteve.
[19] Përfshin degët e bankave të huaja që veprojnë në Kosovë.
[20] Bankat me pjesëmarrje në treg prej >10% të gjithsej mjeteve.

"Kërkesat ndaj bankave/plasmanët" regjistruan rënie me rreth 99.7 milion euro ose 22.7 për qind krahasuar me vitin e mëparshëm, e cila është reflektuar në rënien e peshës së tyre në kuadër të gjithsej mjeteve nga 18.9 për qind në 13.5 për qind në vitin 2011. Rënia e plasmanëve është ndikuar kryesisht nga rritja e nivelit të kreditimit të ekonomisë vendore, kufizimi i ekspozimeve me rrezik kreditorë dhe vazhdimi i rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive qendrore në vendet që kanë ruajtur klasifikimin e favorshëm. BQK, si në dy vitet e kaluara edhe gjatë këtij viti ndoqi qasje më të matur për sa i takon limiteve ekzistuese të ekspozimeve të bankave në institucionet financiare jashtë vendit. Nga ky aspekt, është mbajtur niveli rregullatorë prej 20 për qind në ekspozimet me rrezik kreditorë karshi kapitalit të klasit të parë. Kjo qasje është diktuar në masë të madhe nga paqëndrueshmëria e tregjeve financiare globale dhe fluktuimet në tregjet rajonale .

"Investimet në letrat me vlerë" ndonëse janë rritur për 28.5 milion euro ose 16.4 për qind, niveli i rritjes është më i ultë krahasuar me vitin paraprak prej 78.8 për qind. Prirja e rritjes më të ngadaltë të zërit të letrave me vlerë është ndikuar nga strategjia e bankave për kanalizimin e mjeteve të lira në aktivitetin e kredi-dhënies. Pjesëmarrja e letrave me vlerë në kuadër të gjithsej mjeteve është në nivel prej rreth 8.0 për qind, përderisa kualiteti është i mirë duke qenë kryesisht letra me vlerë të qeverive qendrore të shteteve me klasifikim të favorshëm, përkatësisht aftësi të lartë paguese.

"Kreditë (Bruto) dhe lizingjet" është zëri i cili shënoi rritjen më të lartë në kuadër të gjithsej mjeteve me rreth 240.2 milion euro ose 16.7 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Ndërmjetësimi financiar nga sistemi bankar, në veçanti aktiviteti kreditues, është një komponent i rëndësishëm në mbështetjen e aktivitetit ekonomik në vend. Kreditimi nga sistemibankar shënoinivel më të lartë rritjeje krahasuar me periudhën e mëparshme. Gjatë vitit 2011, kreditë shënuan rritje vjetore me 16.7 për qind, përderisa në vitin e kaluar rritja ishte 13.5 për qind. Gjithsesi, likuiditeti i mjaftueshëm dhe gjendja e mirë financiare e bankave kanë mundësuar aftësinë e bankave për të rritur nivelin e kredi-dhënies. Rritja më e shpejt e kredive u reflektua në rritjen e pjesëmarrjes së gjithsej kredive (neto) në kuadër të gjithsej mjeteve nga 57.5 për qind sa ishte në vitin 2010në 62.2 për qind në vitin 2011.

Figura 71. Trendi i kredive në sektorin bankar - gjithsej kreditë, në mijëra euro



Burimi: BQK (2012)

Aktiviteti kreditues edhe në vitin 2011 ishte i orientuar drejt kreditimit të sektorit të tregtisë, pjesëmarrja e të cilave në gjithsej kreditë nga sistemi bankar është rritur në 36.2 për qind nga 35.7 për qind sa ishte në vitin 2010. Pasojnë kreditë individuale-konsumuese, pesha e të cilave në gjithsej kreditë po ashtu është rritur në 28.9 për qind nga 26.0 për qind. Në anën tjetër, rënie të pjesëmarrjes në gjithsej kreditë kanë shënuar kreditë për pasuri të patundshme në 8.1 për qind nga 9.1 për qind, ato për shërbime, turizëm, hotelieri në 7.5 për qind nga 8.8 për qind, kreditë e dhëna për prodhimtari në 7.1 për qind nga 8.1 për qind, kreditë për bujqësi në 2.4 për qind nga 2.6 për qind duke vazhduar kështu të kenë pjesëmarrje mjaft të vogël në gjithsej kreditë dhënë ekonomisë së vendit.

Tabelë 17. Kreditë sipas degëve të ekonomisë

Përshkrimi	2010		2011	
	Mijëra euro	Pjesëmarrja (%)	Mijëra euro	Pjesëmarrja (%)
Kreditë për bujqësi	37,718.5	2.6%	40,489.3	2.4%
Miniera	14,629.7	1.0%	17,227.1	1.0%
Prodhimtari	115,198.9	8.0%	119,594.9	7.1%
Energji	26,087.3	1.8%	23,675.3	1.4%
Shërbim, turizëm, hotelieri, restorante	126,268.4	8.8%	125,239.4	7.5%
Komunikim	4,949.0	0.3%	2,467.8	0.1%
Tregti	512,658.7	35.7%	606,970.4	36.2%
Shërbime financiare (të tjera nga kërkesat ndaj bankave)	4,003.5	0.3%	5,065.9	0.3%
Pasuri e patundshme.-ndertimi i pasurise së patundshme	131,244.3	9.1%	135,649.5	8.1%
Kreditë individuale për amvisri, familje & shpenzime tjera personale (kreditë konsumuese)	373,631.8	26.0%	484,929.9	28.9%
Kreditë tjera	89,014.6	6.2%	114,269.9	6.8%
Lizingjet	0.0	0.0%	0.0	0.0%
Gjithsej kreditë dhe lizingjet	1,435,405	100%	1,675,580	100%

Burimi: BQK (2012)

Me gjithë rritjen e kredive, portofoli kreditorë i bankave mbetet i një cilësie të kënaqshme me nivel të kredive joperformuese të menaxhueshme dhe mbulueshmëri të mjaftueshme me provizione për humbje nga kreditë. Në vijim janë të përshkruara ndryshimet e kategorive të cilësisë së portofolit kreditor.

- "kreditë me vonesa[21] gjithsej kreditë" u zvogëluan nga 10.3 për qind sa ishin në vitin e kaluar në 10.0 për qind në vitin 2011,

- "kreditë me probleme[22] gjithsej kreditë" nga 8.5 për qind në 8.3 për qind, si dhe

- "kreditë jopërformuese[23] gjithsej kreditë" nga 5.9 për qind në 5.7 për qind.

Këto zhvillime në cilësinë e kredive kanë ndikuar në rritjen e rezervës për kredi krahasuar me vitin e kaluar për 15.7 milion euro ose për 16.2 për qind.

Struktura e burimeve të financimit të sistemit bankar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shfaq këto zhvillime kryesore :

"Gjithsej Depozitat" shënuan rritje vjetore me rreth 165.9 milion euro ose 8.6 për qind. Depozitat pa interes u zvogëluan për 13.8 milion euro ose 2.6 për qind, ndërsa depozitat me interes u rritën për 179.7 milion euro ose për 12.8 për qind krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të strukturës së depozitave pa interes janë shënuar këto ndryshime: depozitat nga bankat u zvogëluan për 2.0 milion euro ose 57.0 për qind, ato nga individët u rritën për 39.1 milion euro ose 13.7 për qind, ndërsa depozitat nga ndërmarrjet u zvogëluan për rreth 51.0 milion euro ose 21.6 për qind.

Ndërsa, në kuadër të strukturës së depozitave me interes janë shënuar këto ndryshime: depozitat nga bankat u rritën për rreth 5.0 milion euro ose 146.2 për qind, ato nga individët

[21] Kreditë me vonesa përfshijnë kreditë e klasifikuara: vrojtuese, nënstandard, të dyshimta dhe kreditë humbje.

[22] Kreditë me probleme përfshijnë kreditë e klasifikuara: nënstandard, të dyshimta dhe kreditë humbje.

[23] Kreditë jopërformuese përfshijnë kreditë e klasifikuara: të dyshimta dhe kreditë humbje.

për rreth 156.4 milion euro ose 14.9 për qind dhe depozitat nga ndërmarrjet u rritën për 18.3 milion euro ose për 5.2 për qind.

Depozitat vazhdojnë të ruajnë peshën e lartë që pozicioni i tyre ka në kuadër të burimeve të mjeteve. Në vitin aktual pjesëmarrja e gjithsej depozitave në kuadër të burimeve të mjeteve të sektorit bankar evidentohet rreth 83.4 për qind.

"Ekuiteti i aksionarëve" shënoi rritje vjetore me rreth 24.9 milion euro ose 10.8 për qind, duke rritur pjesëmarrjen në kuadër të burimeve të mjeteve të sektorit bankar nga 9.9 për qind sa ishte në vitin e kaluar në 10.2 për qind në vitin aktual.

Kapitali Rregullator – Mjaftueshmëria dhe Trendet

Gjithsej kapitali rregullator[24] në sistemin bankar vijoi me trend të rritjes edhe në vitin 2011. Vlera e gjithsej kapitalit rregullator raportohet rreth 300.3 milion euro, që paraqet një rritje vjetore në shumë prej 29.0 milion euro ose 10.7 për qind. Në rritjen e kapitalit ndikim kryesor kanë pasur fitimet e realizuara gjatë vitit në vlerë prej 37.0 milion euro. Në vitin 2011 dy bankashpërndanë dividendë nga fitimet e mbajtura në vlerë prej 20.0 milion euro nga të cilat 7.5 milion euro u ri-kapitalizuan.

Figura 72. Trendi i depozitave në sektorin bankar - gjithsej depozitat, në mijëra euro



Burimi: BQK (2012)

Treguesit kryesorë të mjaftueshmërisë së kapitalit vazhduan të jenë dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar nga kuadri rregullativ. Përveç rritjes së fitimeve, ruajtja e nivelit të kapitalit u ndikua edhe nga shtimi i kapitalit të ri në vlerë prej rreth 1.1 milion euro.

Sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme, cilësia e kapitalit përkon me pjesëmarrjen më të theksuar të kapitalit të klasit të parë, i cili në vitin 2011 shënoi rritje për 6.2 milion euro ose për 3.7 për qind. Fitimi neto i sistemit bankar ishte 37.0 milion euro, i cili është më i lartë se ai i vitit 2010 për 4.2 milion euro ose 12.8 për qind.

Cilësia e kapitalit të përgjithshëm konsiderohet e kënaqshme. Kapitali i klasit të parë përbënë rreth 84.0% të kapitalit rregullator, përderisa pjesëmarrja e kapitalit të klasit të dytë evidentohet rreth 16.0%. Rritja e kapitalit të klasit të parë rrjedh kryesisht nga bankat e mëdha (G1), me një rritje prej rreth 20.2 milion euro. Tri bankat e grupit (G2) kanë pasur rritje të kapitalit të klasit të parë me rreth 4.6 milion euro, ndërsa për degët e bankave të huaja që veprojnë në Kosovë G3 rritja ka qenë vetëm 278.3 mijë euro.

[24] Kapitali rregullator = kapitali i klasit të parë + kapitali i klasit të dytë

Tabelë 18. Struktura e kapitalit rregullator dhe ecuria e komponentëve të tij

Përshkrimi	2010		2011	
	Mijëra euro	Pjesëmarrja (%)	Mijëra euro	Pjesëmarrja (%)
Kapitali (Kapitali aksionar, teprica, akc. e pref)	170,402	62.8%	176,574	58.8%
Fondet rezervë	622	0.2%	606	0.2%
Fitimi (humbja) për vitin e aktual	32,841	12.1%	37,044	12.3%
Fitmi i pas shpërndarë nga vitet paraprake	26,642	9.8%	41,933	14.0%
Mjetet jo materiale dhe vlera e emrit të mirë	3,243	1.2%	3,821	1.3%
Gjithsej kapitali i klasit të I-rë (I)	227,264	83.8%	252,337	84.0%
Provizioni i përgjithshëm për kreditë	12,711	4.7%	16,491	5.5%
Aksionet e preferuara të rëndomta	0	0.0%	0	0.0%
Aksionet e preferuara të afatizuara	0	0.0%	0	0.0%
Borxhet e varura	31,045	11.4%	31,045	10.3%
Instrumente tjera	298	0.1%	442	0.1%
Gjithsej kapitali i klasit të dytë (II)	44,054	16.2%	47,979	16.0%
Gjithsej kapitali (I+II)	271,318	100%	300,316	100%

Burimi: BQK (2012)

Niveli i kapitalit të bazuar në rrezik, përkatësisht "gjithsej kapitali / gjithsej mjetet e rrezikuara" në vitin 2011 ishte 17.6 për qind nga 18.6 për qind sa ishte në vitin 2010. Rënia e këtij treguesi i atribuohet rritjes më të shpejt të gjithsej mjeteve të rrezikuara krahasuar me rritjen e gjithsej kapitalit. Përderisa gjithsej mjetet e rrezikuara evidentuan rritje me rreth 254.3 milion euro ose 17.5 për qind (si rezultat i rritjes së nivelit të kredive dhe letrave me vlerë), gjithsej kapitali u rrit me rreth 29.0 milion euro ose 10.7 për qind krahasuar me vitin e kaluar.

Tabelë 19. Treguesit e kapitalizimit, në përqindje

Treguesit	Dhjetor 2010	Mars 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Dhjetor 2011
Gjithsej kapitali / Gjithseh mjetet e rrezikuara	18.6	18.1	17.2	17.1	17.6
Ekuiteti I aksionarëve / Gjithsej mjetet	9.9	10.1	10.2	9.8	10.2
Kreditë me probleme (neto) / Kapitali i klas. të I-rë	17.1	18.4	16.7	17.4	16.7

Burimi: BQK (2011)

Megjithatë, niveli i kapitalit të bazuar në rrezik prej 17.6 për qind mbetet ndjeshëm mbi nivelin rregullativ prej 12 për qind.

Pesha e kredisë neto me probleme ndaj kapitalit të klasit të parë përllogaritet 16.7 për qind nga 17.1 për qind sa ishte në fund të vitit të kaluar. Rënia e këtij treguesi është rrjedhojë e rritjes më të shpejt të kapitalit të klasit të parë (me 11.0 për qind) krahasuar me rritjen e kredisë neto me probleme (me 8.5 për qind). Për rrjedhojë, aftësia e sistemit bankar për të absorbuar humbjet potenciale nga kreditë me probleme rezulton të jetë rritur gjatë 2011.

Raporti "'ekuiteti i aksionarëve / gjithsej mjetet" si indikatorë i nivelit të mbështetjes së mjeteve nga ekuiteti i aksionarëve ka shënuar trend të rritjes. Rritja e këtij treguesi nga 9.9 për qind në 10.2 për qind do të thotë se sistemi bankar është mbështetur më pak në borxh për financimin e mjeteve, duke shtuar aftësinë e sistemit në përballimin e rreziqeve të mundshme financiare përmes kapitalit. Ky ndryshim rezultoi kryesisht nga rritja e ekuitetit të aksionarëve me një ritëm më të shpejtë, përkatësisht rritje për 24.9 milion euro

ose 10.8 për qind krahasuar me ritmin e rritjes së gjithsej detyrimeve me rreth 163.0 milion euro ose 7.8 për qind krahasuar me vitin e kaluar.

Cilësia e kredive

Viti 2011 prezantoi rritje më të shpejt të kredi-dhënies e cila përllogaritet rreth 240.2 milion euro ose 16.7 për qind, krahasuar me rritjen prej 170.4 milion euro ose 13.5 për qind në vitin paraprak. Rritja e nivelit të kredisë u ndikua kryesisht nga bankat e mëdha (G1), pasuar nga bankat e vogla të grupit G2 dhe degët e bankave të huaja të grupit G3, përkatësisht rritje për 114.4 milion euro (8.0 për qind), 80.9 milion euro (5.6 për qind) dhe 44.9 milion euro (3.1 për qind).

Tabelë 20. Treguesit e cilësisë së kredive, në përqindje

Treguesit	Dhjetor 2010	Mars 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Dhjetor 2011
Kreditë me vonesa / Gjithsej kreditë	10.3	11.3	10.7	10.7	10.0
Kreditë me probleme / Gjithsej kreditë	8.5	8.9	8.2	8.5	8.3
Kreditë joperformuese / Gjithsej kreditë	5.9	6.2	5.9	6.0	5.7
Rezervat për humbjet nga kreditë / Kreditë jopërformuese	114.4	114.7	115.4	117.2	117.0

Burimi: BQK (2012)

Treguesit "kredi me probleme / gjithsej kredi" dhe "kredi joperformuese / gjithsej kredi" shënuan nivelet prej 8.3 për qind dhe 5.7 për qind në vitin 2011 nga nivelet prej 8.5 për qind dhe 5.9 për qind sa ishin në vitin 2010. Përmirësimi i cilësisë së portofolit kreditor ndikoi në rritjen e shkallës së mbulueshmërisë së kredive joperformuese nga rezervat për humbjet nga kreditë në 117.0 për qind nga 114.4 për qind sa ishte në vitin 2010. Ky është një tregues i kujdesit të shtuar në trajtimin e kredive joperformuese përmes mbulueshmërisë me rezerva për humbje nga kreditë.

Figura 73. Pjesëmarrja e kredive problematike dhe kredive jopërformuese në gjithsej kreditë, në përqindje



Burimi: BQK (2012)

Nga analiza e cilësisë së kredive në bazë të sektorëve të kredituar evidentohet se nuk është shënuar ndonjë ndryshim i madh në fund të vitit 2011 krahasuar me fundin e vitit 2010. Niveli më i lartë i kredive joperformuese vazhdon të shfaqet tek kreditë për tregti, pjesëmarrja e të cilëve në gjithsej kreditë e sistemit bankar është rritur në 3.1 për qind nga 2.9 për qind sa ishte në vitin e kaluar.

Tabelë 21. Kreditë joperformuese sipas degëve të ekonomisë

Përshkrimi	2010	2011
	Pjesëmarrja (%)	Pjesëmarrja (%)
Kreditë për bujqësi	0.10	0.06
Miniera	0.08	0.02
Prodhimtari	0.97	0.92
Energji	0.04	0.03
Shërbim, turizëm, hotelieri, restorante	0.70	0.70
Komunikim	0.00	0.00
Tregti	2.87	3.09
Shërbime financiare (të tjera nga kërkesat ndaj bankave)	0.01	0.01
Pasuri e patundshme.-ndertimi i pasurise së patundshme	0.40	0.29
Kreditë individuale për amvisri, familje & shpenzime tjera personale (kreditë konsumuese)	0.48	0.42
Kreditë tjera	0.23	0.24
Lizingjet	0.00	0.00
Gjithsej kreditë dhe lizingjet	5.90	5.79

Burimi: BQK (2012)

Profitabiliteti i sistemit bankar

Përformanca e sistemitbankar gjatë vitit 2011, në këndvështrimin e fitimit neto prezantohet me ritme më të larta rritjeje krahasuar me vitin 2010. Fitimi neto i realizuar gjatë vitit 2011 në vlerë prej 37.0 milion euro ka qenë rreth 4.2 milion euro ose 12.8 për qind më i lartë, ku rritja e aktivitetit bankar ka qenë përcaktuese. Vetëm në tremujorin e katërt është realizuar rreth 33.6 për qind e gjithsej rezultatit neto të gjithë vitit 2011. Treguesit kryesorë të profitabilitetit, respektivisht kthimi nga mjetet mesatare (anglisht: Retunr on Average Assets – ROAA) ruajti nivel të njëjtë sikurse në vitin e kaluar prej 1.5 për qind, ndërsa kthimi nga ekuiteti mesatar (anglisht Return on Average Equity – ROAE) evidentoi rritje nga 14.8 për qind sa ishte në vitin e kaluar në 15.3 për qind në vitin aktual.

Tabelë 22. Treguesit e profitabilitetit (të përvitësuar), në %

Treguesit	Dhjetor 2010	Mars 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Dhjetor 2011
Kthimi nga mjetet mesatare (ROAA)	1.5	0.9	1.3	1.4	1.5
Kthimi nga ekuiteti mesatar (ROAE)	14.8	9.1	12.6	13.7	15.3
Margjina neto e interesit (MNI)	6.4	6.1	6.3	6.3	6.4
Të ardhurat neto nga interesi / Shpenzimet e përgjithshme	137.0	145.0	142.8	144.3	141.2

Burimi: BQK (2012)

Analiza e treguesit të ROAA-së sipas grup-bankave, tregon një rentabilitet më të lartë të bankave të mëdha (G1) kundrejt dy grupeve të tjera (G2 dhe G3). Treguesi i ROAA-së për G1 përllogaritet rreth 1.8 për qind duke shënuar një rënie të lehtë krahasuar me atë të periudhës paraprake 1.9 për qind. Për bankat e G2 dhe G3, ROAA prezantohet në nivelet 0.8 për qind (nga 0 për qind) dhe 0.2 për qind (nga 0.4 për qind). Marzha neto nga interesat

(MNI)[25] mbeti në nivel të njëjtë sikurse në vitin e kaluar prej 6.4 për qind. Niveli i lartë i treguesit të efikasitetit[26] prej 141.2 për qind tregon për efikasitet të lartë në mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme nga të hyrat neto nga interesi. Profitabilitetiti i lartë i bankave vazhdon të siguroj mbështetjen kryesore dhe qëndrueshmërinë e kapitalit.

Likuditeti i sistemit bankar

Sistemi bankar vazhdon të ketë gjendje të kënaqshme të likuiditeti edhe pse treguesit kryesorë të likuiditetit krahasuar me vitin e kaluar reflektuan tendencë të rënies. Treguesit, "mjetet likuide / gjithsej mjetet" dhe "mjetet likuide / gjithsej depozitat" përllogariten 32.5 dhe 39.0 për qind nga nivelet 37.3 dhe 45.0 për qind sa ishin në vitin e kaluar. Prirja rënëse e treguesve është rezultat i zhvillimeve që kanë përfshirë sisteminbankar gjatë këtij viti, ku gradualisht është kaluar nga investimet në mjete likuide të cilat konsiderohen përgjithësisht me rrezik të ulët, drejt investimeve në mjete afatgjata me rrezik më të lartë, por edhe me një marzhë fitimi më të lartë, siç janë kreditë. Gjithashtu, faktor tjetër ndikues në rënien e treguesve të likuiditetit ishte edhe rritja më e ngadaltë e depozitave.

Tabela 23. Treguesit e likuiditetit (në %)

Treguesit	Dhjetor 2010	Mars 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Dhjetor 2011
Kredi / Depozita	74.3	77.9	82.2	77.9	79.9
Mjete likuide / Gjithsej mjete	37.3	35.3	30.6	33.4	32.5
Mjete likuide / Gjithsej depozita	45.0	43.0	37.1	39.6	39.0
Mjete likuide / Gjithsej detyrime	41.4	39.3	34.1	37.1	36.2

Burimi: BQK (2012)

Raporti kredi – depozita, ndër indikatorët e rëndësishëm të likuiditetit, është rritur gjatë vitit 2011 nga 74.3 për qind në 79.9 për qind, si rrjedhojë e rritjes së kredive me një ritëm më të shpejt krahasuar me rritjen e depozitave. Përderisa kreditë shënuan rritje për 16.7 për qind, depozitat u rritën me rreth 8.6 për qind. Sipas grup-bankave evidentohet rritje e depozitave në të tre grupet, përkatësisht me rreth 78.0 milion euro në G2, 64.7 milion euro në G3 si dhe 23.2 milion euro në G1. Gjatë vitit 2011, të gjitha bankat kanë qenë në përputhje të plotë me rregullën e BQK-s, që përcakton kërkesën mbi minimumin e mbajtjes së rezervës së likuiditetit.

Ekzaminimet në vend

Vazhdimi i rritjes së portofolit kreditorë me ritme të theksuara dhe përshtatshmëria e kapaciteteve menaxhuese ndaj rreziqeve bankare, e veçanërisht të rrezikut kreditorë, kanë qenë pikë referimi e aktivitetit mbikëqyrës. Për më tepër, vëmendje më e theksuar i është kushtuar profilizimit të grupit të bankave, përkatësisht efekteve potenciale nga profili i konsoliduar i rrezikut të grupit bankar, pjesë e së cilit janë filialet dhe degët e bankave në Kosovë.

Në realizimin e kësaj qasjeje, gjatë vitit 2011 janë kryer më shumë ekzaminime të fokusuara në segmente të caktuara të rrezikut të bankave dhe vlerësimit të pajtueshmërisë me kuadrin rregullativ dhe ligjor. Për më tepër, ekzaminimet e plota janë shtrirë edhe në

[25] MNI = Neto të hyrat nga interesi / Mjetet mesatare fitimprurëse

[26] Treguesi i efikasitetit = Të ardhurat neto nga interesi / Shpenzimet e përgjithshme

vlerësimin e segmentit të 'ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut' si komponentë i shtuar në vlerësimin e përgjithshëm, përkatësisht në përcaktimin e profilit të rrezikut të bankave.

Gjatë vitit 2011 janë realizuar nëntë (9) ekzaminime në banka, nga të cilat katër (4) të plota dhe pesë (5) të fokusuara.

Tabela 24. Ekzaminimet në banka

Ekzaminimet e plota dhe të fokusuara	Ekzaminimi i plotë	Ekzaminimi I fokusuar
Bankat	4	5

Burimi: BQK (2012)

Sistemi mikrofinanciar dhe jo bankar[27] - Karakteristikat e pergjithëshme

Institucionet mikrofinanciare mbeten akterë aktivë në ndërmjetësimin financiar, në kreditimin e shtresave me të ardhura të vogla, ekonomive familjare dhe bizneseve individuale që jo lehtësisht gjejnë qasje në burime të financimit.

Gjatë 2011 sistemi mikrofinanciar dhe jo-bankar përbëhej nga pesëmbëdhjetë (15) institucione mikrofinanciare, pesë (5) institucione financiare jo-bankare që ushtrojnë veprimtarin financiare të kreditimit (dy (2) nga të cilët ofrojnë produktin e lizingut financiar), katër (4) institucione financiare jo-bankare të tranferit të parave dhe njëzet e gjashtë (26) zyre të këmbimit të valutave.

Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare të kreditimit në vitin 2011 pasqyruan rënie të lehtë të gjithsej mjeteve për dallim nga rritja e tyre përgjatë vitit 2010. Shuma e gjithsej mjeteve të këtij sistemi arriti në 121.9 milion euro, ose 2.2 për qind më e vogël krahasuar me rritjen vjetore prej 0.8 për qind në vitin 2010. Rënia e gjithsej mjeteve i referohet kryesisht zvogëlimit/kthimit të huamarrjeve kreditorëve në dy institucionet më të mëdha mikrofinanciare.

Sistemimikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me shkallë të latë të përqendrimit ku rreth 57.7 për qind e gjithsej mjeteve menaxhohen nga katër institucione mikrofinanciare. Megjithatë, në vitin 2011 evidentohet rënie e shkallës së përqendrimit krahasuar me vitet paraprake prej 67.4% në 2010, përkatësisht 75.0% në 2009, i cili nxit konkurrencën ndërmjet këtyre institucioneve.

Figura 74. Ecuria e gjithsej mjeteve në sektorin mikrofinanciar dhe jobankar kreditues, në mijëra euro



Burimi: BQK (2012)

Mjetet në këtë sektor financohen kryesisht nga huamarrjet të cilat përbëjnë rreth 67.9 për qind dhe ekuiteti prej 32.1 për qind të gjithsej mjeteve. Krahasuar me vitin 2010 detyrimet në raport me gjithsej mjetet kanë rënë për 4.1 pikë përqindje,

[27] Përfshijnë :
- Institucionet jo-bankare të cilat aktivitet kanë kreditimin - përfshirë edhe lizingun financiar,
- Agjencionet për transfer të parave,
- Zyrat për këmbimin e valutave

respektivisht për të njëjtën pikë përqindje është ngritur pjesëmarrja e ekuitetit. Detyrimet gjatë vitit 2011 shënuan rënie vjetore rreth 7.0 milion euro ose 7.8 për qind, përderisa ekuiteti është rritur për 4.2 milion euro ose 12.3 për qind.

Aktiviteti i këtyre institucioneve vazhdon të jetë i përqendruar në kreditimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Portofoli i kredive në fund të vitit 2011 është në shumë prej 104.4 milion euro, që paraqet një rënie vjetor prej 12.4 milion euro ose 10.6 për qind krahasuar me rritjen vjetore prej 6.8 për qind në vitin 2010. Gjithashtu, nga vitit 2010 në 2011 kreditë bruto kanë zvogëluar peshën e tyre në kuadër të gjithsej mjeteve për 7.7 pikë përqindje. Në strukturën e gjithsej mjeteve kreditë neto në shumë prej 98.8 milion euro marrin pjesë me 81.0 %, duke shënuar rënie prej 11.9 milion euro nga viti 2010. Aktualisht kreditë e këtij sistemi përbëjnë vetëm 6 % të gjithsej kredive të sektorit financiarë.

Cilësia e kredive

Treguesit e cilësisë së portofolit kreditor kanë pasur ecuri të përafërt me vitin paraprak. Raporti i kredive me probleme ndaj gjithsej kredive dhe raporti i kredive jopërformuese ndaj gjithsej kredive pasqyrohet në nivelet prej 4.8 për qind dhe 3.8 për qind, përderisa në fund të vitit 2010 ishte 4.6 për qind, përkatësisht 3.9 për qind. Rezervat për humbjet nga kreditë në raport me gjithsej kreditë sillen në nivele prej 5.3 për qind, nivel i ngjashëm me vitin 2010. Në dhjetor 2011 shkalla e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me rezerva për humbjet nga kreditë arrin në 138.0% nga 136.0% sa ishte vitin e kaluar duke prezantuar raport të kënaqshëm të mbulueshmërisë.

Tabela 25. Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë (dhjetor 2010 – dhjetor 2011)

Treguesit	Dhjetor 2010	Mars 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Dhjetor 2011
Kreditë me probleme / Gjithsej kreditë	4.6	4.7	5.3	6.6	4.8
Kreditë joperformuese / Gjithsej kreditë	3.9	3.9	4.5	5.5	3.8
Rezervat për humbjet nga kreditë / Kreditë jopërformuese	136.0	148.1	137.7	128.7	138.0

Burimi: BQK (2012)

Profitabiliteti i sistemit mikrofinanciar

Sistemi mikrofinanciar dhe jobankar kreditues gjatë vitit 2011 ka gjeneruar fitime neto në shumë prej 449 mijë euro, përderisa në fundvitin 2010 përformanca financiare ishte negative – humbje në vlerë prej 3.0 milion euro. Te ardhurat neto nga interesi si dhe shpenzimet e përgjithshme në vitin 2011 kanë shfaqur nivele të ngjashme me ato të vitit 2010, që do të thotë se profitabiliteti i sektorit konsiston kryesisht nga zvogëlimi i shpenzimeve të provizioneve për humbjet nga kreditë.

Treguesit kryesor të profitabilitetit evidentojnë përmirësim të theksuar krahasuar me vitin 2010. Kthimi nga mjetet mesatare (ROAA) dhe kthimi nga ekuiteti mesatar (ROAE) shënojnë nivele pozitive prej 0.4 për qind dhe 1.3 për qind nga minus 1.6 për qind, respektivisht minus 5.5 për qind sa ishin në vitin 2010. Marzha neto nga interesi historikisht ka qenë mjaft e lartë në këtë sektor dhe në fund të vitit 2011 arrin në nivel prej 15.5 për qind, niveli më i lartë i shfaqur gjatë tri viteve të fundit. Treguesi i efikasitetit prej 107.4 për qind sillet në nivel të përafërt me vitin 2010.

Tabela 26. Ecuria treguesit të profitabilitetit (dhjetor 2010 – dhjetor 2011)

Treguesit	Dhjetor 2010	Mars 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Dhjetor 2011
Kthimi nga mjetet mesatare (ROAA)	-1.6	0.3	1.2	0.7	0.4
Kthimi nga ekuiteti mesatar (ROAE)	-5.5	1.1	3.9	2.3	1.3
Margjina neto e interesit (MNI)	14.5	14.1	14.1	14.3	15.5
Të ardhurat neto nga interesi / Shpenzimet e përgjithshme	104.4	108.7	108.5	105.8	107.4

Burimi: BQK (2012)

Agjensionet për transfer të parave dhe zyret e këmbimit të valutave

Përveç institucioneve financiare jobankare kredidhënëse ekzistojnë edhe tridhjetë (30) institucione tjera financiare jo-bankare, prej të cilave katër (4) janë agjensione për transfer të parave dhe njëzet e gjashtë (26) zyre të këmbimit valutor.

Përmes agjensioneve për transfer të parave në vitin 2011 janë transferuar 246.3 milion euro ose 6.26 për qind më shumë se në vitin 2010. Nga kjo shumë 89.4 për qind janë transfere hyrëse në Kosovë.

Ekzaminimet në Vend

Gjatë vitit 2011 është rritur numri dhe shpeshtësia e ekzaminimeve në institucionet mikrofinanciare dhe jo-bankare. Gjithsej, janë kryer tetë (8) ekzaminime të plota dhe njëzet e e nëntë (29) ekzaminime të fokusuara. Në fokus të aktivitetit mbikëqyrës kanë qenë kryesisht përshtatshmëria e qeverisjes së institucioneve si një ndër mangësitë më të theksuara, pajtueshmëria me kornizën rregullative, rreziku kreditorë – përshtatshmëria e njohjes dhe provizionimit të portofolit kreditorë.

Tabela 27. Ekzaminimet e kryera gjatë vitit 2011

Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare- Ekzaminimet e plota dhe të fokusuara		
Përshkrimi	I plotë	I fokusuar
Institucionet mikrofianciare	5	
Institucionet financiare jobankare:		
Kreditore		1
Agjesionet për transfer të parave		1
Zyret për këmbimimin e valuatve	3	26
Gjithsej	8	28

Burimi: BQK (2012)

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Pjesë e rëndësishme e mbikëqyrjes edhe gjatë vitit 2011 ka qenë vetëdijesimi i sektorit privat dhe publik mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (tani e tutje "PPP&FT"), përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe strukturës raportuese në funksion të PPP&PFT.

BQK-ja ka dhënë kontribut thelbësorë në vetëdijesimin e sektorit privat dhe publik mbi PPP&FT me anë të prezantimeve të ndryshme nga stafi profesional i Departamentit të

Mbikëqyrjes Bankare në tryeza diskutimi dhe organizime të shumta në bashkëpunim me Policinë e Republikës së Kosovës, Shoqatën e Bankave, Departamentin e Thesarit Amerikan, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian dhe palë tjera të interesit. Në këtë pikë, BQK ka shpërndarë të gjithë informacionin e nevojshëm të nivelit ndërkombëtarë institucioneve të mbikëqyra në nivel të rezolutave të nxjerra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara ndaj individëve, entiteteve dhe shteteve me të cilat është ndaluar aktiviteti financiar ose ndaj të cilave është kërkuar vëmendje më e theksuar.

Sa i përket infrastrukturës ligjore, BQK-ja ka luajtur rol të rëndësishëm në identifikimin e zbrazëtirave ligjore dhe përshtatshmërisë së Ligjit Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të dekretuar në vitin 2008. Për plotësimin e këtij ligji gjatë vitit 2011 është formuar grupi punues në të cilin BQK-ja ka qenë e përfshirë së bashku me Ministrinë e Financave, Njësinë për Inteligjencë Financiare të Republikës së Kosovës, Misionin e Sundimit të Ligjit të BE (EULEX)dhe Asistencën Teknike të Departamentit të Thesarit Amerikan. Në këtë periudhë, përveç tjerash, BQK-ja gjithashtu ka freskuar formularin (si formë standarde) për përdorim nga institucionet financiare për identifikimin e prejardhjes së fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të pronësisë së bashku me udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij formulari.

Mbikëqyrja, përveç ekzaminimeve të përgjithshme periodike në banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jo-bankare ka kryer edhe ekzaminime të veçanta me fokus në pajtueshmërinë me legjislacionin për PPP&FT. Nga këto ekzaminime është evidentuar se institucionet e lartpërmendura kanë avancuar infrastrukturën e nevojshme në funksion të PPP&FT si politikat, procedurat dhe sistemet në identifikimin, njohjen dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta dhe përgjithësisht në adresimin e kësaj fushe të ndjeshme si në rrafshin vendorë e gjithashtu edhe në atë ndërkombëtarë. Megjithatë, janë identifikuar çështje për vëmendje më të theksuar të institucioneve financiare bankare dhe jo-bankare në drejtim të avancimit të kapaciteteve njerëzore dhe sistemeve për pajtueshmëri në PPP&FT, e që mbeten subjekt monitorimi i vazhdueshëm nga BQK në kursin e rregullt të mbikëqyrjes në vend dhe monitorimit nga jashtë.

Pajtueshmëria me kornizën rregullative dhe ligjore – verpimet detyruese

Ekzaminimet në vend, të nivelit të plotë dhe të fokusuar, në banka dhe institucione financiare jo-banka kanë identifikuar raste të mospajtushmërisë me kornizën rregullative ligjore. Ndër mangësitë më të theksuara që janë identifikuar në kursin e ekzaminimeve, përkojnë me qeverisjen e institucioneve, rrezikun kreditorë, tejkalime kufizimesh në ekspozimet me rrezik kreditorë dhe në përshtatshmërinë e raportimeve.

Rastet e identifikuara janë përcjellë me veprime administrative dhe detyrimore ndaj subjekteve të mbikëqyra dhe rregulluara nga BQK. Ndër veprimet administrative të ndërmarra janë veprimet e vërejtjeve drejtuar strukturave menaxhuese dhe të kontrollit, gjoba administrative dhe monetare si dhe masa e administrimit të përkohshëm në institucionin mikrofinanciarë KEP Trust.

Administrimi i institucionit mikrofinanciar “KEP TRUST”

Ekzaminimi në KEP Trust, në tremujorin e fundit të 2010 pati ritheksuar mangësitë e evidentuara më parë (2009), e që kryesisht kishin të bënin me qeverisjen e institucionit. Këto mangësi, të bartura në një hark kohorë të konsiderueshëm, në fund të vitit 2010 rezultuan në mungesën e autorizimeve, përkatësisht të legjitimitetit të strukturave të kontrollit dhe menaxhimit të institucionit mikrofinanciar KEP Trust. E gjithë kjo

problematikë u ritheksua më tepër nga pozicionimi i distancuar, mungesa e konsensusit e me vonë braktisja e institucionit nga vetë themeluesit e tij duke shpërbërë kështu të gjithë strukturën e nevojshme qeverisëse.

Rrjedhimisht, me qëllim të evitimit të dobësive të evidentuara dhe ruajtjes së aftësisë së likuiditetit dhe solvencës së institucioni, BQK-ja në fillim të vitit 2011 ishte e detyruar të caktoj masën e administrimit të përkohshëm.

Sipas termave të angazhimit, nga administratori i përkohshëm, përveç drejtimit të institucionit me të gjitha të drejtat ekzekutive, kërkohej që brenda tre muajve nga emërimi të vazhdoi përpjekjet me themeluesit për rivendosjen e strukturave qeverisëse në institucion. Në pamundësi të realizimit të objektivit kryesorë brenda kësaj periudhe, administrimi i përkohshëm u vazhdua disa herë, deri në takimin e organizuar nga BQK me të gjithë palët e interesit të institucionit nën administrim, në tetor të 2011. Ky takim rezultoi me marrëveshje mes themeluesve për zgjedhjen e bordit drejtues të ri.Masa e administrimit të përkohshëm u përfundua në nëntor 2011 pas rezultateve pozitive të testit të përshtatshmërisë së anëtarëve të bordit drejtues të nominuar nga themeluesit dhe emërimit të drejtorit menaxhues. Rrjedhimisht, e drejta ekzekutive u bartë nga administratori tek bordi i ri drejtues.

Përfundimi me sukses i gjithë këtij procesi ritheksoi rëndësinë e veprimeve të shpejta dhe të koordinuara mirë nga BQK. Institucioni mikrofinanciar KEP Trust gjatë procesit të administrimit arriti të ruaj vazhdimësinë duke përmbushur obligimet kontraktuale ndaj kreditorëve, ruajtjen e niveleve të likuiditetit, cilësisë së portofolit kreditorë dhe kapitalit, e si rezultat i krejt kësaj, ruajtjes së reputacionit të sektorit financiar.

Ecuria e procesit të likuidimit të Bankës Kreditore të Prishtinës

Procesi i likuidimit të Bankës Kreditore të Prishtinës ka vijuar edhe gjatë vitit 2011. Procesi i likuidimit është mundësuar nga arkëtimet e kredive. Gjatë vitit 2011 nga kreditë janë arkëtuar gjithsej 962,887 euro dhe si rezultat i kësaj, deri në fund vitin 2011 janë rimbursuar gjithsej 53.22% e shumës së depozitave, përkatësisht 99.80% e numrit të llogarive të depozitave. Perspektiva e procesit të likuidimit është e lidhur ngushtë me efikasitetin e arkëtimeve nga kreditë, arkëtimeve sekondare nga kolateralet si dhe nga blerës potencial të portofolit kreditorë të mbetur.

Tabela 28. Kreditë – trendi i arkëtimeve

Përshkrimi	Numri i llogarive	Shuma	Ndryshimi në llogari		Ndryshimi në shumë	
			Numri	Përqind	Nr	Përqind
Kreditë me 13.03.2006		28,438,587				
Kreditë 01.01.2011		23,277,414			5,161,173	18.15%
Kreditë 31.12.2011		22,497,071			5,941,516	20.89%
Arkëtimet gjatë 2011		962,887			962,887	3.39%

Burimi: BQK (2012)

Tabela 29. Depozitat – trendi i rimbursimeve

Përshkrimi	Numri i llogarive	Shuma	Ndryshimi në llogari		Ndryshimi në shumë	
			Numri	Përqind	Shuma	Përqind
Depozitat me 13.03.2006	35529	33,454,222				
Depozitat 01.01.2011	76	16,418,553	35453	0.9979	17,035,669	50.92%
Depozitat 31.12.2011	76	15,649,533	35453	0.9979	17,804,689	53.22%
Arkëtimet gjatë 2011						

Burimi: BQK (2012)

4.3. Mbikëqyrja e sigurimeve

Kompanitë e sigurimeve, struktura e pronësisë

Gjatë vitit 2011, numri i kompanive të sigurimit që operuan në Kosovë ishte trembëdhjetë (13) ku dhjetë (10) prej tyre ofrojnë produkte jo-jetë, ndërsa tre (3) kompani operojnë në treg me produktet e sigurimit të jetës.

Figura 75. Struktura e pronësisë së kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2012)

Nëse marrim në konsideratë strukturën e kompanive të sigurimit sipas pronësisë gjatë vitit 2011 delse në tregun e sigurimeve të Kosovës nuk ka pas ndonjë ndryshim të theksuar në krahasim me vitin e kaluar. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2011, tregut të sigurimeve të Kosovës i janë shtuar edhe dy kompani të cilat operojnë me produkte të jetës kunjëra është me kapital të përzier (pjesa më e madhe është me kapital të huaj) ndërsa tjetra me 100 % me kapital të huaj.

Siç shihet nga figura e mësipërme, nga gjithsej numri i kompanive të cilat operojnë në industrinë e sigurimeve, shtatë (7) kompani ishin me pronësi të huaj, dy (2) kompani me pronësi të përzier, tre (3) prej tyre janë kompani të sigurimit tërësisht me pronësi vendore dhe një (1) kompani është vartëse.

Struktura e portofolios së sigurimeve - Numri dhe shuma e kontratave (policave)

Numri total i policave të shkruara gjatë vitit 2011 ishte 604,735 ose 12% më shumë se në vitin 2010.

Tabela 30. Numri i Policave të Shkruara

Periudha: Janar - Dhjetor	Numri i Polisave		Ndryshimi	Pjesa ndaj totalit	
	2010	2011		2010	2011
Sigurime të detyrueshme	258,022	285,900	10.80%	47.64%	47.28%
Sigurime vullnetare	89,916	98,862	9.95%	16.60%	16.35%
Sigurime kufitare	192,801	219,343	13.77%	35.60%	36.27%
Sigurime të Jetës	813	630	-22.51%	0.15%	0.10%
Gjithsej	541,552	604,735	11.67%	100%	100%

Burimi: BQK (2012)

Struktra e portofolios së produkteve të sigurimit në numër për vitin 2011 karakterizohet me 47.64% polica të produkteve të sigurimit të detyrueshëm nga auto – përgjegjësia, 36.27% polica të sigurimit kufitar dhe 16.35% polica të sigurimit vullnetar.

Për shkak të kërkesës së ulët për produktet e sigurimit të jetës, vërehet një rënie e konsiderueshme në numrin e policave të shkruara për produktet e sigurimit të jetës (-23%) e cila reflekton edhe në rënien e këtyre produkteve në pjesëmarrjen totale të portofolios se policave të shkruara për vitin 2011 (0.15 % e portofolios së policave për vitin 2011 dhe 0.10 % për vitin 2010)

Tabela 31. Bruto Primet e Shkruara

Periudha: Janar - Dhjetor	Bruto Primet e Shkruara		Ndryshimi në %	Pjesa ndaj totalit	
	2010	2011		2010	2011
Auto përgjegjësia	40,926,008	43,950,031	7.39%	56.55%	58.52%
Sigurimet Kufitare	10,491,743	9,526,802	-9.20%	14.50%	12.69%
Sigurimet Vullnetare	20,244,145	21,623,327	6.81%	27.97%	28.79%
Sigurimet e Jetes	704,885	1,040,715	47.64%	0.97%	1.39%
Bruto Primet e Shkruara	72,366,781	75,100,161	3.78%	100%	100%

Burimi: BQK (2012)

Gjatë vitit 2011, vlera e buro primeve të shkruara mbërriti në 75,100,161 euro. Nga gjithsej bruto primet e shkruara, 58.52% të primit rezulton nga sigurimi i detyrueshëm i auto përgjegjësisë, pastaj 28.79% nga sigurimet vullnetare, 12.69% nga sigurimet kufitare dhe vetëm 1.39% nga sigurimet e jetës.

Sigurimet e jetës akoma mbeten të ulëta krahas produkteve tjera të sigurimeve jo – jetë. Ky treg, edhe pse ka shënuar një ngritje modeste në vlerë të primeve të shkruara jete, pjesëmarrja e tyre vlerësohet si pjesëmarrje e vogël dhe në gjithsej bruto primin e shkruar përbën vetëm 1.39% për vitin 2011.

Është tregues pozitiv ngritja e pjesëmarrjes së produkteve vullnetare në bruto primin e shkruar për 36.27%. Një ndër faktorët kryesor të cilët kanë ndikuar në ngritjen e këtyre produkteve është kërkesa e kompanive të cilat operojnë në Kosovë për këto produkte.

Gjithashtu vlen të theksohet se gjatë vitit 2011 ka pasur një rritje të numrit të policave të sigurimit kufitar dhe rënie në vlerën e këtyre policave si rezultat i zvogëlimit të tarifave të sigurimit kufitar nga BQK në fundtë vitit 2010.

Numri dhe vlera e dëmeve të paguara

Gjatë vitit 2011 numri i dëmeve të paguara ka shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar, rritjen më të madhe e kanë shënuar sigurimet vullnetare.

Tabela 32. Numri i Dëmeve të paguara

Periudha: Janar - Dhjetor	Numri i Demeve		Ndryshimi	Pjesa ndaj totalit	
	2010	2011		2010	2011
Sigurime të detyrueshme	14,860	14,211	-4.37%	24.72%	20.10%
Sigurime vullnetare	45,252	56,494	24.84%	75.28%	79.90%
Gjithsej	60,112	70,705	18.00%	100.00%	100.00%

Burimi: BQK (2012)

Dëmet e paguara në numër gjatë vitit 2011 arritën në 70,705 apo 18% më shumë se në vitin 2010, ndërkaq vlera e dëmeve të paguara për këtë vit ishte 27 milion euro apo 3.60% më pak se në vitin 2010.

Tabela 33. Dëmet e Paguara

Periudha: Janar - Dhjetor	Demet e Paguara		Ndryshimi në %	Pjesa ndaj totalit	
	2010	2011		2010	2011
Auto përgjegjësia	16,865,141	14,857,285	-11.91%	23.31%	19.78%
Sigurimet Kufitare	1,113,796	974,286	-12.53%	1.54%	1.30%
Fondi i Grancise	3,342,806	3,320,840	-0.66%	4.62%	4.42%
Sigurimet Vullnetare	6,816,856	7,974,583	16.98%	9.42%	10.62%
Total Demet e Paguara	28,138,599	27,126,994	-3.60%	39%	36%

Burimi: BQK (2012)

Raporti i dëmeve të paguara[28] në vitin 2011 është 44% krahasuar me atë të vitit 2010 që ishte 48.88%. Nga tabela e mësipërme vërehet një rënie e shumës së dëmeve të paguara gjatë vitit 2011 në krahasim me vitin 2010. Një raport më i lartë i dëmeve të paguara gjatë vitit 2010 vjen si rezultat që në këtë vit ishin bërë pagesa të dëmeve të cilat kanë qenë të trashëguara nga vitet paraprake.

Pavarësisht rënies së nivelit të dëmeve të paguara gjatë vitit 2011, DMS ka vazhduar edhe më tej mbikëqyrjen e shtuar dhe efektive në drejtim të kontrollit të pagesës së dëmeve më qëllim të mbrojtjes së interesave të policë mbajtësve, ku në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010 është shënuar rritje e numrit të dëmeve të paguara me 18%.

Duke marrë parasysh rolin dhe objektivat e BQK-së, respektivisht DMS-sënë mbrojtjen e interesave të polic mbajtësve (klientëve), DMS performoi një mbikëqyrje të bazuar në rrezik duke bërë ekzaminime në vend (anglisht: "on-site") ashtu edhe monitorime nga jashtë (anglisht: "off-site").

Mbi bazën e raporteve mujore, tremujore dhe vjetore, është bërë monitorimi – analizimi nga jashtë i performancës së kompanive të sigurimit me ç' rast janë prodhuar raporte për industri dhe kompani individuale duke u në indikatorë të ndryshëm financiarë të cilët tregojnë ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të kompanive të sigurimeve si: marxhina minimale e Solvencës, fuqia financiare – likuiditeti, kalkulimi i rezervave teknike, ekspozimi i rrezikut, maksimumi i mbajtëse së rrezikut nga kompanitë e sigurimeve, kualiteti i risigurimit si dhe tregues tjerë relevant financiar.

Pozicioni financiar i kompanive të sigurimeve.

Asetet e industrisë së sigurimeve

Me 31 Dhjetor 2011, asetet rrjedhëse kanë vazhduar dominimin e tyre në krahasim me asetet tjera në kuadër të total aseteve me 61% ndërsa asetet fikse përbëjnë 13.2% të totalit të aseteve. Kërkesat dhe të arkëtueshmet tjera kanë shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar, ndërkohë që risigurimi dhe shpenzimet e shtyra e të parapaguara kanë qenë në një nivel të njëjtë me vitin e kaluar.

Figura 76. Struktura e Aseteve te industrise se Sigurimeve



Burimi: BQK (2012)

[28] Shuma e Dëmeve të paguara në Raport me Neto Primet e Shkruara.

Duke bërë një krahasim me vitin 2010 kur asetet rrjedhëse përbënin 63% dhe asetet fikse me 15.6% shihet një tendencë e ndryshimit të strukturës së aseteve si rezultat i rritjes së numrit te kompanive jetë që kanë hyrë në treg gjatë vitit 2011.

Rritja e gjithsej aseteve dhe ndryshimi i strukturës se aseteve fikse eshte karakteristike e vitit 2011, e para si rezultat i hyrjes se dy kompanive jete ne treg dhe e dyta është rezultat i investimeve ne patundshmëri. Rritja e parasë si aset është edhe si rezultat i fitimeve të mbajtura nga ana e kompanive të sigurimeve.

Detyrimet dhe ekuiteti

Me 31 Dhjetor 2011 rezervat teknike përbënin 51.6% të total detyrimeve, detyrimet tjera 10.0% ndërsa kapitali dhe rezervat tjera përbënin 38.4%.

Figura 77. Struktura e Detyrimeve te industrise se Sigurimeve



Burimi: BQK (2012)

Gjatë vitit 2011 shihet një vazhdimësi e rritjes së trendit të alokimit të fondeve në rezervat teknike. Rezervat teknike shënuan rritje për 33% ndërsa kapitali për 15%. Në kuadër të rezervave teknike, rritjen më të madhe e kanë shënuar rezervat për dëmet e njohura por ta parregulluara si dhe dëmet e ndodhura por të pa raportuara (anglisht: IBNR – Incurred But Not Reported).

Lëvizjet pozitive të cilat kanë ndodhur në pjesëmarrjen në rezervat teknike dhe në total primin janë tregues domethënës i rezultateve të stabilizimit dhe rregullimit të tregut të sigurimeve. Rritja e rezervave teknike në raport të drejtë me rritjen e primeve është rezultat i themelimit të kritereve për rezerva teknike bazuar në udhëzimin e nxjerrë nga BQK-ja në vitin 2010 dhe rezultat i një monitorimi të vazhdueshëm të alokimit të rezervave teknike si rezultat i këtij udhëzimi. Si rrjedhojë kjo ka mundësuar një vlerësim më real të rezervave të siguruesit si dhe mbrojtje më të mirë të interesave të policë mbajtësve apo përfituesve të sigurimit.

Treguesit e përformancës

Monitorimi i kompanive të sigurimit bëhet përmes "Divizionit për raportim dhe analiza" (DRA) në mënyrë sistematike dhe në forma të standardizuara duke nxjerrë analiza të rregullta mujore tremujore dhe vjetore sipas Rregulloreve të brendshme të BQK-së, bazuar në parimet e IFRS dhe praktikave të IAIS.

DRA në baza të rregullta mujore, përgatitë raporte për bordin e BQK-së, monitoron performancën financiare të kompanive të sigurimit, llogarit marzhën minimale të Solvencës,të likuiditetit dhe treguesëve tjerë të rrezikut.

Niveli i Solvencës në industrinë e sigurimeve

Aftësia paguese (anglisht: Solvency) është aftësia e një kompanie për të mbuluar detyrimet e saj afatgjata. Aftësia paguese dallon në krahasim me likuiditetin e cila në vete tregon aftësinë e organizatës për ti mbuluar detyrimet afatshkurtra. Aftësia paguese

(Solvenca) për industrinë e sigurimeve në Kosovë është e rregulluar me Rregulloren Nr. VIII të BQK, e cila në kalkulimin e Solvencës nuk i njehë si asete: i) 100% e debitorëve të primeve mbi 90 ditë, ii) 100% e parapagimeve dhe aseteve tjera të paprekshme si dhe iii) 25% e shpenzimeve të shtyra e të parapaguara. Si rrjedhojë e kësaj kur prej aseteve neto zbresim detyrimet dhe ekuitetin e aksionareve atëherë fitojmë rezultatin e Solvencës e cila duhet të jetë mbi vlerën 600,000 euro ashtu siç është përcaktuar me rregulloren Nr. VIII të BQK-së.

Bazuar në raportet financiare të 31 Dhjetorit 2011 industria e sigurimeve në Kosovë është Solvente për 27,957,180 euro dhe në krahasim me vitin 2010 kjo solvencë është rritur për 32%. Si rezultat i kësaj industria e sigurimeve në Kosovë vazhdon të ketë 27,957,180 euro asete mbi nivelin e detyrimeve dhe nivelin e kërkuar me Rregulloren Nr. VIII të BQK-së.

Tabela 34. Kalkulimi i Margjinës minimale të Solvencës

Pershkrimi	2011	2010
Total Assetet	120,945,630	97,168,934
Minus: Asetet e papranueshme	(86,388,451)	(69,438,177)
Neto Asetet =1 +(2 - 8)	34,557,180	27,730,756
Niveli i Margjinë Minimale të Solvences	6,600,000	6,600,000
Niveli I Solvencës	27,957,180	21,130,756
Pozicioni I Solvencës	Solvent	Solvent

Burimi: BQK (2012)

Ndërkohë,asetet e papranueshme kanë shënuar rënie në vitin 2011 në krahasim me 2010 për 6% që është tregues i mirë i përformances se industrisë dhe rritjes së aseteve kualitative ne raport me total asetet.

Profitabiliteti i industrisë së sigurimeve

Si një tregues mjaft i rëndësishëm i cili përcakton koston e policës së sigurimit dhe mjaftueshmerinë e primeve për të mbuluar kërkesat e obligimeve të cilat rrjedhin nga kontrata e sigurimit, raporti i dëmeve neto **(**angl: net loss ratio**)** i tregut të sigurimeve në Kosovë për vitin 2011 përbën 67% në krahasim me vitin 2010 sa ishte 52%. Kjo rritje e këtij treguesi për këtë vit ka ndodhur si rezultat i rritjes së rezervave teknike për dëme.

Kthimi mesatar në asete (ROAA) për industrinë e sigurimeve në Kosovë ka pasur një trend zvogëlimi nga 1.51% në vitin 2010 në 0.81% në vitin 2011. Ky zvogëlim ka ndodhur si rezultat i rritjes së rezervave për këtë vit. Gjithashtu një rënie ka pas edhe raporti i kthimit mesatar në ekuitet (ROAE)nga 3.65% sa ishte në vitin 2010 në 2.15% vitin 2011.

Likuiditeti industrisë së sigurimeve

Gjatë vitit 2011 industria e sigurimeve në përgjithësi rezultoi me tregues të qëndrueshëm likuiditeti.

Si vërehet nga tabela e sipërme, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në raport me rezervat teknike është 119%, (2010:130%), ndërsa në raport me gjithsej detyrimet ishin 100% (2010:107%). Ngushtimi i likuiditetit në vitin 2011 kryesisht ka rezultuar si pasojë e trendit të rritjes së shpejtë të totalit të rezervave teknike krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i implementimit të Udhëzimit të metodologjisë se kalkulimit të rezervave teknike të lëshuar nga BQK-ja në vitin 2011.

Tabela 35. Treguesit e Likuiditetit

Përshkrimi	2011	2010
Raporti Neto i Riskut: NPSH / Ekuitetin	125%	135%
Raporti Bruto i Riskut: BPSH / Ekuitetin	149%	155%
Parapagimet në Raport me Ekuitetin	4%	4%
Raporti i rritjes se total shpenzimeve	37%	43%
Total Mjetet Likuide Keshi / Provizionet Teknike	119%	130%
Total Mjetet Likuide Keshi / Total Detyrimet	100%	107%
Te hyrat nga investimet / Gjithsej të Hyrat	23%	10%
Non TPL / GWP	33%	32%

Burimi: BQK (2012)

Ndërkohë që dy raportet tjera nga tabela e mësipërme, raporti neto i riskut dhe raporti bruto i riskut të cilët tregojnë nivelin e riskut të marrë në raport me ekuitetin kanë shënuar rënie në krahasim me vitin 2010.

Risigurimi ne industrinë e sigurimeve

Risigurimi është një mjet mjaft efektiv për transferimin e rreziqeve të mëdha tek kompanitë risiguruese. Kryesisht kompanitë e sigurimit të cilat nuk kanë fonde të mjaftueshme për mbulimin e humbjeve të cilat rrjedhin nga këto rreziqe, bëjnë ndarjen e primit dhe dëmit tek kompanitë risiguruese. Duke qenë se tregu i sigurimeve në Kosovë ka një tendencë të rritjes se produkteve vullnetare, kompanitë e sigurimeve marrin në sigurim rreziqe të mëdha duke bërë transferimin e pjesës së primit dhe dëmit tek kompanitë risiguruese. Gjatë vitit 2011 pjesa e primit të ceduar në gjithsej primet bruto të shkruara është 12% ndërsa në vitin 2010 ishte 9%. Ky trend i rritjes se primit të ceduar është një tregues mjaft pozitiv i cili kryesisht është rezultat i rritjes së trendit të produkteve vullnetare.

Mbikëqyrja në vend

Mbikëqyrja ne vend është proces thelbësor i mbikëqyrjes së kompanive të sigurimitsepse, në njërën anë, siguron zgjerimin e informacionit mbi bazën e statistikave financiare të cilat raportohen nga kompanitë e sigurimeve dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve të cilat kontribuojnë për të analizuar mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, ndërsa, në anën tjetër, siguron informaciontë nevojshëm mbi zhvillimet në entitetet e mbikëqyrura lidhur me ushtrimin e aktiviteteve të menaxhimit dhe qeverisjes, aktiviteteve financiare dhe aktiviteteve të tjera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Si pjesë e mbikëqyrjes së aktivitetit të kompanive të sigurimeve dhe me qëllim të mbrojtjes së interesave të policë mbajtësve, DMS-ja gjatë vitit 2011 ka zhvilluar ekzaminime të plota dhe ekzaminime të fokusuara.

Ekzaminimet e plota janë zhvilluar në pajtueshmëri me politikën e mbikëqyrjes së BQK-së si dhe me planin vjetor të ekzaminimeve të hartuar paraprakisht, ndërsa ekzaminimet e fokusuara janë ndërmarrë dhe janë kryer si rezultat i zhvillimeve në industrinë e sigurimeve, në saje të mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhdueshëm.

Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e ekzaminimeve të realizuara gjatë vitit 2011 kanë mbuluar vitet financiare 2009 dhe 2010.

Ekzaminimet janë kryer në fushën e financave, marrjes në sigurim dhe në fushën e dëmeve (kjo e fundit është realizuar në dy cikle gjatë vitit).

Tabela 36. Ekzaminimet e plota dhe fokusuara

Përshkrimi	Kompanitë e sigurimeve	Njësia e Sigurimeve	Fondi i Garancisë së Kosovës
Ekzaminime të plota	8	1	1
Ekzaminime të fokusuara	40	1	1

Burimi: BQK (2012)

Ekzaminimet janë kryer në të gjitha kompanitë e sigurimeve, si dhe në Njësinë e sigurimeve të detyruara /Shoqata e Sigurimeve të Kosovës (NJSD/SHSK) dhe po ashtu në Fondin e Garancisë së Kosovës (FGK), të cilat si njësi tashmë janë transferuar në Byronë Kosovare të Sigurimeve.Gjatë ekzaminimit janë konstatuar gjetje të ndryshme dhe si të tilla janë evidentuar në raportet e ekzaminimeve. Çështjet e konstatuara janë adresuar përmes urdhrave të lëshuara nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së, dhe rekomandimeve në raportet e ekzaminimit përmes së cilave është kërkuar marrja e masave të nevojshme në përmirësimin dhe evitimin e parregullsive, si dhe përmbushjen e rekomandimeve sipas dinamikës së caktuar.

Për dallim nga ekzaminimet e kaluara të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara në mbikëqyrjen e bazuar në rregullativë, mbikëqyrja dhe realizimi i ekzaminimeve po përqendrohet gjithnjë e më shumë në qasjen e bazuar në risk.

4.4. Mbikëqyrja e Pensioneve

Sistemi pensional i Kosovës gjatë vitit 2011 nuk ka pasur ndonjë ndryshim te theksuar edhe pse lëvizja e tregjeve financiare ndikon drejtpërsëdrejti në mjetet e fondeve pensionale të investuara jashtë Kosovës. Qëllimi i mbikëqyrjes se pensioneve mbetet ruajtja e mjeteve të kontribuesve .

Sistemi pensional i Kosovës funksionon në bazë të Ligjit 03/L-084 për ndryshim të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 mbi pensionet në Kosovë. Ligji në fjalë bazohet në tre shtylla:

- Pension bazë të moshës së vjetër për të gjithë kosovarët mbi 65 vjeç, që financohet nga të hyrat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (i njohur si shtylla e I-rë);

- Pensione të investuara që financohet nga kontributet e obligueshme të punëdhënësve dhe punëtorëve për të punësuarit (i njohur si shtylla e II-të) dhe;

- Skemat vullnetare pensionale, të financuara nga kontributet vullnetare të individëve dhe punëdhënësve (i njohur si shtylla e III-të).

Në bazë të Ligjit 03/L-084 për Pensionet në Kosovë, shtylla e dytë financohet nga kontributet mujore të detyrueshme të cilat janë të përcaktuara me ligj, ku 5% kontribuojnë të punësuarit në bruto pagën e tyre dhe 5% kontribuojnë punëdhënësit. Çdo pagesë transferohet në llogaritë individuale të kontribuesve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

Gjatë vitit 2011 janë kryer inspektime të plota dhe të fokusuara në bazë të planit për ekzaminime të divizionit të pensioneve.

Tabela 37. Ekzaminimet e kryera nga mbikëqyrja e pensioneve gjatë vitit 2011

Përshkrimi	I plotë	I fokusuar
Trusti i Kursimeve Pensionale i Kosovës	1	0
Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve	1	1
Gjithsej	2	1

Burimi: BQK (2012)

a) Shtylla e II-të

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (tani e tutje "TKPK").

TKPK është themeluar për të administruar dhe menaxhuar shtyllën e dytë të pensioneveashtu siç është përcaktuar me ligjin mbi pensionet 03/L-084.

TKPKështë krijuar sipasRregullores sëUNMIK-ut Nr. 2001/35 (dhjetor 2001), më vonë e amandamentuar me Rregulloren 2005/20, kjo më vonë e amandamentuar me Ligjin nr. 03/L-084 të Republikës së Kosovës, si entitet ligjor jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të aseteve pensionale dhe duke paguar rrjedhjet nga llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursimet pensionale, si i besuar për menaxhim duke vepruar në të mirë të pjesëmarrësit dhe përfituesve të tij/saj.

TKPKdrejtohet nga Bordi Udhëheqës i cili ka shtatë anëtarët të cilët mbikëqyrin punën e tij.

Numri i kontribuesve deri më 31 dhjetor 2011 ishte 384,574 ndërsa ne vitin 2010 ishte 350,960 që rezulton me një rritje të kontribuesve për 9.58%. Gjatë vitit 2011 shuma e mjeteve në menaxhim të TKPK u rrit për 100,079,934.00€. Gjithsej vlera e mjeteve në menaxhim të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës më 31 dhjetor 2011 ishte 595,618,335.00 euro, ndërsa në vitin 2010 ishte 495,538,401.00 euro.

Figura 78. Paraqitja grafike e lëvizjes se çmimit të njësisë



Burimi: TKPK (2012)

Gjatë vitit 2011 investimet e TKPK-së patën një kthim në shumë bruto prej 3,313,459.00 euro në totalin e mjeteve të investuara apo 0.56%.Në fund të vitit 2011 vlera e njësisë e Trustit ishte 1.0346 euro,ndërsa në vitin 2010 ishte 1.0327 euro,rritje kjo eçmimit të njësisë për 0.18%.

Në tabelën si me poshtë shihet pjesëmarrja e kategorive te investimeve te mjeteve pensionale gjatë vitit 2011 të totalin e mjeteve të TKPK-së.

Tabela 38. Struktura e investimit të mjeteve pensionale deri me 31 dhjetor

Institucionet ku janë te investuara mjetet pensionale	Klasa e Asetit	Mjetet	Pjesmarrja në %
Vanguard	Ekuitete	203,454,177	34.58%
BNP Paribas	Tregu i Parave	63,654,874	10.82%
Schroders	Bono	59,964,591	10.19%
European Credit Managment	Treg i Kredive	19,980,969	3.40%
Aquila	Diversified	50,641,026	8.61%
AXA GILB	Bono të lidhura me inflacionin	84,909,413	14.43%
BNY Mellon	Të ndryshme	50,361,646	8.56%
Raiffeisen Bank	Certifikata Depozitash Bankare	18,844,793	3.20%
NLB Prishtina	Certifikata Depozitash Bankare	15,855,128	2.69%
BQK	Të painvestuara	20,736,598	3.52%
Gjithsej		588,403,214	100.00%

Burimi: BQK (2012)

Po ashtu ne tabelën e mëposhtme mund te shihet edhe kthimi nga investimet për secilin institucion ku janë të investuara mjetet pensionale:

Tabela 39. Struktura e kthimit nga investimet e mjeteve pensionale deri me 31 dhjetor

Institucionet	Klasa e Asetit	Kthimi bruto
Vanguard	Ekuitete	-9,984,210
BNP Paribas	Tregu i Parave	741,523
Schroders	Bono	-552,629
ECM ECL	Treg i Kredive	1,056,691
ECM DEC	Treg i Kredive	-519,385
Aquila	Diversified	641,026
AXA GILB	Bono të lidhura me inflacionin	10,220,048
BNY Mellon	Të ndryshme	361,464
Raiffeisen Bank	Certifikata Depozitash Bankare	415,307
NLB Prishtina	Certifikata Depozitash Bankare	551,969
BQK	Të painvestuara	75,122
Auriel Sp		306,533
Kontributet e arketueshme	Të painvestuara	
Gjithsej		**3,313,459**

Burimi: BQK (2012)

b) Shtylla e III

Fondi Slloveno - Kosovar i Pensioneve (tani e tutje “FSKP”)

FSKP është themeluar si shoqëri aksionare “Prva Group” nga Ljubljana dhe Korporata “Dukagjini” nga Peja, më 4 shtator 2006, në bazë të Ligjit 03/L-084 për ndryshim të rregullores së UNMIK-ut 2005/20 mbi Pensionet në Kosovë. FSKP-ja është licencuar si Fond Pensional Suplementar dhe si Menaxher i Mjeteve Pensionale.

Në vitin 2011 bordi i FSKPvendosi qe te tërhiqet nga tregu si Menaxher i Mjeteve të Pensioneve. Rredhimisht, Bordi ekzekutiv i BQK-së mori vendimin për revokimin e licencës se FSKPpër ushtrimin e veprimtarisë si “Menaxher i Mjeteve të Pensioneve” dhe vazhdimin licencës si “Fond Plotësues Individual i Pensioneve”.

Me 31 dhejtor 2011 mjetet e Fondit Plotësues Individual të Pensioneve në Fondin Slloveno Kosovar të pensioneve arritën vlerën prej 4,079,674.97 euro, rritje kjo për12.80% në krahasim me vitin 2010.

Vlera e njësisë me 31 dhjetor 2011 ishte 125.6594 euro,ndërsa në vitin 2010 ishte 120.9082 euro.FSKPgjatë vitit 2011 arriti të ketë një kthim pozitiv prej 147,927.28 euro, përkatësisht3.93%.

Tabela 40. Struktura e investimit të mjeteve pensionale tëFSKP-së (me 31 dhjetor 2011)

Përshkrimi	Mjetet në euro	Përqindja
Aksione	105,118	2.58%
Obligacione dhe letra te tjera fikse me vlere	3,089,274	75.72%
Depozita	753,600	18.47%
Paraja e gatshme	77,919	1.91%
Asetet tjera	53,765	1.32%
Gjithsejt asetet	4,079,675	100.00%

Burimi: BQK (2012)

Numri i kontribusve për vitin 2011 arrin ne 3,513 anëtarë, ndërsa në vitin 2010 ishte 3,404 anëtarë.Ngjashëm me institucionet tjera financiare edhe operatorët e sistemit të pensioneve si TKPKashtu edhe FSKPu janë nënshtruar ekzaminimeve në venddhe analizave të kryera nga Divizioni i Pensioneve iBQK-së.

5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

BQK u siguron institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjerë shërbimet e rëndomta që ofrojnë bankat qendrore. Në përgjithësi këto shërbime kanë të bëjnë me qarkullimin e parave të gatshme, transaksionet e llogarive, menaxhimin e mjeteve financiare, sistemet ndërbankare të pagesave, regjistrin e kredive dhe statistikat dhe analizat ekonomike.

5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

Figura 79. Furnizimi me para të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 80. Pranimi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK(2012)

Funksioni i BQK-së për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi gjatë vitit 2011 është kryer në mënyrë të suksesshme. Meqë euroja është valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë, përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kishin të bëjnë në radhë të parë me euron.

Sa i përket vlerës së përgjithshme, paratë e gatshme të furnizuara gjatë vitit 2011 patën një zvogëlim prej 1 përqind krahasuar me vitin 2010, ndërkaq struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk pati ndonjë ndryshim te dukshëm nga viti 2010 në vitin 2011. Te kartëmonedhat euro vazhduan të dominojnë denominimet e ulëta 5, 10, 20 dhe 50 euro, ndërsa vëllimet e denominimeve prej 200 dhe 500 euro mbeten dukshëm më të ulëta.

Përderisa gjatë vitit 2010 furnizimi me monedha euro kryesisht u dominua nga monedhat

Figura 81. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2012)

Figura 82. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2012)

me vlerë të mesme nga 10 eurocent deri në 50 eurocent, në vitin 2011 vëllimet e denominimeve të ulëta patën rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë dhe ishin më të larta krahasuar me denominimet e monedhave në vlerë prej 10 cent deri në 2 euro.

Figura 83. Kartëmonedha euro të pranuara sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2012)

Figura 84. Monedha euro të pranuara sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2012)

Siç është paraqitur në figurat e mësipërme, gjatë vitit 2011, BQK-ja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera me afër 8.2 milionë copë kartëmonedha euro (në shumë prej mbi 224 milionë euro) dhe mbi 1.4 milion copë monedha euro (në shumë rreth 0.3 milion euro). Në vitin 2011, vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuara si depozita shënoi një rritje prej 17.13 përqind krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi afër 13.9 milionë copë kartëmonedha euro (mesatarisht rreth 55,000 copë kartëmonedha në

ditë) dhe mbi 2 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 8,200 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 758.2 milionë euro dhe 1.8 milionë euro, përkatësisht. Struktura e kartëmonedhave dhe monedhave euro të pranuara nuk dallon shumë nga viti paraprak.

Ngjashëm me vitet e kaluara, në vitin 2011, paratë e gatshme neto[29] të depozituara ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 535.2 milionë euro, ndryshimi i tillë ishte në një masë të konsiderueshme më i lartë se sa në vitin e mëhershëm që ishte rreth 423.6 milionë euro.

Figura 85. Eksporti i parave të gatshme (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 86. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin minimal të nevojshëm të parave të gatshme, duke dërguar tepricat në eurozonë, ku kthehen në mjete interes-prurëse dhe përdoren edhe për kryerjen e pagesave ndërkombëtare dhe investime, rritja vjetore e parave të gatshme të depozituara kundrejt parave të gatshme të furnizuara ka rezultuar gjithashtu në rritjen e neto dërgesave jashtë vendit të parave të gatshme. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2011 arritën shumën prej 581.9 milionë eurove (2010:405.3 milionë euro). Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim.

Operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat standarde. Të gjitha paratë e gatshme të pranuara nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera u procesuan dhe u klasifikuan sipas shkallës së vjetërsimit. Gjatë vitit 2011, rreth 4.3 milionë copë kartëmonedha euro (31.2 për qind e numrit të kartëmonedhave euro të depozituara) u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat qendrore të eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro tejet të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi ishin ato të denominimeve 20, 10 dhe 5 euro, për shkak të qarkullimit më të madh të tyre në ekonomi.

[29] Depozitat minus Terheqjet

Figura 87. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2012)

Figura 88. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuara



Burimi: BQK (2012)

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të

Figura 89. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)



Burimi: BQK (2012)

Figura 90. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara



Burimi: BQK (2012)

kartëmonedhave plotësisht të reja euro, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2011, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me mbi 3.1 milionë copë kartëmonedha të reja euro (39 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara).

Shumica e kartëmonedhave të reja të furnizuara ishin kartëmonedha të denominimeve më të ulëta (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej, edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të një cilësie standarde të lartë (cilësia adekuate për bankomatë).

Figura 91. Parate euro te falsifikuara te konfiskuara ne nivel te Kosoves (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2012)

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, BQK-ja vazhdoi të përcjellë rastet e parave të falsifikuara gjatë vitit 2011. Në veçanti, vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false dhe organizimin e trajnimeve mbi paratë e falsifikuara të

dizajnuar për stafin e zgjedhur të institucioneve financiare që ofrojnë shërbime me para të gatshme. Në këtë kontekst, janë mbajtur takime të rregullta tëKomitetit Qendror të Analizave të Parave të Falsifikuara[30]. Në vitin 2011 BQK së bashku me Policinë e Kosovës dhe Laboratorin e Forenzikës publikoi ne ueb[31] faqen e saj statistikat mbi paratë e falsifikuara në nivel të Republikës së Kosovës. Materialet e publikuara kane si qëllim informimin e publikut te gjerë mbi kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara.

5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Thesarin dhe institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe institucione te tjera siç janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (FMN, BB), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar ne nenin 9 te ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së.

Në vitin 2011, sikurse edhe viteve të mëparshme, këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe kryerja e pagesave, duke përjashtuar çfarëdo forme të kreditimit.

Gjatë vitit 2011, BQK-ja vazhdoi të mbështesë avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Thesarit dhe të AKP-së. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre. Vlen të veçohet elektronizimi i plotë i urdhërtransfereve.

Në fillim të vitit 2011 u bë përmbyllja e të gjitha fazave të planifikuara të projektit të Bankingut Direkt duke përfshirë të gjitha aspektet financiare, ato të dizajnit si dhe përpilimi i Kushteve dhe Manualit për përdorimin e Bankingut Direkt nga klientët. Klientët gjate tërë vitit 2011 kanë qenë të lidhur në Bankingun Direkt dhe në kohë reale kanë parë transaksionet dhe gjendjet e llogarive të tyre të mbajtura në BQK.

Tabela 41. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2007	2008	2009	2010	2011
Transaksionet me para te gatshme	**+371,745**	**+385,113**	**+411,055**	**+423,658**	**+535,190**
Depozita ne para te gatshme	533,178	524,346	601,207	648,911	760,082
Terheqje te parave te gatshme	161,433	139,233	190,152	225,253	224,892
Transferet vendor	**+358,182**	**+78,078**	**+41,169**	**+392,587**	**+462,867**
Transferet vendor ardhes	1,055,472	1,076,145	1,225,527	1,568,021	1,615,232
Transferet vendor dales	697,290	998,067	1,184,358	1,175,434	1,152,365
Transferet nderkombetar	**+13,124**	**-364,795**	**-463,816**	**-408,689**	**-558,778**
Transferet nderkombetar ardhes	335,613	203,113	202,755	326,319	266,706
Transferet nderkombetar dales	322,489	567,908	666,571	735,008	825,483

Burimi: BQK (2012)

[30] Komiteti është i përbërë nga tre përfaqësues të lartë të PK-së dhe tre përfaqësues të lartë të BQK-së

[31] http://www.bqk-kos.org/?cid=1,141

Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së ndërlidhet me bankat komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së kryhen në emër të dhe për llogari të Thesarit[32].

Figura 92. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2012)

Figura 93. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

BQK-ja merr pjesë në kanalizimin e urdhërpagesave vendore në emër të dhe për llogari të llogarimbajtësve të saj si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN). Gjatë vitit 2011, përmes SEKN-së, BQK-ja ka dërguar në emër të klientëve të saj rreth 250 mijë urdhërpagesa dalëse (një rritje prej 20.1 për qind krahasuar

Figura 94. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse, numri



Burimi: BQK (2012)

Figura 95. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 94 mijë urdhërpagesa ardhëse (një rritje prej 6.76 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse në vitin 2011 arritën mbi 1.15 miliardë euro (një zvogëlim prej 1.96 përqind krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse arritën mbi 1.61 miliardë euro (një rritje prej 3 përqind krahasuar me vitin paraprak). BQK-ja ka mbetur, sa i përket si vlerës ashtu edhe vëllimit të transaksioneve, pjesëmarrësi më i madh në SEKN.

Kur flitet për transaksionet e pagesave vendore, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato si pjesëmarrëse në SEKN, kurse institucionet e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.

[32] Thesari – Ministria e Ekonomise dhe Financave

Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, në vitin 2011, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kanë të bëjnë me transferët e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore për pesë vitet e fundit mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.

Figura 96. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, numri



Burimi: BQK (2012)

Figura 97. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Figura 98. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2012)

Figura 99. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Me qëllim të avancimit të validimit të urdhërtransferëve ndërkombëtar dhe në mungesë të SWIFT – BIC kodit (për shkak se Republika e Kosovës ende nuk ka kod të saj) BQK në fillim të vitit 2011 ka implementuar bazën e BIC kodeve me qëllim të përdorimit nga sistemi i kontabilitetit dhe Bankingu Direkt gjatë kryerjes së pagesave ndërkombëtare.

Depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës së bashku me depozitat e AKP-së përbënin pjesën më të madhe të depozitave të gjithmbarshme të mbajtura në BQK në fund vitin 2011 (70.7 për qind). Më 31 dhjetor 2011, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës arritën shumën prej 194.33 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 585.76 milionë euro.

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave që mbahen në llogaritë në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me obligimet e tyre rregullatore. Ato përbënin 19.7 për qind të gjithsej depozitaveqë u mbajtën në BQK gjatë vitit 2011. Më 31 dhjetor 2011, depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimit ishin në shumën prej 217.39 milionë euro.

Figura 100. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, në milionë euro



Burimi: BQK (2012)

Niveli i depozitave të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) të mbajtura në BQK u zvogëlua gjatë vitit 2011. Ato përbënë rreth 1.9 për qind të gjithsej depozitaveqë u mbajtën në BQK gjatë vitit 2011 dhe në fund të vitit arritën shumën prej 20.74 milionë euro.

Tabela 42. Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive, në milionë euro

Llojet e llogarive	2007	2008	2009	2010	2011
I. Llogaritë rrjedhëse	1,009.66	796.34	959.00	441.76	677.95
Institucionet Qeveritare	475.54	202.89	88.84	48.80	89.33
Agjencia Kosovare e Privatizimit	375.60	403.31	451.04	65.09	265.31
Institucionet tjera Qeveritare (TKPK)	5.57	34.43	122.00	38.09	20.74
Fondet Pensionale Suplementare	1.92	0.07	0.07	0.07	0.07
Bankat Komerciale	113.55	137.01	233.23	203.56	209.70
Kompanitë e Sigurimeve	14.87	15.39	7.66	5.78	7.69
Institucionet Publike (PTK, KEK, RTK etj)	20.99	1.54	0.51	0.04	0.22
Institucionet Ndërkombëtare (EULEX etj)	0.02	0.00	0.80	1.68	0.73
Institucionet Ndërkombëtare (FMN, BB)	0.00	0.00	53.11	76.99	73.39
Të tjera	1.61	1.70	1.74	1.67	10.77
II. Depozitat e afatizuar	10.56	7.20	125.00	597.10	425.45
Institucionet Qeveritare	0.00	(0.00)	125.00	140.00	105.00
Agjencia Kosovare e Privatizimit	0.00	0.00	0.00	457.10	320.45
Fondet Pensionale Suplementare	5.40	0.00	0.00	0.00	0.00
Kompanitë e Sigurimeve	5.16	7.20	0.00	0.00	0.00
III. Letrat me vlere te qeverise	0.00	267.89	0.00	84.75	0.00
Institucionet Qeveritare	0.00	267.89	0.00	84.75	0.00
Gjithsej gjendja	1,020.22	1,071.44	1,084.00	1,123.61	1,103.40

Burimi: BQK (2012)

5.3. Sistemi i Pagesave

5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar

Zhvillimi i një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave kombëtare, si shtyllë kyqe e infrastrukturës financiare, është një prej funksioneve parësore të BQK-së. BQK-ja operon Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), i cili është sistem i

vetëm ndër bankar i pagesave në vend. SEKN-ja, funksionon si një sistem hibrid i cili mundëson kanalizimin ndër bankar të një sërë instrumentesh të pagesave.

Figura 101. Numri i transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2012)

Figura 102. Vlera e transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2012)

Gjatë vitit 2011 u shënuan rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve të SEKN-së dhe u bë avancim i mëtejmë i sistemit. Nga zhvillimet me rëndësi të veçantë ishte funksionalizimi me sukses i modulit të letrave me vlerë në SEKN dhe krijimi i ndërfaqes plotësisht të automatizuar të SEKN-së me sistemin qendror të tregut për letra me vlerë (DEPO/X) si dhe fillimi i zbatimit të disa nga projektet e planifikuara zhvillimore në kuadër të Strategjisë për Zhvillim të Sistemit Kombëtar të Pagesave.

Rritja e vazhdueshme në vëllim dhe vlerë të transaksioneve ndërbankare të SEKN-së pasqyron rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar. Sikurse viteve të mëparshme, në vitin 2011, rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishte e dukshme. Rreth 4.2 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 5.1 miliardë euro u kanalizuan përmes SEKN-së gjatë vitit 2011.

Figura 103. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2012)

Figura 104. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2012)

Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 6.67 për qind dhe vlera e transaksioneve u rrit për 9.15 për qind. Rritja e transaksioneve të SEKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SEKN-së në vitin 2011 ishte rreth 20.5 milionë euro, krahasuar me rreth 18.5 milionë euro në vitin 2010. Mandej, vëllimi ditor i transaksioneve të SEKN-së në vitin 2011 ishte afro 16.9 mijë, krahasuar me rreth 15.6 mijë në vitin 2010. Një ndër faktorët që ka ndikuar në rritjen e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishin transaksionet

fiskale nga Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës. Ndërkaq rritja në numër të pagesave ndërbankare gjatë këtij viti nuk ishte për t'u theksuar në krahasim me vitet paraprake.
Janë disa lloje të veçanta të transaksioneve të SEKN-së: të rregullta (individuale dhe masive), prioritare (individuale dhe masive), Kos-Giro dhe Debitimi Direkt. Nivelet e vëllimeve dhe vlerave të tyre për vitet 2011 dhe 2010 janë të paraqitura në figurat në vijim.

Figura 105. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2012)

Figura 106. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2012)

Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbejnë rreth 87.5 për qind të vëllimit dhe rreth 69.9 për qind të vlerës së transaksioneve të SEKN-së. Ato kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale (një-deri te-një) ose si transaksione masive (një-deri te-shumë ose shumë-deri te-një). Ato procesohen përmes 4 sesionevetë rregullta të kliringut dhe shlyhen në baza neto.
Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Ato kanalizohen përmes SEKN-së si transaksione masive (shumë-deri te-një). Përderisa transaksionet e rregullta individuale janë të destinuara për pagesat në përgjithësi dhe pagesat e rregullta masive janë të destinuara për pagesat dhe arkëtimet e ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme, transaksionet Kos-Giro janë të destinuara për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të entiteteve të mëdha faturuese. Gjatë vitit 2011 u shënua një rritje si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së tyre.

Transaksionet prioritare (urgjente) procesohen dhe shlyhen menjëherë gjatë orarit të punës në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare mund të kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së. Në vitin 2011,sa i përket vëllimit, ato përfaqësuan më pak se 1 për qind të transaksioneve, ndërsa sa i përket vlerës, ato arritën të përfaqësojnë mbi 12.8 % të transaksioneve. Ky lloj vazhdon të përdoret kryesisht për kryerjen e pagesave urgjente dhe të atyre me vlera më të mëdha.

Debitimi Direkt si instrument dhe skemë e re e pagesave në Kosovë e lansuar në nëntor 2009ofronnjë mundësi më të avancuar të kryerjes automatike të pagesave periodike (pa para të gatshme) nga llogaria bankare qëkanë të bëjnë, në radhë të parë, me shpenzime mujore për energji elektrike, furnizim me ujë, telefoni, ngrohje, mirëmbajtje etj. Si lloj i ri transaksioneve të SEKN-së ende nuk përdoret në atë masë sa llojet e tjera, kështuqe gjatë vitit 2011, përfaqësontevetëm 1 për qind të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SEKN-së. Gjatë vitit 2011, tri kompani të reja iu bashkuan skemës së Debitimit Direkt.

Një pasqyrë e detajuar e treguesve të përqendrimit të pjesëmarrjes së institucioneve më aktive në SEKN gjatë vitit 2011, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem, është paraqitur në vijim.

Figura 43. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SEKN

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
3 banka	52.20%	61.90%
5 bankat tjera	47.80%	38.10%
Totali (vlerë absolute)	4.189.777	5.086.555.947

Burimi: BQK (2012)

Referuar vlerës së përgjithshme të transaksioneve të shlyera në SEKN, gjatë vitit 2011 vlera e përgjithshme ka qenë 5,086,555,947.69 €, ku tre institucionet e para me vlerë më të madhe të transferëve të iniciuara zënë 61.9 për qind të vlerës absolute ndërsa gjithë institucionet tjera 38.1 për qind. Sa i përket numrit të transferëve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre 4.189.777, tre institucionet e para me numër më të madh të transferëve të iniciuara zënë 52.2 për qind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera zënë 47.8 për qind.

Figura 44. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuara/hyrëse në SEKN

Sistemi SEKN	Vëllimi Peshë totali	Vlera Peshë totali
3 banka	90.90%	67.10%
5 bankat tjera	9.10%	32.90%
Totali (vlerë absolute)	4.189.777	5.086.555.947

Burimi: BQK (2012)

Sa i përket transferëve të pranuara, tre institucionet me vlera më të mëdha të transferëve të pranuara zënë 67.1 për qind të shumës absolute, ndërsa gjithë institucionet tjera zënë 32.9 për qind. Ndërsa nga numri i përgjithshëm i transferëve të pranuara, tre institucionet e para zënë 90.9 për qind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera 9.1 për qind.

5.3.2 Zhvillimet e përgjithshme, analiza dhe mbikëqyrja e sistemeve të pagesave

Në kuadër të implementimit të Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave, gjatë vitit 2011 u zhvilluan aktivitete pothuaj në gjitha shtyllat përkatëse të saj si: i) korniza ligjore, ii) pagesat me vlera të mëdha dhe ato urgjente, iii) pagesat me vlera të vogla, iv) transaksionet qeveritare, v) letrat me vlerë, vi) tregu monetar, vii) dërgesat nga jashtë, viii) mbikëqyrja e sistemit të pagesave, dhe ix) bashkëpunimi dhe koordinimi mes akterëve të pagesave.

Në kuadër të nismave për implementim të strategjisë janë themeluar grupet punuese për të gjitha shtyllat e parapara në strategji dhe janë ndërmarrë një mori aktivitetesh përkatëse. Konkretisht, janë përgatitur termat e referencës për sistemet e reja të pagesave (shtylla ii, iv dhe vi) si dhe është finalizuar drafti i ligjit për sistemin e pagesave (shtylla i) i cili pritet të aprovohet në vitin 2012. Në kuadër të shtyllës së fundit (ix), Këshilli Kombëtar i Pagesave(KKP), është themeluar për të mbështetë zhvillimin dhe rritjen e sistemeve të

qëndrueshme dhe efikase për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë në Kosovë. Gjatë këtij viti, nën ombrellën e KKP-sëka vepruar me sukses edhe grupi për menaxhimin e projektit për reduktimin e pagesave jo me para të gatshme në Kosovë. Në këtë fushë, janë realizuar analiza të veçanta rrethpërdorimit tëinstrumenteve elektronike në vend dhe krahasimet me vende në regjion dhe më gjerë si dheanaliza lidhur mepagesat jo në para të gatshme - hulumtim për klientin dhe tregtarin, etj. Njëkohësisht në kuadër të aktiviteteve të kësaj ekipe, u nisën dhe zhvilluan kontaktet e para me përfaqësues të kompanive "MasterCard" dhe "Visa", për shkëmbim të ideve dhe bashkëpunim lidhur me promovimin e mënyrave elektronike të pagesave, etj.

Në kuadër të fushës së mbikëqyrjes së sistemit të pagesave (shtylla vii), BQK ka themeluar dhe zhvilluar funksionin përkatës në linjë me parimet dhe standardet ndërkombëtare, janë bërë publikime të rregullta të treguesve analitikë për instrumente të pagesave në Kosovë. Poashtu, gjatë vitit 2011 u përpilua dhe u aprovua Rregullorja e re e statistikave për instrumente të pagesave si dhe u rishikua dhe harmonizua Metodologjia për Raportimin e Instrumenteve të Pagesave, që kanëpër synim:

- Grumbullimin dhe përsosjen e përpunimit të të dhënave periodike si dhe mirëmbajtjen efikase të bazës së të dhënave mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë.
- Monitorimin e zhvillimeve në fushën e sistemeve të pagesave në mënyrë që të vlerësohet shkalla e rreziqeve që përmbajnë këto dhe të sigurohet transparenca në marrëveshjet që kanë të bëjnë me instrumentet dhe shërbimet e pagesave.
- Përmirësimin e cilësisë së raporteve analizave dhe publikimeve mbi instrumentet e pagesave në pajtim me raportet nga Banka Qendrore Evropiane, duke synuar kështu publikimin e të dhënave për Kosovë në botim përkatëse në të ardhmen e afërt.[33]
- Analizimin e zhvillimeve në sferën e instrumenteve të pagesave në Kosovë karshi shteteve në Evropën Juglindore dhe Qendrore.[34]

Nga të dhënat e mbledhura dhe të analizuara gjatë vitit 2011 është krijuar një pasqyrë e gjerë mbi nivelin e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave. Në përgjithësi, vërehet se infrastruktura dhe instrumentet e pagesave po zhvillohen me një ritëm të shpejtë.

Figura 107. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2012)

Figura 108. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit



Burimi: BQK (2012)

Në vazhdimësi, numri i kartelave me funksion pagese është në rritur. Rrjeti i terminaleve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje. Në dhjetor të vitit 2011, janë raportuar

[33] Burimi: http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,54
[34] Burimi: http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,55

548.253 kartela me funksion debiti, afër 75.000 kartela me funksion krediti dhe 12.391 kartela me parapagim. Këto kartela kanë mundur të përdoren në 460 terminale ATM (bankomatë) dhe 7.534 terminale POS (pika të shitjes) të vendosura nëpërKosovë.

Në krahasim me vitin paraprak, numri i terminaleve ATM është rritur për 10.84 për qind dhe numri i terminaleve POS me 21.63 për qind.

Figura 109. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2012)

Figura 110. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2012)

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2011, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve është rreth 2.1 milion, me një rritje prej 11 % krahasuar me fundin e vitit 2010. Rreth 98.3% e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.7% të jo rezidentëve.

Tabela 45. Numri i llogarive

Përshkrimi I llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2009	2010	2011	2009	2010	2011
Llogaritë e klientëve (1+2)	1.780.451	1.857.608	2.059.878	40.924	50.274	68.99
1-llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.50%	98.40%	98.34%	94.10%	94.20%	94.80%
a-individuale (%)	94.00%	94.30%	94.36%	81.90%	83.60%	80.00%
b-kompani (%)	6.00%	5.70%	5.63%	18.10%	16.40%	20.00%
2-llogari të jo-rezidentëve (c+d)	1.50%	1.60%	1.66%	5.90%	5.80%	5.20%
c-individuale (%)	95.40%	96.10%	96.60%	94.80%	94.30%	90.80%
d-kompani (%)	4.60%	3.90%	3.40%	5.20%	5.70%	9.20%

Burimi: BQK, Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Nga totali i llogarive në fund të vitit 2011, rreth 69 mijë llogari kanë qasje "online" në internet për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, duke shënuar një rritje prej 37 për qind në krahasim me vitin 2010. Pavarësisht rritjes së ndjeshme të këtij treguesi gjatë vitit 2011, niveli i shfrytëzimit të llogarive bankare me "e-banking" vazhdon të mbetet në nivele të ulëta.

Në krahasim me shtetet e tjera në Evropën Qendrore dhe Juglindore, Kosova ka edhe shumë punë për të bërë. Sa i përket numrit të terminaleve për 1 milion banorë, Kosova vazhdon të qëndrojë ndër vendet e fundit në rajon. Mirëpo, shenjë pozitive në këtë drejtim është ritmi më i shpejt i zhvillimit të infrastrukturës sesa mesatarja e zhvillimit në vendet e regjionit. Situatë e ngjashme është edhe tek kartelat bankare. Numri i kartelave me funksion pagese vazhdon të rritet.

Tabela 46. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave[35]

Përshkrimi	Kosova	Shqipëria	Republika Çeke	Turqia	Sllovenia	Bullgaria	Hungaria	Bosnja	Kroacia	Maqedonia
Banorë	2.1	3.19	10.51	73.3	2.05	7.54	10.02	3.77	4.42	2.06
Sipërfaqja (km^2)	10,887	28,748	78,865	783,562	20,273	110,879	93,028	51,197	56,594	25,713
Densiteti (për km^2)	193	111	133	94	101	68	108	74	78	80
ATM	460	771	3,742	27,649	1,814	5,718	4,843	1,098	3,794	869
për 1 milion banorë	219	242	356	377	885	758	483	291	858	422
për 100 km^2	4	3	5	4	9	5	5	2	7	3
POS	7,534	4,903	96,958	1,823,530	35,622	60,762	78,441	17,834	92,690	31,491
për 1 milion banorë	3,587	1,537	9,225	24,878	17,377	8,059	7,828	4,731	20,971	15,287
për 100 km^2	69	17	123	233	176	55	84	35	164	122
Kredit Kartelat	74,873	27,300	1,587,889	46,956,124	122,638	992,428	1,367,928	-	1,990,395	303,158
për 1 milion banorë	35,654	8,558	151,084	640,602	59,823	131,622	136,520	-	450,316	147,164
Debit Kartelat	548,253	667,548	7,888,879	69,916,462	2,742,470	6,623,423	7,553,209	-	6,846,034	1,048,180
për 1 milion banorë	261,073	209,263	750,607	953,840	1,337,790	878,438	753,813	-	1,548,876	508,825
E-Banking	68,992	27,368	-	/	-	-	-	67,802	989,862	211599

Burimi: BQK (2012) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

5.4. Menaxhimi i Mjeteve

5.4.1 Menaxhimi i Mjeteve dhe Politika e Investimeve të BQK-së

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore (BQK) Nr.03/L-209 (Neni 1, paragrafi 1.6), BQK-ja vepron si agjent fiskal i Qeverisë ndërsa sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048 (Neni 7), BQK është autorizuar të investojë mjetet e Qeverisë. Kjo formë e investimeve financiare mundëson kthimin në investime, krijimin e mjeteve të paguara nga interesi, mjete të cilat pastaj derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Fondet e depozituara në BQK ju takojnë kryesisht Institucioneve Qeveritare; Ministrisë së Financave (rezervat buxhetore), Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)-së si dhe institucioneve financiare (rezervat e obligueshme për likuiditet).

Menaxhimi i investimeve të Thesarit kryhet nga BQK në marrëveshje me Thesarin përmes Komitetit të Likuiditetit i cili mbahet rregullisht çdo muaj. AKP filloi afatizimin e fondit të saj që nga gushti 2010 në depozita bankare me afat maturimi deri në një vit. Këto investime janë kryer në pajtim me Politikën e Investimeve dhe Politikën e Normës së Kamatës të aprovuara nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së. Poashtu BQK-ja është e ngarkuar me menaxhimin e fondeve të depozituara nga agjencitë publike, institucionet financiare, dhe organizatat donatore.

Politika e Investimeve e aprovuar nga Bordi i BQK-së implementohet nga ana e Drejtoratit të Menaxhimit të Mjeteve. Për shkak se një pjesë e madhe e fondeve që menaxhohen janë mjete të fondeve publike, të cilat mund edhe të kthehen për një afat të shkurtër kohor, objektivat primare sipas politikës së investimeve janë siguria, likuiditeti dhe kthimi në investime.

[35] Të dhënat në tabelë janë nga viti 2010 pasi që disa nga vendet në rajon të dhënat për vitin 2011 nuk i kanë publikuar akoma, ndërsa të dhënat për Kosovën i takojnë vitit 2011.

5.4.2 Menaxhimi i Mjeteve në vitin 2011

Në pajtim me politikën e investimeve, e aprovuar nga Bordi i BQK-së më 16 Mars 2011, përgjatë vitit 2011 të gjitha mjetet janë investuar në instrumente financiare që bien në kategorinë e instrumenteve më të sigurta dhe më likuide. Respektivisht, dy janë kategoritë e instrumenteve financiare në të cilat janë investuar mjetet nën menaxhimin e BQK-së:

- depozitat e afatizuara në institucione financiare me rangim/vlerësim superior, përkatësisht euro-depozita të afatizuara me banka komerciale dhe qendrore të shteteve më kredibile të BE-së dhe Eurozonës, dhe
- bonot e thesarit të shteteve me ekonomi më të avancuara të Eurozonës me maturitet maksimal deri në një vit dhe të emetuara në euro.

Figura 111. Raporti i Investimeve të BQK-së



Burimi: BQK (2012)

Duke iu përmbajtur kriterit mbi sigurinë e kapitalit dhe likuiditetit, të gjitha mjetet e investuara në depozita dhe bono thesari janë bërë me afat të shkurtër kohor, përkatësisht horizonti kohor mesatar i investimeve për vitin 2011 është 13 ditë (horizonti kohor i investimeve në depozita dhe bono thesari sillet prej 1 ditë deri në 365 ditë), ndërsa rangimi afat-shkurtër i institucioneve financiare është jo më i vogël se A-2, P-2 apo F1 nga agjencitë më të mëdha të rangimit (Standard and Poor's, Moody's Investors Services dhe Fitch Ratings).

Sipas këtij principi, rreth 40.79% e investimeve në depozita janë bërë në Banka Qendrore të tri shteteve më eminente të Eurozonës, respektivisht në Bankën Qendrore të Gjermanisë (Deutsche Bundesbank), Bankën e Francës (Banque de France) dhe Bankën Qendrore të Luksemburgut (Banque Centrale du Luxembourg). Më 31 Dhjetor 2011, 2.35% të mjeteve janë lënë në bono thesari të Belgjikës, instrumente borxhi këto që ende kanë rangim apo notë superiore afatshkurtër prej P-1 dhe A-1 nga agjencitë e lartpërmendura të rangimit.

Viti 2011 u karakterizuara si vit i vazhdimit të vështirësive për ekonominë e Eurozonës e cila u prek nga kriza e borxheve sovrane të një numri shtetesh brenda këtij unioni monetar. Në këto kushte të vështira tregu, kthimet në instrumente borxhi të denominuara në Euro u bënë të pafavorshme për investime. Mundësia për të investuar në instrumente afat-shkurtra borxhi sovran u nda në dysh. Mundësia e parë ishte investimi në bono

Figura 112. Shpërndarja e investimeve përgjatë muajve



Burimi: BQK (2012)

thesari të shteteve më të sigurta si Gjermania, Franca, Finlanda dhe Holanda që ofruan norma kthimi jashtëzakonisht të ulëta, zero dhe madje edhe negative, duke e bërë kështu të kushtueshëm dhe jo-profitabil investimin në këto instrumente. Mundësia e dytë ishte investimi në bono thesari të shteteve që ofruan norma atraktive interesi por me risk më të lartë si Italia, Portugalia dhe Irlanda.

Duke konsideruar këtë gjendje të pafavorshme dhe rrezikun e lartë të tregut, BQK zvogëloi alokimin e mjeteve për investime në bono thesari duke alokuar kështu më shumë mjete për investime në depozita afat-shkurtëra. Kjo alternativë ofroi kontroll më të madh mbi rrezikun dhe nevojat e likuiditetit. Prej afërsisht 22% të mjeteve që u investuan në bono thesari nga totali i portfolios në janar 2011, ky raport ra në vetëm 2.35% në dhjetor 2011. Rrjedhimisht, investimet në depozita të afatizuara filluan të rriten nga muaji i shtatë i vitit, ku prej afër 75% të mjeteve të portfolios të investuara në depozita në janar, ky raport u ngrit në mbi 97% në dhjetor të vitit 2011.

Figura 113. Mesatarja mujore e ofruar e realizuar për portfolion e BQK-së



Burimi: BQK (2012)

Krahasuar me vitin 2010 rritja e rezervave apo mjeteve nën menaxhim e BQK-së është me 3.11% më e lartë. Kjo rritje vjen edhe si rezultat i kthimeve më të mëdha nga investimet që janë arritur përgjatë vitit 2011.
Norma mesatare në investimet në depozita dhe bono thesari arriti 0.84% për 2011, që është 2.7 herë më e lartë krahasuar me normën e kthimit të realizuar gjatë vitit 2010.

Faktorët kryesor që kanë ndikuar në realizimin e një norme të kthimit më të lartë në 2011 mund ti përmbledhim si në vijim:

(i) Përmirësimi i gjendjes në tregun e parasë në Eurozonë gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 që filloi me rritjen e normave të interesit në tregun e huasë ndër-bankare. EONIA (anglisht: Euro Overnight Index Average), përkatësisht Indeksi Mesatar i Euro 'brenda natës',gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2011 është 0.85%. Ky indeks është

Figura 114. Mesatarja kthimit në portfolio dhe kthimit në benchmark



Burimi: BQK (2012)

pikë referimi për normat e interesave në investimet një-ditore që BQK i kryen përmes llogarisë rrjedhëse me Deutsche Bundesbank, Raiffeisen Bank International dhe Commerzbank[36].

(ii) Rritjes së përgjithshme të normave të interesit për huatë ndër-bankare prej atyre një javore deri në një vit[37]. Kjo rritje është rezultat i: a) largimit të investitorëve nga tregu i borxheve për shkak të luhatjeve në çmimet e letrave me vlerë dhe fokusimit të tyre në investimet afat-shkurtëra në tregun ndër-bankar. b) Rritjes së kërkesës për likuiditet në treg për shkak të masave të ndërmarra nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), njëra prej të cilave ishte ndryshimi i normave të interesit nga BQE me 13 Prill 2011 që ishte edhe ndërhyrja e parë që nga maji i vitit 2009[38].

5.4.3 Menaxhimi i Rrezikut të Investimeve

5.4.3.1 Rreziku i Normës së Interesit dhe Rreziku Kreditor

Matjen relative të rrezikut të normës së interesit mund ta bëjmë duke krahasuar normën e realizuar te interesit apo kthimit në portofolio me normën e interesit të një pikë referuese apo krahasuese (+- marzha). Pikat referuese me të cilat i kemi krahasuar kthimet në portofol janë EONIA dhe EURIBOR (anglisht: Euro Interbank Offered Rate), përkatësisht Norma e ofruar për depozita ndërbankare për 2011 që janë norma mesatare të fondeve të ofruara në tregun ndër-bankar.

Gjatë vitit 2011 është vendosur një pikë referuese prej EONIA – 0.30% për depozita një ditore, dhe EURIBOR 1-javor – 0.30% për depozita 1-javore. Norma e realizuar e kthimit në portofolin e BQK-së prej 0.84% e tejkalon horizontin prej 0.47% deri në 0.73%, që nënkupton një realizim më të mirë të kthimit në raport me pikat referuese.

Matja relative e rrezikut të normës së interesit mund të bëhet edhe duke marrë indikatorë statistikorë që kapin efektet e ndryshueshmërisë apo volatilitetit të normave të interesit si devijimin standard apo variancën. Devijimi standard në normën e interesit për vitin 2011 rezulton të jetë +/-0.237%, që nënkupton se normat e interesit në mesatare mund të shmangen negativisht prej 0.237% apo 23.7 pika bazë që është më e vogël se marzha e përcaktuar prej -0.30%. Kjo nënkupton që është tentuar të mbahet një rrezik mjaft i ulët për portofolio nga ndryshimi i normave të interesit në treg.

5.4.3.2 Oscilimet e tregut

Lidhur me zhvillimet e tregjeve financiare, viti 2011 ka qenë vit i karakterizuar me luhatshmëri (volatilitet) të shumta. Përkeqësimi i gjendjes financiare të Greqisë dhe kërcënimi që rrjedh nga falimentimi i mundshëm i këtij shteti si dhe jo-stabiliteti i vendeve të eurozonës kanë bërë që shumë investitorë të ndjejnë vetën si të pafuqishëm. Mirëpo edhe përkundër gjendjes kritike në tregjet financiare, BQK-ja ka arritur që të alokojë mjetet e saja në instrumentet më të sigurta financiare duke e mbajtur rrezikun kreditor, atë të

[36] Mesatarja e EONIA-s për vitin 2010 është 0.44%, përderisa në gjysmën e pare të vitit 2011 kjo normë mesatare është 0.85%, rritje kjo pë 93%.

[37] Këtu pikë referimi marrim Euribor 1-Muaj, Euribor 3-Muaj dhe Euribor 6-Muaj. Këto norma mesatare janë dyfishuar në krahasim me vitin 2010.

[38] Më 13 Prill 2011, BQE rriti me 0.25% tri normat kyçe, repsketivisht Normën e Huadhënies nga 1.75% në 2.00%, normën në operacionet e ri-financimit nga 1.00% në 1.25%, dhe normën në depozita nga 0.25% në 0.50%.

likuiditetit, rrezikun e tregut si dhe atë operacional gjatë gjithë kohës nën kontroll dhe duke siguruar në çdo kohë likuiditet të mjaftueshëm.

5.4.3.3 Operacionet e Tregut të Letrave me Vlerë

Në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike Nr. 03/L-175, (Neni 2, paragrafi 1.1. dhe 1.2.) Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) vepron si agjent i Ministrisë së Financave (MeF) për të zbatuar detyrat e caktuara që kanë të bëjnë me çështjet fiskale të Republikës së Kosovës dhe si autoritet monetar i Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj, BQK ka për detyrë të zhvillojë ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë, të regjistrojë emetimin dhe transferimin e letrave me vlerë të dematerializuara, lehtësojë themelimin e tregut sekondar për Letrat me Vlerë të Qeverisë si dhetë kryejë, lehtësojë çfarëdo aktiviteti tjetër në lidhje me emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Dokumentet ligjore të aprovuara në dhjetor të vitit 2011 nga BQK dhe MeF (Rregullorja për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë dhe Marrëveshja mbi Akterët Primar) paraqesin bazën themelore për operimin e tregut primar dhe sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në dhjetor të vitit 2011, Akterët Primar janë njoftuar edhe me kalendarin e parashikuar të emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës për vitin 2012.

Në mars të vitit 2011, BQK ka krijuar Divizionin e Operacioneve të Tregut të Hapur i cili ka për detyrë themelore implementimin e ligjeve dhe rregulloreve lidhur me tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë. Themelimi me kohë dhe trajnimi adekuat i personelit nga ana e ekspertëve të Departamentit të Thesarit të SHBA-ve ka bërë që Projekti i Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës të funksionalizohet saktësisht si në kohë ashtu edhe në përmbajtje.
Në qershor të vitit 2011 kanë filluar përgatitjet teknike dhe funksionale me qëllim të implementimit të projektit për tregtimin në mënyrë elektronike të Letrave me Vlerë në tregun Primar dhe Sekondar. Në këtë kontekst, BQK ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për sigurimin dhe instalimin e sistemit të tregtimit dhe të shlyerjes së Letrave me Vlerë të Qeverisë,kështuqë Sistemii Regjistrit Kontabël (SRK) tashmë përfshin katgeoritë kryesore të tregut të letrave me vlerë si:

- Mbajtjen e regjistrit të emetimit dhe transferimit të letrave me vlerë të dematerializuara;
- Regjistrimin etransaksioneve të letrave me vlerë dhe pronësisë me letra me vlerë;
-Monitorimin e pjesëmarrësve me qëllim të menaxhimit të rrezikut lidhur me transaksionet.

Ky sistem elektronik është ndërlidhur në mënyrë automatike me Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar të BQK-së, duke mundësuar kështu shlyerjen e të gjitha transaksioneve të letrave me vlerë në mënyrë elektronike.
Platforma për tregtimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës është projekt i financuar nga Ministria e Financave, Departamenti i Thesarit, vlera e të cilit ka arritur në 1,102,524.00 USD.

5.4.4 Procesi i tregtimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë

Letrat me Vlerë të Qeverisë ofrohen për shitje përmes ankandeve të organizuara dhe mbajtura nga ana e BQK-së. Në ankande tash për tash marrin pjesë si Akterë Primar

shtatë banka komerciale, ndërsa palët tjera të interesuara mund të marrin pjesë në mënyrë indirekte përmes Akterëve Primar.

Norma e interesit për tregtimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë përcaktohet nga tregu varësisht prej ofertës dhe kërkesës. Pritet që gradualisht të krijohen kushte për pjesëmarrje edhe te akterëve tjerë përveç bankave komerciale.

5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës

5.5.1 Gjenerimi i certifikatave autorizuese

Furnizimi i institucioneve kredidhënëse dhe kredimarrësve me informacionet e nevojshme kreditore individuale përmes sistemit të Regjistrit të Kredivetë Kosovës (RKK) është një shërbim me rëndësi i BQK-së. RKK-ja është dizajnuar si një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejte në kohë reale nga institucionet kredidhënëse. Qasja mund të bëhet vetëm nga zyrtarët e autorizuar të paisur paraprakisht me certifikata autorizuese. Këto certifikata autorizuese gjenerohen nga regjistri i kredive duke u bazuar në kërkesat e arritura me autorizim të veqantë nga anëtarët e sistemit të regjistrit të kredive. Në bazë të rregulloreve në fuqi , të gjitha institucionet kredidhënëse të licencuara nga ana e BQK-së janë anëtarë të këtij regjistri. Aktualisht, janë gjithsejt 28 institucione me 1200 përdorues aktiv në sistemin e regjistrit të kredive. Gjatë vitit 2011, regjistri i kredive ka gjeneruar 507 certifikata të reja si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare.

Figura 115. Numri i çertifikatave të gjeneruara në baza mujore



Burimi: BQK (2012)

5.5.2 Hulumtimet në sistemin e regjistrit të kredive

Përdoruesit e sistemit të regjistrit të kredive, të cilët janë të autorizuar nga institucionet kredidhënëse , i qasen sistemit me qëllim të hulumtimit mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor. Sipas statistikave të nxjerrura nga sistemi i regjistrit të kredive, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2011 ka kaluar shifrën prej 920 000 hulumtimeve.

Figura 116. Hulumtimet në sistemin e regjistrit të kredive



Burimi: BQK (2012)

5.5.3 Raportimi i kredive të reja nga institucionet kredidhënëse

Sipas Rregullës Bankare nr. XXVIII dhe mbështetur në sistemin e zhvilluar të RKK-së, të gjitha institucionet kredidhënëse –anëtare të sistemit të regjistrit të kredive janë të obliguara që të raportojnë informacionet mbi kreditë e aprovuara dhe të shpërndara .

Gjatë vitit 2011, nga ana e institucioneve kredidhënëse , në sistemin e regjistrit të kredive ,janë raportuar mbi 200,000 kredi të reja.

Figura 117. Raportimi i kredive të reja nga institucionet kredidhënëse



Burimi: BQK (2012)

Sipas grafikut të paraqitur, nga muaji gusht 2011 deri në fund të vitit 2011 kemi një trend rritës të kredive të raportuara.

Në bazë të të dhënave të nxjerrura nga sistemi i regjistrit të kredive, në vijim është paraqitur numri i kredive aktive dhe numri i kredive të klasifikuara me "writte-off" përgjatë vitit 2011 duke specifikuar numrin në baza mujore.

Subjekte të të dhënave të informacionit të RKK-së janë personat fizikë dhe bizneset si kredimarrës individualë. Nëse konsiderohet e nevojshme, p.sh. për të verifikuar shënime të diskutueshme, çdo kredimarrës individual mund të marrë detajet e veta kreditore të regjistruara në RKK, në BQK. Gjatë vitit 2011 janë gjeneruar mbi 480 raporte të tilla.

5.5.6 Projekti "BEEP"

Projekti trevjeqar për përmirësimin e ambientit biznesor në Kosovë – "BEEP" (anglisht: Business Environment Enhancement Project", përmes një komponente është i përqëndruar edhe në fushën e raportimit dhe informacionit kreditor, konkretisht në regjistrin e kredive.Me qëllim të identifikimit të segmenteve të nevojshme për avansim, janë zhvilluar shumë aktivitete, hulumtime dhe punë permanente përgjatë vitit 2011. Është punuar në segmentin legjislativ, informativ si dhe avansimin e sistemit të regjistrit të kredive në përgjithësi. Lidhur me këto qështje janë mbajtur dy seminare në forma të veçanta për banka komerciale dhe për institucione kredidhënëse. Produkt konkret i tërë këtyre aktiviteteve mund të përmenden draftimi i Rregullores së re mbi Regjistrin e Kredive dhe publikimi i broshurës informative dedikuar kredimarrësve. Regjistri i Kredive të Kosovës është anëtar i Asociacionit ndërkombëtar të regjistrit të kredive.

5.5.8 Raporti i të bërit biznes (anglisht: "Doing Bussines 2012")

Edhe në vitin 2011, regjistri i kredive ishte kontribues i drejtpërdrejtë në të dhënat e mbledhura nga Banka Botërore me qëllim të raportit mbi të bërit biznes për vitin 2012. Sipas raportit të publikuar , fusha mbi marrjen e kredisë (anglisht: "getting credit") gjatë tri viteve në vazhdimësi pasqyron përmirësim, duke u radhitur në të njëjtin nivel me vendet e rajonit.

5.6. Aktiviteti në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Në kuadër të avancimit të mëtutjeshëm të funksioneve dhe përgjegjësive, gjatë vitit 2011, Drejtoria për Analiza Ekonomike (DAE) u promovua në Departamentin për Stabilitet

Financiar dhe Analiza Ekonomike (DSFAE). Rrjedhimisht, DSFAE objektivi kryesor i DSFAE është të sigurojë një vlerësim sa më të mirë të stabilitetit financiar në vend, duke gërshetuar zhvillimet e sektorit financiar në vend me zhvillimet e përgjithshme ekonomike.

Gjatë vitit 2011, DSFAE publikoi numrin e dytë të Raportit të Stabilitetit Financiar, i cili paraqet një analizë të hollësishme të gjendjes së sistemit financiar në vend dhe mes tjerash përfshinë edhe një numër të analizave specifike që trajtojnë tema të veçanta rreth zhvillimeve në sektorin financiar dhe ekonominë e vendit në përgjithësi.

DSFAE vazhdoi të përpilojë në baza të rregullta analizën 'stres-test' për sistemin bankar, i cila po paraqet një vegël të mirë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së bankave që operojnë në Kosovë. Po ashtu, për të vëzhguar sa më mirë zhvillimet për sa i përket qëndrueshmërisë së sistemit financiar në vend, DSFAE vazhdoi ti përpilojë në baza të rregullta treguesit e shëndetit të sistemit financiar.

Gjatë vitit 2011, DSFAE ka shënuar progres të rëndësishëm në përgatitjen e modelit për parashikimin e bilancit të gjendjes dhe pasqyrës së të ardhurave të sistemit bankar, i cili do të ndihmoj parashikimin e zhvillimeve të ardhshme në sistemin bankar por edhe parashikimin e zhvillimeve të përgjithshme makroekonomike në vend.

Ndër projektet e reja të DSFAE gjatë vitit 2011 ishte edhe fillimi i implementimit të anketës mbi kreditimin bankar me bankat që operojnë në Kosovë. Ky projekt ka për qëllim që të rrisë kapacitetet për vlerësimin sa më të mirë të zhvillimeve në aktivitetin kredidhënës në vend. Anketa mbi kreditimin bankar ofron një pasqyrë të gjerë të zhvillimeve të standardeve kreditore, rregullave dhe kushteve kreditore, perceptimin e bankave për rrezikun, gatishmërinë e bankave për të zgjeruar kreditimin dhe po ashtu ofron një pasqyrë të faktorëve që ndikojnë kërkesën për kredi.

Gjatë vitit 2011, DSFAE avancoi metodologjinë e përpilimit të Indikatorëve të Paralajmërimit të Hershëm, duke bërë të mundur vlerësimin e kuantifikuar të ndikimit të zhvillimeve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së vendit në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik dhe rrezikun ekonomik. Për më tepër, metodologjia e re ka bërë të mundur përcaktimin e peshave të ndryshme në ndikimin që zhvillimet në sektorë të veçantë të ekonomisë mund të kenë në aktivitetin dhe rrezikun e ekonomik brenda ekonomisë së vendit.

Gjatë kësaj periudhe, DSFAE gjithashtu ka avancuar Buletinin e Bilancit të Pagesave në Raportin e Bilancit të Pagesave, publikim ky që publikohet në baza të rregullta dhe paraqet një analizë të hollësishme rreth zhvillimeve makroekonomike në përgjithësi dhe bilancit të pagesave të ekonomisë së Kosovës në veçanti. Ky publikim periodik përmban edhe analiza të veçanta të cilat adresojnë segmente të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimet ekonomike në vend e posaçërisht me ato të ndërlidhura me bilancin e pagesave.

Në vitin 2011, në kuadër të Buletinit Mujor Statistikor, DSFAE ka vazhduar të publikojë analizat tremujore rreth zhvillimeve ekonomike në vend dhe në sektorin e jashtëm, duke përfshirë edhe diskutime të veçanta rreth krahasimit të segmenteve të caktuara të ekonomisë së Kosovës me ato të rajonit.

Gjatë vitit 2011, DSFAE ka organizuar një konferencë ku është prezantuar Raporti i Stabilitetit Financiar si dhe ka marrë pjesë në takime dhe konferenca të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, gjatë vitit 2011 stafi i DSFAE ka marrë mirënjohje nga Guvernatori i BQK-së për arritje të veçantë në fushën kërkimore në arenën ndërkombëtare si dhe për përfaqësim ekzemplarë në seminare ndërkombëtare në vitet e kaluara. Si rezultat i inkurajimit dhe njohjes së kompetencës hulumtuese, në vitin 2011 stafi i DSFAE

është shpërblyer nga UNDP me çmimin për studimin më të mirë në fushën e dërgesave të emigrantëve në një konkurrencë ndërkombëtare. Stafi DSFAE gjatë vitit 2011 ka qenë aktiv edhe në fushën e komunikimit me publikun në shërbim të transparencës ndaj publikut rreth zhvillimeve të sektorit financiar dhe atyre ekonomike në përgjithësi.

5.7. Aktivitetet në fushën e statistikave

Sikurse edhe viteve paraprake, Departamenti i Statistikës së BQK-së ka vazhduar me ritmin e hovshëm të zhvillimit edhe gjatë vitit 2011. Miratimi i rregulloreve të reja, përgatitja e projekteve statistikore për institucionet jo bankare, e po ashtu edhe publikimi i statistikave të bilancit të pagesave në frekuencë tremujore, paraqesin disa nga arritjet gjatë vitit 2011. Bashkëpunimi i suksesshëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) në kontekst të ekspertizës në fusha të caktuara statistikore si dhe në kontekst të raportimit statistikor në FMN paraqet një atribut tjetër të veçantë.

Me qëllim të përforcimit të mëtutjeshëm të bazës ligjore lidhur me përpilimin dhe shpërndarjene statistikave që janë përgjegjësi direktee BQK-së, në nëntor 2011 u miratuan këto rregullore:

- *Rregullorja për Statistikat Monetare – Financiare dhe Llogaritë Financiare,* dhe
- *Rregullorja mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare*.

Përderisa rregullorja e parë mundëson raportimin për qëllime statistikore të të gjitha institucioneve financiare (bankare dhe jo bankare), rregullorja e dytë përforcon aspektin ligjor lidhur me obligimet statistikore të raportueseve që kanë të bëjnë me sektorin jo financiar.

Në fushën e statistikave monetare – financiare, viti 2011 karakterizohet me përgatitjet respektivisht finalizimin e disa projekteve statistikore, e që kanë filluar së zbatuari në janar 2012. Për më shumë, është fjala për *Raportin Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare*, *Raportin mbi Normat e Kamatës së Institucioneve Mikrofinanciare* si dhe *Raportin Statistikor mbi Agjencitë për Transferimin e Parave*. Këto projekte statistikore janë konsistent me standardet statistikore ndërkombëtare të FMN-së, Bankës Qendrore Evropiane, Eurostatit, etj.Me këtë është shkurtuar edhe frekuenca e raportimit nga ajo tremujore në mujore. Që nga viti 2011 statistikat e bilancit të pagesave kanë filluar të publikohen në frekuencë tremujore. Për më shumë, publikimi i këtyre statistikave në frekuencë mujore planifikohet të ndodhë që nga viti 2013. Përveç kësaj, gjatë vitit 2011 për herë të parë, janë përpiluar statistikat mbi pozicionin e investimeve ndërkombëtare, të publikuara në fillim të vitit 2012.

Sa i përket bashkëpunimit me FMN-në dhe me institucionet tjera, Departamenti i Statistikës ka vazhduar me raportimin e rregullt periodik në FMN në kuadër të disa publikimeve ku me këtë rast do të veçoheshin:

- Statistikat Financiare Ndërkombëtare (angl.: *International Financial Statistics*),
- Vjetari Statistikor i Bilancit të Pagesave (angl.: *Balance of Payments Statistical Yearbook*),
- Anketa mbi Qasjen Financiare (angl.: *Financial Access Survey*), dhe
- Raporti mbi Stabilitetin Financiar Global (angl.: *Global Financial Stability Report*).

Po ashtu, në baza të rregullta periodike është vazhduar raportimi në kuadër të programit Stand-By me FMN-në. Për herë të parë, gjatë vitit 2011 është filluar me raportimin në Eurostat të indikatorëve të zgjedhur statistikor nga fusha e bilancit të pagesave, krahas raportimit të shtetet e tjera.

Statistikat e përpiluara janë publikuar në publikimet periodike dhe joperiodike të BQK-së. Në këtë kontekst do të veçoheshin Buletini Mujor Statistikor i cili publikohet për më shumë se 10 vite me radhë, si dhe Seritë Kohore të BQK-së që paraqesin publikimet kryesore statistikore. Përveç kësaj, statistikat monetare – financiare dhe të sektorit të jashtëm shërbejnë si input kyç edhe për publikimet tjera të BQK-së. Stafi i Departamentit të Statistikës ka prezantuar BQK-në disa takime ndërkombëtare në kuadër të fushës përkatëse siç janë: Komiteti i Statistikave Monetare – Financiare dhe të Bilancit të Pagesave të organizuara nga Eurostat, etj.

Në veçanti duhet theksuar se gjatë vitit 2011, drejtori i Departamentit të Statistikës, ka kryer me sukses të plotë misionin e tij të parë në cilësinë e ekspertit për statistika monetare dhe financiare të FMN-së në Bankën Qendrore të Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa Udhëheqësi i Divizionit për Bilancin e Pagesave në BQK është pranuar në listën e ekspertëve të FMN-së lidhur me statistikat e bilancit të pagesave.

6. Zhvillimet e brendshme

6.1. Kontrolli i brendshëm

Shefi i Auditimit të Brendshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë si dhe kompetencat e Shefit të Auditimit të Brendshëm (ShAB) janë të definuara dhe të përcaktuara me Ligjin e BQK-së (nenet 60 dhe 61). Pas implementimit të rekomandimeve te FMN-së, përkatësishtmisionit të vlerësimit të cilësisë së proceseve dhe procedurave të BQK-së (anglisht: "Safeguard assessment"), ShAB ka vazhduar te jetë i fokusuar vetëm në fushën a auditmit të brendshëm.

Auditmi i Brendshëm

Gjatë vitit 2011 është realizuar plani i punës i paraparë për këtë vit, plan ky i përpiluar konform standardit të IIA 2010 (planifikimi) .Bazuar në statusin e Auditorit të Brendshëm në BQK (*anglisht:* Audit Charter) dhe konform standardit 2020 (komunikimi dhe aprovimi) , Shefi i Auditimit të Brendshëm ka prezantuar planin vjetor të punës së Departamentit të Auditimit të Brendshëm (DAI)për vitin 2011 para Komitetit të Auditimit dhe pas aprovimit nga ky Komitet plani vjetor i punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2011 është prezantuar para Bordit të BQK-së dhe është aprovuar nga ky Bord.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm i përmbahet strategjisë sipas së cilës plani vjetor i punës së Auditimit të Brendshëm ka rolin kyç në rritjen e kualitetit dhe në përmbushjen e qëllimeve, objektivave dhe misionit të cilin e ka DAI.

Gjatë vitit 2011 është implementuar rekomandimii Fondit Monetar Ndërkombëtar i dhënë përmes Raportit mbi vlerësimin e proceseve dhe procedurave të BQK-së (anglisht: "Safeguards Assesment")kështuqe janëaudituar proceset dhe sistemet(gjithëpërfshirëse) si ai iFlexcube, Statistikës, Resurseve Humane, Sistemit Ndërbankar të Pagesave dhe Regjistrit të Kredive të Kosovës.

Për përcjelljen e Portofolios së Investimeve në Bankat Korrespondente të BQK-së, Auditimi i Brendshëm gjatë vitit 2011 ka përgatitur 52 raporte speciale në baza javore, për periudhën Janar-Dhjetor 2011.Përveç auditimeve të parapara me planin vjetor të punës të DAI, gjatë viti 2011 me kërkesën e Shefit të Auditimit janë performuar 11 auditime të rastit "Ad Hock" .

Bazuar në Memorandumin Teknik të Mirëkuptimit ndërlidhur me Programin me FMN-nëjanë performuar gjashtë (6) auditime të pavarura të barazimit të llogarive të Qeverisë në baza kuartale, ku katër (4) prej këtyre auditimeve janë realizuar për vitin kalendarik 2011 dhe dy (2) auditime për periudhën Korrik-Dhjetor për vitin 2010.

Duke u bazuar në standardin e IIA 2500 (monitorimi i progresit)për përcjelljen e implementimit të rekomandimeve (anglisht: Follow up) është përpiluar raporti i veçantë për periudhën Janar-Dhjetor 2011 ku janë përcjellë edhe rekomandimet e raporteve të auditimit të bëra gjatë vitit 2010. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet, rekomandimet, përgjigjet e menaxhmentit, statusi i rekomandimit dhe përgjigjet e auditorëve.

Gjatë viti 2011 janë përpiluar katër raporte mbi pasqyrimin e punës së Auditimit të Brendshëm për periudhat tremujore. Këto raporte të përgatitura janë dorëzuar te Shefi i Auditimit të Brendshëm i cili më pas i ka përcjellë tek Komiteti i Auditimit konform ligjit nr.03/l-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 61 detyrat e Shefit të Auditimit të Brendshëm, paragrafi 1.4. Në këto raporte është prezantuar puna e auditorëve të brendshëm të cilët kanë ofruar opinionet e tyre të pavarura dhe objektive lidhur me menaxhimin e riskut, qeverisjen dhe vlerësimin efektiv në arritjen e objektivave të institucionit bazuar në standardin e IIA 1100 (mbi pavarësinë dhe objektivitetin). Objektivat kryesore të auditorëve të brendshëm të BQK-së (statuti i auditimit të brendshëm)kanë qenë të fokusuara në auditimin e respektimit të ligjit dhe rregullave në fuqi (objektivi i legjitimitetit), në auditimin e prezantimit të informacionit të plotë financiar dhe menaxherial (objektivi i informimit) dhe në auditimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shfrytëzimit të aseteve dhe burimeve të tjera të BQK-së(objektivi i biznesit).

Fushat e identifikuara të auditimit sipas shkallës së riskut për periudhën 2008-2011 janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike si më poshtë:

Tabela 47. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut (2008-2011)

Drejtoratete	2011	2010	2009	2008
Menaxhimi i Mjeteve	16.00%	11.00%	16.90%	14.00%
Shërbimet e Përgjitshme	12.90%	9.10%	8.30%	
Kontabiliteti	11.20%	9.90%	15.60%	18.00%
Teknologjia Informative	10.30%	10.00%	4.20%	
Prokurimet	9.30%	9.20%	10.40%	10.00%
Arka dhe Trezori	7.30%	17.80%	16.50%	14.00%
Resurset Humane	6.10%	8.80%	9.40%	
Mbikqyrja Finaciare	5.00%	6.40%		

Burimi: BQK (2012)

Me qëllim të ruajtjes së raporteve, përcjelljevedhe letrave të punësnë vitin 2011 është krijuar arkiva elektronike në serverët e BQK-së. Në këtë arkivë auditorët kanë mundësinë

e qasjes dhe arkivimit të raporteve të tyre dhe dokumentacionit përcjellës. Qasja në arkivë bëhet sipas procedurave të shkruara nga auditorët dhe të aprovuara nga Shefi i Auditimit të Brendshëm.

Në funksion të implementimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2011 është bërë kodimi i raporteve dhe letrave të punës për të cilat ekzistojnë procedurat e shkruara të cilat janë të aprovuara nga Shefi i Auditimit të Brendshëm.Gjithashtu është bërë standardizimi i formave përcjellëse me rastin e përpilimit të raportit të auditimit. Këto forma përcjellëse janë:
Formati i raportit të auditimit të brendshëm,
Forma e mbajtjes së evidencës lidhur me procesin e auditimit,
Forma për indeksimin e letrave të punës.

Figura 118. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut për periudhën 2008-2011



Burimi: BQK (2012)

Duke implementuar rekomandimin e FMN-sëështë krijuar forma e "Planit të aksionit dhe kornizës kohore" e cila i bashkëngjitet secilit raport të auditimit me qëllim të pasqyrimit të gjetjeve, rekomandimeve, komenteve të stafit përgjegjës (komentet e menaxhmentit) dhe përgjigjet e auditorëve. Në tabelë është futur edhe kolona në të cilën vendosen afatet kohore për implementimin e rekomandimeve. Gjithashtu përmes kësaj tabele mundësohet edhe përcjellja e implementimit të rekomandimeve nga raportet paraprake në rast se ato ekzistojnë.

Është definuar "Universi iAuditimit2012-2014" duke marrë për bazë strukturën e re organizative të BQK-së dhe matricën e riskut. Universi i auditimit përmban nëntë (IX) zona të auditimit, ku secila zonë e auditimit e ka kodin e vet identifikues. Brenda zonave janë përcaktuar auditimet të cilat kryhen në pajtim me planin e Universit te Auditimit për vitin 2012-2014. Këto auditime janë koduar në mënyrë që kodi i secilit auditim përmban kodin e zonës të cilës i përket dhe numrin rendor. Në tabelën e më poshtë për sqarim është dhënë tabela vetëm për një zonë auditimi:

Tabela 48. Zona e auditimit

Numri	KODI	EMRI	ZONA
1	DPRF-001	Auditimi i Raportiti të Menaxhmentit	Departamenti i Planifikimit dhe Raportimit Financiar - DPRF
	DPRF-002	Auditimi i Llog. të Pagueshme dhe Patty Cash	Departamenti i Planifikimit dhe Raportimit Financiar - DPRF
	DPRF-003	Auditimi i Buxhetit	Departamenti i Planifikimit dhe Raportimit Financiar - DPRF

Burimi: BQK (2012)

Nga Universi i Auditimit2012-2014 është nxjerr edhe plani i punës së DAI-së për 2012. Plani vjetor i auditimit të brendshëm është përpiluar duke marr për bazë metodologjinë e bazuar në risk, ku prioriteti më i lartë për tu audituar u ipet zonave të universit të auditimit tek të cilat gjatë përpilimit të matricës së riskut është vlerësuar risku më i lartë. Matrica e riskut ka ofruar një pasqyrë të qartë të niveleve të riskut nëpër fushat e audituara bazuar në gjetjet dhe rekomandimet paraprake përmes dy indikatorëve: gjasës

dhe ndikimit. Plani vjetor 2012 është hartuar konform rekomandimit të Misionit të FMN-së dhe objektivave të BQK-së.

6.2. Burimet njerëzore

Burimet njerëzore janë aseti më i çmuar i BQK-së, aset ky i cili detrminon efektivitetin dhe efikasitetin e realizimit të agjendës biznesore të BQK-së.Nisur nga kjo është vazhduar me rekrutim racional si dhe zhvillim profesional të stafit ekzistues.Në dhjetor të vitit 2011 numri i të punësuarve në BQKka qenë 176 veta. Nga numri total i të punësuarve(176) 82 janë femra dhe 94 meshkuj. Në strukturën e pozitave menaxheriale 35% marrin pjesë femrat , ndërsa 65% meshkujt.Mosha mesatare e të punësuarve në fund të muajit dhjetor 2011 ka qenë rreth 40 vjet.

Figura 119. Struktura e kualifikimit të punonjësve të BQK-së



Burimi: BQK (2012)

Në vitin 2011 , struktura kualifikuese e të punësuarve të BQK-së është si në vijim: 38 me MSc/MA (prej tyre 6 kandidat për PhD),93 me diplomë fakulteti, 39 me diplomë të shkollës së mesme , 1 me shkollë të lartë dhe 3 me shkollë fillore.

BQK vazhdimisht përkrah edukimin e të punësuarve të saj përmes kurseve, seminareve, punishteve,konferencave të rëndësishme si dhe programeve akademike relevante për BQK-në me qëllim të përmbushjes së kërkesave të tyre të punës me standarde më të larta dhe dhënies së mundësive për promovim të institucionit dhe personal.Mirënjohje të posaçme për përfaqësimin ekzemplar të BQK-së në seminare ndërkombëtare në kursin tre mujor " Applied Economic Policy" organizuar nga Instituti i FMN-së në Vjenë janë ndarë për stafin e BQK-së.

Tabela 49. Edukimi, zhvillimi profesional dhe trajnimet e personelit

Edukimi	Numri i punëtorëve
Studime Bachelor	2
Studime Master	29
Studime te doktoratës	6
Certifikimet profesionale	
CFA	2
ACCA	2
ShKÇAK	26
FSI Connect	6
Zhvillimet profesionale	
Seminare ne vend	4
Seminare jashtë vendit	68
Trajnime për Shkathtësit menaxheriale	14
Praktika studentore	
Praktikë për studentët universitar (internship-program) gjatë muajit korrik, gusht 2011 nga vendi dhe jashtë vendit	16

Burimi: BQK (2012)

Trajnimet e ndjekura gjatë vitit 2011 kryesisht janë organizuar nga; Joint Vienna Institute i FMN-së, Banka e Francës, Banka e Holandës, Banka e Polonisë, Banka e Çekisë, "Center of Excellence in Finance" i Sllovenisë, Crown Agents, Deutsche Bundesbank, Banka Qendrore Evropiane, International Academy of Financial Management, Shoqata e bankave islamike të Turqisë, etj.Gjithashtu,BQK vazhdimisht u ofron mundësi studentëve nga universitetet /kolegjet si nga vendi ashtu edhe nga jashtë mbajtjen e praktikës në BQK,kështuqe gjatë vitit 2011, gjashtëmbëdhjetë (16) studentë kanë kryer një program praktike nëBQK.

6.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së

Gjatë vitit 2011, aktiviteti ligjor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është përqendruar në zhvillimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, të cilat në pajtim me legjislacionin në fuqi janë pjesë e detyrave dhe përgjegjësive të BQK-së. Gjatë këtij viti, BQK-ja ka vijuar punën për rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ dhe harmonizimin në përputhje me legjislacionin e BE-së, standardet dhe praktikat ndërkombëtare, gjithmonë në përshtatje me dinamikën më të fundit të zhvillimeve në vend.

Kështu, me asistencën teknike të ofruar në vazhdimësi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar si dhe Banka Botërore, edhe gjatë këtij viti janë nxjerrë akte juridike si dhe janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme në drejtim të nxjerrjes së akteve tjera juridike të parapara në strategjinë ligjore të BQK-së.

Në korrik të vitit 2011, nga Kuvendi i Kosovës është miratuar Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, i cili ligj rregullon sigurimin nga autopërgjegjësia për dëmet e shkaktuara palëve të treta, e që me këtë ligj përcaktohet si sigurim i detyrueshëm.

Me qëllim të avancimit dhe konsolidimit të bazës ligjore për sistemin financiar në Kosovë, gjatë vitit 2011 është hartuar draft ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, dhe është dorëzuar për procedim të miratimit tek organet kompetente. Draft ligji i ri është hartuar në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, standardet dhe direktivat e BE-së, në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, si dhe në përputhje me parimet bazë të Bazelit për Mbikëqyrje Bankare Efektive.

Me qëllim të avancimit të infrastrukturës ligjore ekzistuese, për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e Fondeve Pensionale, duke siguruar mbrojtjen e pjesëmarrësve në fondet pensionale në Kosovë, është përgatitur edhe draft ligji për Fondet Pensionale, dhe është dorëzuar për procedim të miratimit tek organet kompetente. Ky projektligj përcakton kompetencat e Fondit të Kursimeve Pensionale në menaxhimin, administrimin dhe investimin e mjeteve pensionale të pjesëmarrësve si dhe përcakton licencimin, rregullimin, mbikëqyrjen dhe investimin e fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësve dhe fondeve plotësuese individuale.

Gjithashtu, gjatë vitit 2011 kanë vazhduar konsultimet dhe puna për hartimin e draftligjit për Sistemin e Pagesave, si dhe draft ligji për Sigurimet e Përgjithshme. Të dy këto draftligje janë të përfshira në strategjinë legjislative për vitin 2012, kur edhe pritet të përfundojnë dhe miratohen.

Për më tepër, me qëllim të modernizimit dhe harmonizimit në hap me zhvillimet më të reja, aktiviteti ligjor ka vazhduar edhe me nxjerrjen e akteve nënligjore, lidhjen e marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione vendoredhe të huaja, si dhe me një varg aktivitetesh tjera,të gjitha këto në drejtim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit financiar, duke përmbushur kështu objektivat dhe detyrat e BQK-së.

6.4. Teknologjia Informative

Infrastruktura e Teknologjisë dhe Sistemeve te Informacionit

Thelbi i procesit te zhvillimit mbetet infrastruktura, e cila ka bere te mundur centralizimin e te gjitha sistemeve bankare gjë që kaka ndikuar ne uljen e kostos se aseteve në shfrytëzim nga ana e BQK-së.Specifikisht, te gjithë shfrytëzuesit janë ne një infrastrukture me qasje ne aplikacionet bankare, si p.sh: *Flexcube* (aplikacioni kryesor bankar), *Depo/X* (aplikacioni i letrave me vlere), *Intraneti* (rrjeti i brendshëm për komunikim dhe shkëmbim te shënimeve), *Storage* (pjesa ku ruhen shënimet kryesore te shfrytëzuesve te BQK-se).

Procesi i centralizimit ka ulur dukshëm koston e menaxhimit te sistemeve, aseteve te Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit dhe ka përmirësuar produktivitetin e shërbimeve se bashku me sigurinë.

Serverët

Gjate vitit 2011 janë futur ne përdorim 16 serverë te rinj, ku 5 do te përdoren për te zëvendësuar serverët e vjetër ne sistemin kryesor bankar, dhe 4 te tjerë do te shfrytëzohen për posten elektronike te freskuar. Konsolidimi dhe centralizimi i serverëve te rinj ka ndikuar dukshëm ne uljen e kostos se operacioneve te teknologjisë informative. Te gjithë serverët janë standardizuar sipas nevojave te BQK-së.
Gjate vitit 2011 është futur ne përdorim lidhja me fibër optike me institucione relevante dhe për qëllime të sigurimit të planit të vazhdimësisë së punës.Gjate vitit 2011 ka përfunduar konfigurimi i pajisjeve te rrjetit për lidhjet e sigurta me bankat dhe tani ky komunikim behet përmes tuneleve te sigurta duke përdorur algoritmin përkatës të integritetit si dhe atë të kriptimit.Te gjitha bankat kane qasje ne sistemet tona (CSD dhe EICS) duke përdorur IP adresat respektive qe i ka ndare BQK për bankat komerciale.

Ngritja e sistemit Flexcube

Ka vazhduar ngritja e sistemit kryesor Flexcube duke kaluar në versionin e tij më të avancuar gjë që ka rritur efikasitetin e përfshirjes, procesimit dhe raportimit të të dhënave si për klientë ashtu edhe për vetë BQK-në.
Kjo është me rëndësi te madhe edhepër përputhjen me sistemin aktual të pagesave – sistemin elektronik të kliringut ndërbankar ashtu edheme sistemet e pritura për t'u implementuar ne BQK – sistemi i barazimeve bruto në kohë reale (anglisht: Real Time Grosss Setllement -RTGS) dhe SWIFT-i,etj Për me tepër, versioni i fundit është i ndërtuar mbi rregullat dhe parimet e sistemit bankar evropian kompatibil me Zonën e Përbashkët të Pagesave në Euro (anglisht: Single Euro Payments Area – SEPA).
Niveli i sigurisë dhe enkriptimit është shume i larte, gjë qe ka rëndësi te madhe për operacionet e BQK-se.Ndërveprimi mes komponentëve te sistemit është shume i shpejte, gjë qe lehtëson dhe shpejton operacionet e stafit te operacioneve bankare.

Instalimi i komponentit për investimet në letra me vlerë

Ky komponent i sistemit Flexcube është instaluar për nevojatëkryerjes sëoperacioneve te investimeve ne letra me vlere, te cilat i kryen BQK për klientë të saj.Ky komponent kamundësuarstandardizimin dhe automatizimin teknologjik dhe me këtë edhe thjeshtësimin e regjistrimit tëletrave me vlerë dhe mbikëqyrjen e tyre nga Departamenti i menaxhimit te mjeteve si dheDepartamenti i planifikimit dhe raportimit financiar, përfshirë edhe Departamentin e auditimit të brendshëm.

Instalimi i komponentit për banking përmes interneti

Ky komponent i sistemit Flexcube është instaluar për nevojatëmenaxhimit më tëstandardizuar te raportimit për klientë si dhe te mundësimit te tyre për inicimin e urdhër-transferave nga mjediset e klientëve. Me këtë komponentë është përmirësuarefikasiteti i punës se Njësisë së marrëdhënieve bankare dhe siguria e komunikimit me klientë. Ky komponent ka rritur posaçërishtcilësinë e komunikimit(dërgim raportesh elektronike dhe pranim urdhër-transferash elektronike) me Departamentin e Thesarit te Ministrisë së Financave. Gjithashtu, ky komponentmund të përdoret edhe për raporte elektronike për agjencitë e tjera qeveritare(Doganat, Administrata Tatimore etj.) si dhe klientëtjerë (bankat, sigurimet).

Për te gjitha komponentët e përmendur me sipër është bërë një vizitë zyrtare paraprake e ekspertëve të BQK-së në Bankën Friesland në Holandë, me ç'rast janë analizuar paraprakisht përfitimet që sjellin komponentet e lartcekura.

Aplikacioni i tregtimit te letrave me vlere DEPO/X

Gjatë këtij viti me sukses dhe me një afat rekord është arritur instalimi, funkcionalizimi dhe mbarëvajtja e punës në sistemin e tregtimit të letrave me vlerë. Aplikacioni për tregëtimin e letrave me vlerë DEPO/X është një kompleks sistemesh që përfshin disa komponente përgjegjëse për shërbime të caktuara.

DEPO/X është një sistem për ruajtjen dhe regjistrimin e instrumenteve të ndryshme financiare.Lidhur me letrat me vlerë, në rastin tonëpërdoren ankandet tek të cilët ruhen të dhënat elektronike lidhur me autorizimet, kryerjen e transaksioneve te ndryshme në kohë reale, pagesat automatike te interesit ne momentin e maturimit si dhe regjistrimi i tyre në sistemin e pagesave (EICS).

Ky sistem përdor pajisje te veçanta harduerike për tri ambiente pune: ambientin punës aktiv (anglisht: Primary Site), ambientin punues të fatkeqësisë dhe rimëkëmbjes (anglisht: Disaster Recovery) dhe ambientin testues (anglisht: Test & Development). Në këtë mënyrë nuk kainterferenca ne cilindo rast dhe skenar të punës me këtë sistem.

Ambienti punues (anglisht: Primary Site)

Ky ambient përbëhet nga grup pajisjesh me gatishmëri të lartë (anglisht: High Available Cluster) i cili përdoret për të menaxhuar sistemin e data bazës dhe komponentëve bazë të këtij sistemi. Serverët në Cluster funksionojnë duke përdorur bazën qëofron shërbim të automatizuar të aktivizimit të resurseve dytësore me qëllim që mos të ketë ndërprerje të shërbimeve. Gjithashtu, sistemi përdor grupe të disqeve që ofrojnë siguri në rast te prishjeve eventuale të ndonjë prej disqeve dhe konsistencë të vazhdueshme të shënimeve.

Për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave përdoret Oracle 11g së bashku me nënproduktin përkatësi cili ofron një menaxhim automatik të kopjeve identike të të dhënave. Në serverët tek të cilët lidhen shfrytëzuesit përdoret teknologji për balancimin e ngarkesës në sistem

me qëllim që performanca e aplikacionit të jetë sa më e mirë. Siguria e aplikacionit bazohet në përdorimin e certifikatave dixhitale të cilat hyjnë në funksion me aktivizimin e teknologjisëmë të sigurtënë fushën e rrugëtimit të informacionit. Për këtë teknologji shfrytëzohet gjithashtu lloji i serverëve qëështë lider në këtë fushë.

Arkitektura e rrjetit (anglisht: Network Architecture)

Rrjetëzimi është realizuar duke përdorur fjalën e fundit të teknologjisë ku janë përdorur pajisje për drejtimin dhe ridrejtimin e trafikut të informacionit por edhe pajisje të sigurisë së rrjeteve kompjuterike.

Lidhjet me bankat komerciale janë realizuar duke përdorur pajisje të veçanta por gjithashtu edhe rrugë të veçanta komunikimi duke përdorur fijet optike në të cilat gjithashtu është aplikuar teknologjia e enkriptimit dhe lidhjeve private virtuale (VPN) I ndarë për secilën bankë.

Politikat, procedurat dhe format

Ne fushën e politikave, procedurave dhe formave gjate vitit 2011 është krijuar një manual i teknologjisë informative, i cili përfshin te gjitha Politikat, Procedurat dhe Format e teknologjisë së Informacionit dhe ndahet në 5 seksione siç janë: Administrimi i TIS, Menaxhimi i Aseteve te TIS, Trajnimi dhe Përkrahja, Siguria dhe Kthimi nga Fatkeqësitë, dhe Zhvillimi dhe Menaxhimi i Softuerëve. Ne këtë manual ka asistuar teknikisht Banka Botërore duke bërë rekomandimet e nevojshme mbi këtë çështje.

7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

7.1. Marrëveshjet, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2011, BQK-ja vazhdoi me angazhimet e saja për rritjen e bashkëpunimit me institucione dhe autoritete mbikëqyrëse simotra të vendeve të ndryshme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në vitin 2011, ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Autoritetin Federal të Mbikëqyrjes Financiare në Gjermani (BaFin), dhe Memorandumin e Bashkëpunimit me Misionin e USAID-it në Kosovë, qëllimi i të cilit ishte mbështetja e zhvillimit të Regjistrit të Kredive të Kosovës. Gjithashtu, BQK-ja është bërë anëtare e Forumit Evropian për Para dhe Financa, forum ky anëtarë të së cilës janë mbi 30 banka me renome ndërkombëtare.

Ndër aktivitetetme rëndësi në këtë fushë ishin pjesëmarrja në inaugurimin e Presidentit të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), pjesëmarrja në Konferencën ndërkombëtare të Bankës së Italisë me temë "Italia dhe Ekonomia Botërore", pjesëmarrja në Konferencën ndërkombëtare në Vjenë "Integrimi Evropian në Kontekstin Global" organizuar nga Banka e Italisë dhe Banka e Finlandës, pjesëmarrja në takimin vjetor pranveror dhe vjeshtor të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB), pjesëmarrja në forume të ndryshme ndërkombëtare, pjesëmarrja në kolegjet mbikëqyrëse, në takimet vjetore të Fondit Evropian për Evropën Juglindore(*anglisht: European Fund for Southeastearn Europe- EFSE*), përkatësisht ne punën e Bordit këshillues të EFSE, pastaj në punën e Bordit Këshillues dhe tryezat e organizuara nga ana e Qendrës për zhvillimin e financave e (*anglisht: Center of Excellence in Finance - CEF*) me seli në Lubjanë, etj.

Për ta rritur nivelin e përfaqësimit të stafit të BQK-së në ngjarje profesionale ndërkombëtare, rol mjaft me rëndësi kanë luajtur programet e asistencës teknike nga

FMN, BB dhe BQE. Vlen të përmendet se në fillim të vitit 2011 është përmbyll me sukses programi i asistencës teknike i ofruar nga BQE për " Forcimin e Mbikëqyrjes Makro dhe Mikro prudenciale. Përfitimi profesional i stafit të BQK-së ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm. Për t' konkretizuar disa nga aktivitetet e mësipërme të BQK-së gjatë vitit 2011 do të elaborohen në pika të shkurtëra ato që konsiderohen si më relevate:

Projekti BQE-së ka qenë një projekt shumë i rëndësishëm dhe mjaftë prestigjioz si për nga përfitimi profesional i stafit të BQK-së ashtu edhe për nga mekanizmat/institucionet mbështetëse të realizimit të tij. Për realizimin e këtij projekti BQE nënshkroi marrëveshje partneriteti me katërmbëdhjetë (14) banka qendrore të eurosistemit. Përveç këtyre, edhe institucionet tjera financiare ndërkombëtare ishin pjesëmarrës aktiv në zbatimin e këtij projekt si Fondi Monetarë Ndërkombëtarë, Banka Botërore, Instituti i Përbashkët i Vienës (JVI); Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI Basel), Qendra për Përsosmëri Financiare (CEF –Lubjanë), Federata Evropiane Bankare (Bruksel) Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare (BCBS Bazel), Komiteti i Mbikëqyrësve Evropian Bankar (CEBS – Londër) dhe Parlamenti Evropian (Bruksel dhe Strasburg).

Ky projekt kishte tre komponentë kryesore:

Në kuadër të komponentit të parë janë mbajtur 20 trajnime dhe 3 punishte të nivelit më të lartë, në vendet e Bashkimit Evropiane

-
- Në komponentin e dytë përmes memorandumit trepalësh të mirëkuptimi me BQE, BQK-në dhe Bankën e Finlandës është punuar në avancimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm, modelet e parashikimeve dhe mbledhjes së të dhënave.
- Komponenti i tretë i projektit është fokusuar në ushtrime teknike simulimi krizash duke u fokusuar në menaxhimin e krizave dhe praktikat e bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Një bashkëpunim mjaftë i sukseshëm është realizuar në fushën e këmbimit të informacionit me institucionet më të cilat BQK ka marrëveshje bashkëpunimi. Një bashkëpunim i tillë mjaft më rëndësi gjatë vitit 2011 ishte realizuar në mes BQK-së dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (FMA) në Austri dhe atë në baza tremujore, BQK-së dhe Autoritetit te Mbikëqyrjes se Bullgarisë (FSC).

Në bashkëpunim me BB (dhe duke shfrytëzuar asistencën teknike të saj përmes ekspertëve vlerësues) janë realizuar dy raporte me rëndësi që kanë të bëjë mevlerësimin estandardeve dhe kodeve të qeverisjes korporative të bankave dhe institucioneve mikrofinanciare dheme vlerësimin e përmbushjes së 'standardeve dhe kodeve të insolvencës dhe regjimit të debitorëve dhe kreditorëve'. Njëkohësisht është inicuar edhe vlerësimi mbi standardet dhe kodet në fushën e auditimit dhe kontabilitetit.

Themelimit të BKS i parapriu edhe vizita zyrtare e delegacionit te Këshillit te Byrove të Kartonit të Gjelbër – me seli ne Bruksel, vizitë e cila u realizua për herë të parë në Kosovë, përkatësisht në BQK e që kontribuoi drejt nxitjes së mundësisë se anëtarësimit në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër me seli në Bruksel.

Ne vazhdën e këtyre zhvillimeve, në nëntor të vitit 2011, me ndihmesë edhe të BQK-së, Byroja Kosovare e Sigurimeve përgatiti dhe dorëzoi aplikacionin për anëtarësim ne Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër me seli në Bruksel.

Projektet u mundësuan falë bashkëpunimit ndërkombëtarë respektivisht asistencës teknike të ofruar nga Banka Botërore. Gjatë vitit 2011 BQK në bashkëpunim me asistencën teknike të ofruar nga Banka Botërore përgatiti Draft-Ligjin e Përgjithshëm të Sigurimeve i

cili draft-ligj është në fazën e shqyrtimit. Një ndër projektet e iniciuara qysh në fund të vitit 2010 ishte "Vlerësimi i parimeve bazë të sigurimeve" i cili projekt u finalizua në vitin 2011.

Gjithashtu BQK-ja ka shfrytëzuar edhe asistencën tëknike të të ofruar nga Departamenti i Thesarit të SHBA-ve,

Përvc tjersh vlen të përmëndet që BQK ka marrë pjesë aktive në një studim të iniciuar nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore - "EFSE" (anglisht: European Fund for Southeastearn Europe), mbi hulumtimin e mbingarkesës së kredimarrësve kosovarë, regjistri i kredive ka dhënë një kontribut direkt në realizimin e këtij studimi. Studimi i cili involvoi shtatë institucione kredidhënëse me gjithsej 1200 raste, rezultoi i suksesshëm duke nxjerrë në pah cilësinë e mirë të regjistrit si dhe rëndësinë e tijnë mbrojtjen e kredimarrësve kur është në pyetje mbingarkesa e tyre me kredi.

Ndërlidhur me këtë, duhet përmendur në veçanti se përveq rritjes së bashkupnimit ndërkombëtar në gjitha nivelet e detyrave dhe përgjegjësive të saj, mjaft përfitues i këtij bashkëpunimi ka qenë edhe vetë stafi i BQK-së, i cili ka filluar të ofrojë asistencë teknike për bankat qendrore në regjion dhe më gjerë, duke shndërruar kështu BQK-në nga marrësi në dhënës të asistencës teknike.

Përveç përfaqësimit të BQK-së në arenën regjionale dhe me gjerë, BQK-ja gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të jetë edhe organizatore dhe bashkëorganizatore e ngjarjeve më rëndësi për sektorin financiar dhe ekonominë e Kosovës.

Sfidat që e kanë përcjellur BQK-në në këtë fushë gjatë vitit 2011 ishin përpjekjet e vazhdueshme për gjetjen e mundësive për të siguruar qasjen në Sistemin SËIFT *(anglisht: Society for Ëorldëide Interbank Financial Telecommunication)*, Sitetmin e Kartonit të Gjelbër *(anglisht: Green Card System)* dhe njëkohësisht rritjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

8. Pasqyrat financiare të BQK-së

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Raporti i Auditorit te Pavarur dhe

Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

PASQYRA PËRMBLEDHËSE **FAQJA**

Raporti i auditori te pavarur	1
Pasqyra e gjendjes financiare	3
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva	5
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	6
Shënime mbi pasqyrat financiare	7 - 38

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Kosovo

T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grant-throtnon.com.mk

Per Bordin udhëheqës të
Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e gjendjes financiar më 31 dhjetor 2011, pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe një përmbledhje të politikave te rëndësishme kontabël dhe informatat tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Manaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Manaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme aq sa manaxhmenti i konsideron të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u krye në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikes dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, auditori merr në konsideratë kontrollet e brendshme te lidhura me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat e Bankës, por jo me qëllim për të shprehur një opinion mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të saj. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga manaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyre të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2011, rezultatin e saj financiar dhe rrjedhjen e parase për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2010 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka dhënë një opinion të pa modifikuar në ato pasqyra financiare me datë 27 maj 2011.

Grant Thornton LLC

Grant Thornton Shpk

Prishtinë, Kosovë

16 Maj 2012

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e gjendjes financiare

Më 31 dhjetor

Në mijë Euro	**Shënimi**	**2011**	**2010**
Aktivet			
Paraja e gatshme	7	13,456	60,194
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	31,513	25,621
Bono thesari	9	24,988	199,275
Depozita me bankat e huaja	10	1,009,046	807,332
Aktive në Fondin Monetar Ndërkombëtar	11	155,687	154,554
Aktive afatgjata materiale	12	1,576	1,725
Aktive afatgjata jo-materiale	13	1,506	909
Aktive të tjera	14	446	429
Gjithsej aktivet		**1,238,218**	**1,250,039**
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave vendase	15	209,700	203,572
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	156,509	153,868
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	782,178	798,721
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	37,059	43,228
Detyrime të tjera vendase	19	3,337	2,670
Gjithsej detyrimet		**1,188,783**	**1,202,059**
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali	20	30,000	30,000
Rezerva të përgjithshme	21	17,980	14,923
Fitimet e mbajtura		1,455	3,057
Gjithsej kapitali dhe rezervat		**49,435**	**47,980**
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		**1,238,218**	**1,250,039**

Shënimet nga faqja 7 deri në faqen 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga menaxhmenti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në 16 Maj 2012 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Gani Gerguri
Guvernator

Faton Ahmetaj
Drejtor per Planifikim dhe Raportim Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Në mijë Euro	**Shënimi**	**2011**	**2010**
Të ardhura nga interesi		10,079	4,574
Shpenzime për interes		(7,585)	(2,852)
Të ardhura nga interesi, neto	22	2,494	1,722
Të ardhura nga tarifa dhe komisione		2,651	2,575
Shpenzime për tarifa dhe komisione		(290)	(248)
Të ardhura nga tarifa dhe komisione, neto	23	2,361	2,327
Të ardhura nga grantet	24	44	57
Të ardhura operative të tjera	25	1,620	1,522
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit		(1,139)	1,408
Të ardhura operative të tjera		**5,380**	**7,036**
Shpenzime personeli	26	(2,249)	(2,395)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(625)	(564)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	27	(1,051)	(1,020)
Shpenzimet operative		**(3,925)**	**(3,979)**
Fitimi për vitin		**1,455**	**3,057**
Te ardhurat tjera gjithpërfshirëse		**-**	**-**
Gjithsej te ardhurat gjithpërfshirëse për vitin		**1,455**	**3,057**

Shënimet nga faqja 7 deri në faqen 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva

Në mijë EUR	**Kapitali i autorizuar**	**Rezerva të përgjithshme**	**Fitim i pashpërndarë**	**Gjithsej**
Gjendja më 1 janar 2010	**30,000**	**11,203**	**3,720**	**44,923**
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**-**	**-**
Fitimi per vitin	-	-	3,057	3,057
Te ardhura tjera gjithpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin	-	-	**3,057**	**3,057**
Transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet				
Transferime në rezervën e përgjithshme	-	3,720	(3,720)	-
Gjithsejt transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet	-	**3,720**	**(3,720)**	**-**
Gjendja më 31 dhjetor 2010	**30,000**	**14,923**	**3,057**	**47,980**
Gjendja më 1 janar 2011	**30,000**	**14,923**	**3,057**	**47,980**
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**-**	**-**
Fitimi ose humbja	-	-	1,455	5,733
Te ardhura tjera gjithpërfshirëse	**-**	**-**	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin	-	-	**1,455**	**5,733**
Transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet				
Transferime në rezervën e përgjithshme	-	3,057	(3,057)	-
Gjithsejt transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet	-	**3,057**	**(3,057)**	**-**
Gjendja më 31 dhjetor 2011	**30,000**	**17,980**	**1,455**	**49,435**

Shënimet nga faqja 7 deri në faqen 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Në mijë Euro	**Shënimi**	**2011**	**2010**
Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi për periudhën		1,455	3,057
Rregullime për:			
Zhvlerësimi	12	484	478
Amortizimi	13	141	86
Të ardhura nga grantet	24	(44)	(57)
Të ardhura nga interesi	22	(10,079)	(4,574)
Shpenzime për interes	22	7,585	2,852
		(458)	**1,842**
Ndryshime në bono thesari		104,122	250,380
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		(40,989)	(163,904)
Ndryshime në aktive me FMN		(1,112)	(22,477)
Ndryshime në aktive të tjera		30	(85)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave vendase		6,128	(29,672)
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN		2,678	21,490
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		(17,212)	132,947
Ndryshime në detyrimet ndaj entiteve tregtare dhe publike		(6,170)	(87,619)
Ndryshime në detyrimet e tjera vendase		77	652
		47,094	**103,554**
Interesa të marra		9,147	4,119
Interesa të paguara		(6,895)	(2,347)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operacionale		**49,346**	**105,326**
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	12	(334)	(99)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	13	(738)	(810)
Parave e perdorur në aktivitetet investuese		**(1,072)**	**(909)**
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Grante të marra		634	53
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		**634**	**53**
Ndryshimi neto i parasë dhe ekuivalentëve të saj		**48,908**	**104,470**
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		723,305	618,835
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	29	**772,213**	**723,305**

Shënimet nga faqja 7 deri në faqen 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës te cilit tashe tutje i referohemi si "Ligji". Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar.
- të kontribon në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit te brendëshëm të çmimeve.
- të mbështes rregullat e përgjithëshme ekonomike të qeverisë.

Sic është përshkruar në ligj, BQK duhet të vepron në përputhje me parimet e një tregu te hapur me një konkurencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK ushtron veprimtarinë e saj nga zyrat e saj qendrore në Prishtinë. Adresa zyrtare e BQK është si më poshtë:

Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

Bordi i BQK-së, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

Në BQK vendimet merren nga: Bordi i BQK-së, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 79, paragrafi 2 i ligji-t, Bordi i BQK-së përbëhet nga: Guvernatori, Drejtori Gjeneral i Thesarit dhe tre anëtar jo-ekzekutiv që janë përgjegjës për mbikqyrjen e: implementimit të politikave, e adiministratës dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2011, Bordi i BQK-së përbëhej nga këta anëtarë:

- Gazmend Luboteni – Kryetar i Bordit
- Gani Gerguri – Guvernator
- Zilif Lufi – Anëtar, u.d. Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Financave
- Sejdi Rexhepi – Anëtar
- Mejdi Bektashi – Anëtar

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e vlersimeve specifike per secilen lloj te aseteve, detyrimeve, te hyrave dhe shpenzimev ne perputje me SNRF. Baza e matjeve (vlersimeve) ne formë me te plotë është e shpalosur ne politika kontabël me poshtë.

2. Baza e përgatitjes (në vazhdim)

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro ("EUR"), e cila është monedha funksionale e BQK-së. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Euro është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti i Bankës që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vleresuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, në shënimin 5 jepet informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare.

Polikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

3. Politika të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj vlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së veprimeve. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të tregut rivlerësohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e tregut. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave si fitim ose humbje.

b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër kur është e përshtatshme) deri në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivit ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet a paguara apo të arkëtuara, kostot e transaksioneve, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë interesat nga aktivet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

c) Tarifa dhe komisione (ndalesat) ne sherbime

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet (ndalesat) të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, transferimet e fondeve dhe tarifat e licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

d) Përfitimet e punonjësve

i. Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

BQK paguan kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve me kontribute të përcaktuara bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Gjithashtu, BQK-ja bën kontribute ne plane pensioni sikurse lejohet nga legjislacioni i Kosovës, ku shteti siguron përfitime pensioni për punonjësit deri në daljen e tyre në pension. Këto kontribute për planet e pensionit i ngarkohen si shpenzim fitimit ose humbjes në momentin kur ndodhin.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 miratuar më 22 Korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si bëhet shpërndarja e neto rezultatit.

f) Aktivet dhe detyrimet financiare

Banka klasifikon investimet e saja në këto kategori: aktivet financiare më vlerë reale sipas fitimit apo humbjes, kreditë dhe detyrimet, aktivet financiare të mbajtura deri në maturim dhe aktivet financiare të gatshme për tregtim. Ky klasifikim varet nga qëllimi për të cilin investimet janë siguruar. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të tij sipas njohjes fillestare dhe e rivlerëson këtë gjatë çdo date të raportimit.

Aktivat financiar më vlerë reale sipas fitimit apo humbjes

Kjo kategori ka dy nënkategori: aktivat financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të përcaktuara sipas vlerës reale të fitimit apo humbjes së pësuar. Një aktiv financiar klasifikohet në “aktivet financiare më vlerë reale sipas kategorisë së fitimit apo humbjes së pësuar nëse parimisht sigurohet më qëllim të shitjes afatshkurte, nëse formon një pjesë të portofolit të aktiveve financiare në të cilat ka dëshmi të përfitimit afatshkurtër, apo nëse përcaktohet kështu nga menaxhmenti. Banka nuk ka aktiva të klasifikuara në këtë kategori.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Financial assets and liabilities

Kreditë dhe te arkëtueshmet

Kreditë dhe detyrimet janë aktiva financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe që nuk citohen në një treg aktiv përveç atyre që Banka ka për qëllim t'i shesë në afat të shkurtër apo që i ka përcaktuar në vlerën reale sipas fitimit apo humbjes apo vënë në dispozicion për shitje. Fillimisht kreditë dhe detyrimet njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodent e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi. Provizioni për dëmin e kredive dhe detyrimeve përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrueshme sipas kushteve fillestare.

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme përveç atyre që plotësojnë përcaktimin e kreditorëve dhe detyrimeve që menaxhmenti i Bankës ka qëllim dhe mundësi pozitive që të mbaj sipas maturitetit. Fillimisht akivet njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi, Provizioni për dëmin e shumave të mbajtura në maturim përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrueshme sipas kushteve fillestare.

Aktive financiare të gatshme për tregtim

Aktive financiare të gatshme për tregtim janë aktive financiare jo-derivative të cilat ose përcaktohen në këtë kategori ose klasisfikohen në ndonjërën nga kategoritë tjera. Banka nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

i. Njohja

BQK-ja fillimisht njeh depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Asetet Financiare apo Aktivitet Financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për artikujt jo me vlerën e drejtë nëpërmjet duke i vlersuar permes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

ii. Çregjistrimi (Mosnjohja)

BQK-ja çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë që vijnë nga aktivi finaciar, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi aktivin financiar përmes një transaksion në të cilin tranferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar. Interesat në aktivin financiar të transferuar të cilat janë krijuar apo mbajtur nga BQK-ja njihen si një aktiv apo detyrim i veçantë. Në çregjistrimitn e një aktivi financiar, ndryshimi në mes të vlerës kontabël të aktivit (ose vlerës kontabël të ndarë në pjesën e aktivit të transferuar), dhe shumën e (i) vlerës së marrë (duke përfshirë çdo aset të ri që ka marrë minus çdo detyrimi të ri të supozuar) dhe (ii) çdo përfitim apo humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera të përmbledhura, njihet si rfitim ose humbje.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

BQK-ja çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

iii. Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma paraqitet neto në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standartet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

v. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një aset mund të këmbehet, ose një detyrim të shlyhet, në mes të palëve të në një transaksion të vullnetshëm midis palëve në datën e matjes (vlerësimit).

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë e një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuara në një treg aktiv për këtë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuara janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të përfaqësojnë transaksionet që ndodhin akutalisht në treg në bazë të vullnetëshme midis palëve.
Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK krijon vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të midis palëve të mirë informuara dhe ne formë te vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e skontimit të rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i marrin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranuara ekonomike për vendosjen e çmimit tëinstrumenteve financiare.

vi. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (humbjes ne vlerë)

Në çdo datë raportimi BQK vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e tregut përmes pasqyrës së të ardhurave ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja nuk do t'i kishte konsideruar, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me sjelljen e vështirësive financiare në BQK.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

Humbja ne vlerë (zhvlerësimi) i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të vlerësuara të parave që skontohen me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave ose humbjeve.

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, llogari rrjedhëse me bankat dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiar me kosto të amortizuar.

h) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë që mbahen për investim, që janë Bonot e Thesarit, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim trajtohen si investime që mbahen deri në maturim.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks, të cilat BQK-ja ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në raste të shitjes ose riklasifikimit përpara maturimit të një sasie të konsiderueshme të letrave me vlerë që mbahen deri në maturim, larg kohës së maturimit të tyre, do të rezultojë në një riklasifikim të të gjitha letrave me vlerë që mbahen deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte BQK-në të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

i) Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejtë, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur. Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij aktivi të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të perditshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

	2011	**2010**
• Investimet në objektet me qira	20 vjet	20 vjet
• Pajisjet	5 vjet	5 vjet
• Kompjuterë	3 vjet	3 vjet
• Automjete	5 vjet	5 vjet

Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

j) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet ne vleresimin per shfrytezimin e atij programi pa qene nevoja per ndonje permiresim te madh.

k) Zhvlerësimi i aktiviteteve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse të parasë që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësive gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis aktiveve të tjera të njësisë për të zvogëluar vlerën kontabël të tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk egziston më. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

l) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

m) Të ardhurat nga grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një aktivi njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të aktivit.

n) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtarë të caktuar dhe financuar për një afat të shkurtër nga organizata ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtarë. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në pasqyrat financiare.

o) Provizionet

Provizionet njihen nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e skontuar rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, rrezikun specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis kostos së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e aktivit të lidhur me atë kontratë.

p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

(i) Standardet e reja dhe të ndryshuara nga Banka

Përmirësimet në SNRF 2010 kanë bërë disa ndryshime të vogla në një numër të SNRF-ve. Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka shpjerë në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Bankës.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

(ii) Standardet, interpretimet dhe ndryshimet në standardet e nxjerra por që nuk janë në fuqi për vitin financiar që fillon me 1 janar 2011 e që nuk janë miratuar më parë nga Banka

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standarde të caktuara, ndryshime dhe interpretime të standardeve ekzistuese janë publikuar nga BSNK-ja por që ende nuk janë në fuqi dhe nuk janë miratuar më parë nga Banka.

Menaxhmenti pret që të gjithat shpalljet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Bankës për periudhën e parë që fillon pas datës së hyrjes në fuqi të shpalljes së tyre. Informacionet rreth standardeve të reja, ndryshimeve dhe interpretimeve që priten të jenë relevante për pasqyrat financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Janë nxjerrë edhe standarde dhe interpretime të caktuara tjera të reja por ato nuk priten që të kenë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 9 Instrumentet Financiare (SNRF 9)

BSNK-ja ka për qëllim që të zëvendësojë në tërësi SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 është shfrytëzuar në faza. Deri me tani, janë nxjerrë kapitujt që kanë të bëjnë më njohjen, klaisifikimin, matjen dhe çregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Këta kapituj janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2015. Kapitujt tjerë që kanë të bëjnë më metodologjinë e zhvlerësimit dhe llogaritjen kufizuese janë ende në zhvillim e sipër.

Standardet e Konsolidimit

Një pako standardesh të konsoliduara është efektive për periudhën që fillon më 1 janar 2013. Informacionet rreth këtyre standardeve të reja janë paraqitur më poshtë. Menaxhmenti i kompanisë duhet të vlerësojë ndikimin e këtyre standardeve të reja dhe të rishikuara.

SNRF 10 Pasqyrat e Konsoliduara Financiare (SNRF 10)

SNRF 10 zëvendëson SNK 27 Pasqyrat e Konsoliduara dhe të Veçanta Financiare (SNK 27) dhe KSI 12 Konsolidimi – Subjektet më Qëllim të Posaçëm. Ai ka rishikuar përkufizimin e kontrollit së bashku me udhëzimin përcjellës për të identifikuar një interes në një degë. Megjithatë, kërkesat dhe mekanika e konsolidimit dhe kontabilitetit për interesat dhe ndryshmet jo-kontrolluese në kontroll mbesin të njëjta.

SNRF 11 Aranzhimet e Përbashkëta (SNRF 11)

SNRF 11 zëvendëson SNK 31 Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta (SNK 31). Llogaritjen nga investitorët e sjell më afër më të drejtat dhe obligimet e tyre lidhur me aranzhimin e përbashkët. Përveç kësaj, opsioni i SNFR 11 për të shfrytëzuar konsolidimin proporcional për sipërmarrjet e përbashkëta është eliminuar. SNFR 11 tani kërkon shfrytëzimin e metodë së llogaritjes së kapitalit, e cila aktualisht shfrytëzohet për investimet në shoqëri.

SNRF 12 Shpalosja e Interesave në Entitetet Tjera (SNFR 12)

SNFR 12 integron dhe e bën të qëndrueshme kërkesën për shpalosje për llojet e ndryshme të investimeve duke përfshirë entitetet me strukturë të pakonsoliduar. Paraqet kërkesat e reja për shpalosje lidhur me rreziqet ndaj të cilave ekspozohet një entitet nga përfshirja e tij me entitete e strukturuara.

Ndryshimet pasuese në SNK 27 dhe SNK 28 Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (SNK 28)

SNK 27 tani merret vetëm më deklaratat e veçantë financiare. SNK 28 sjell në fushëveprimin e saj investimet në sipërmarrje të përbashkëta. Megjithatë, metodologjia për llogaritjen e kapitalit mbetët e njëjtë.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(ii) Standardet, interpretimet dhe ndryshimet në standardet e nxjerra por që nuk janë në fuqi për vitin financiar që fillon me 1 janar 2011 e që nuk janë miratuar më parë nga Banka (vazhdim)

SNFR 13 Matja e Vlerës së Drejtë (SNFR 12)

SNFR 13 nuk ndikon se cilët zëra kërkohen që të vlerësohen drejtë, por sqaron përcaktimin e vlerës së drejtë dhe ofrojnë udhëzime përkatëse dhe shpalosje të shtuar rreth matjeve të vlerës së drejtë. Është i zbatueshëm për periudhat vjetor që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013. Menaxhmenti i kompanisë duhet të vlerësojë ndikimin e këtij standardi.

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Ndryshimet SNK 1)

Ndryshimet në SNK 1 kërkojnë nga një subjekt që t'i grupojë zërat në të hyrat tjera të përmbledhura në ato që, në përputhje me SNRF: (a) nuk do të riklasifikohen më pas në fiton ose humbje dhe (b) do të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje pas plotësimit të kushteve të caktuara. Është e zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013. Menaxhmenti i kompanisë pret që kjo të ndryshojë paraqitjen e tanishme të zërave në të hyrat tjera të përmbledhura; megjithatë, nuk do të ndikojë në matje apo njohjen e zërave të tillë.

Ndryshimet në SNK 19 Përfitimet e Punonjësve (Ndryshimet SNK 19)

(Ndryshimet në SNK 19 përfshijnë një numër të përmirësimeve të synuara nëpërmjet këtij standardi. Ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me planet e definuara të përfitimit. Ato:

- eliminojnë 'metodën e korridorit', që kërkon nga entitetet që të njohin të gjitha fitimet dhe humbjet që lindin në periudhën raportimit,
- rregullojnë paraqitjen e ndryshimeve planin e aktiveve dhe detyrimeve,
- shtojnë kërkesat për shpalosje, duke përfshirë informacionet rreth karakteristikave të planeve të definuara të përfitimit dhe rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen subjektet që marrin pjesë në to.

Versioni i ndryshuar i SNK 19 është efektiv për vitet financiare që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013. Menaxhmenti i kompanisë duhet të vlerësojë ndikimin e këtij standardi të rishikuar në pasqyrat e konsoliduara financiare të kompanisë.

4. Administrimi i Rrezikut Financiar

a) Prezantim dhe të përgjithshme

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kreditimit
- rreziku operacional
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipëme si dhe objektivat, politikat dhe procedurat për matjen dhe administrimin e tyre si dhe për administrimin e kapitalit të BQK-së. Shënime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Struktura e administrimit të rrezikut

Krijimi dhe mbikëqyrja e strukturës së administrimit të rrezikut të BQK-së është përgjegjësi e Bordit ekzekutiv të BQK-së. Bordi ekzekutiv i BQK-së raporton rregullisht tek Bordi i BQK mbi veprimet e lidhura me administrimin e rrezikut. Bordi ekzekutiv dhe Komitetit i investimeve janë të angazhuar në zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika implementohen më pas nga njësitë organizative përkatëse.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e ndeshura nga BQK-ja, për të vendosur limite dhe kontrolle të përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, BQK-ja synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet e ndeshura nga BQK-ja. Komiteti i auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Drejtorati i auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe rastësore, rezultatet e të cilave, permese Shefit te auditimit behet raportimit te Komitetit të auditimit.

b) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një klient ose një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale të veta, dhe shkaktohet kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozitat në banka të tjera.

Administrimi i rrezikut të kreditimit

i. Investimet dhe ekspozimi në banka të tjera

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra me vlerë të emetuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave te huaja, detyrimet afatshkurtra të të cilave janë të vlerësuara në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2011 dhe 31 dhjetor 2010 paraqitet nga vlera e mbartur e parasë në arkë, e llogarive rrjedhëse me bankat jo-rezidente, e bonove të thesarit dhe e depozitave me bankat jo-rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referojuni shënimeve 7, 8, 9 dhe 10.

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është me vonesë ose me rënie në vlerë. Nuk ka ndryshime në politikat e administrimit të rrezikut nga vitet e kaluara. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit.

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja nuk do të jetë në gjendje të përmbushë në kohën e duhur obligimet e lidhura me detyrimet financiare.

4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar të dëmtojë reputacionin e saj.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi . BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jorezidente dhe duke mbajtur shuma të mjaftueshme të mjeteve monetare në arkat e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të përkeqësuara BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testime të rregullta kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë pjesë e rishikimit dhe aprovimit të Bordi ekzekutiv i BQKsë. Raportet ditore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i kalohen anëtarëve të Komitetit të investimeve nga Drejtorati i menaxhimit të mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për detyrimet financiare

31 dhjetor 2011 *Detyrimet jo-derivative*	**Shënimi**	**Vlera e mbartur**	**Më pak se 1 muaj**	**1-3 muaj**	**3 muaj deri në 1 vit**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	209,700	209,700	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	156,509	136,045	-	20,464
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	782,178	355,365	165,171	261,642
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	37,059	37,059	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	2,427	2,427	-	-
		1,187,873	**740,596**	**165,171**	**282,106**
31 dhjetor 2010					
Detyrimet jo-derivative					
Detyrime ndaj bankave vendase	15	203,572	203,572	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	153,868	131,775	-	22,093
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	798,721	497,145	226,351	75,225
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	43,228	43,228	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	2,419	2,419	-	-
		1,201,808	**878,139**	**226,351**	**97,318**

4. Menaxhimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela e mësipërme tregon rrjedhjet e parasë të paskontuara të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të herëshme të maturitetit të tyre kontraktual. Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK mban aktive likuide që përfshijnë para dhe ekuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe të Kosovës

Kriza ekonomike dhe financiare botërore ka rezultuar, përveç të tjerave, në një nivel më të ulët të financimit të tregut kapital, nivel më të ulët të likuiditetit në sektorin bankar, ulje të normave të interesit nga bankat qendrore për të ndihmuar huamarrësit, injektime të kapitalit nga qeveritë, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri në tregun e aksioneve. Zhvillimet e mëtejshme të pafavorshme që rezultojnë nga kriza mund të kenë ndikim në pozicionin financiar dhe të likuiditetit të BQK-së.

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat kreditore (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtura nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga risku.

Menaxhimi i rrezikut të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në masën që aktivet dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Aktivet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçmimit të indekseve të shumëllojshëm me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistente me strategjitë e veprimit të BQK-së.
Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e riçmimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve. Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portofoleve jo të tregtueshme paraqitet si më poshtë:

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

	Shënimi	Vlera e mbartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite
31 Dhjetor 2011						
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	31,513	31,513	-	-	-
Bono thesari	9	24,988	-	24,988	-	-
Depozita me bankat e huaja	10	1,009,046	727,474	177,255	104,317	-
Aktive me FMN	11	155,687	135,223	-	-	20,464
Gjithsej		**1,221,234**	**894,210**	**202,243**	**104,317**	**20,464**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(209,700)	(209,700)	-	-	-
Detyrime ndaj FMN	16	(156,509)	(136,045)	-	-	(20,464)
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	17	(782,178)	(709,429)	(32,652)	(40,097)	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(37,059)	(37,059)	-	-	-
Detyrime të tjera vendase		(2,427)	(2,427)	-	-	-
Gjithsej		**(1,187,873)**	**(1,094,660)**	**(32,652)**	**(40,097)**	**(20,464)**
Ndryshimi		**33,361**	**(200,450)**	**169,591**	**64,220**	**-**

	Shënimi	Vlera e mbartur	Më pak se 3 muaj	3 - 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite
31 Dhjetor 2010						
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	25,621	25,621	-	-	-
Bono thesari	9	199,275	69,902	94,665	34,708	-
Depozita me bankat e huaja	10	807,332	567,765	103,143	136,424	-
Aktive me FMN	11	154,554	132,461	-	-	22,093
Gjithsej		**1,186,782**	**795,749**	**197,808**	**171,132**	**22,093**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(203,572)	(203,572)	-	-	-
Detyrime ndaj FMN	16	(153,868)	(131,775)	-	-	(22,093)
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	17	(798,721)	(527,101)	(100,222)	(171,398)	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(43,228)	(43,228)	-	-	-
Detyrime të tjera vendase		(2,419)	(2,419)	-	-	-
Gjithsej		**(1,201,808)**	**(908,095)**	**(100,222)**	**(171,398)**	**(22,093)**
Ndryshimi		**(15,026)**	**(112,346)**	**97,586**	**(266)**	**-**

Aktivet dhe detyrimet financiare që nuk mbartin interes nuk janë përfshirë në tabelën më lartë.

4. Menaxhimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregëtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Drejtorati i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të meangjuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të hendekut të normave të interesit, kompletohet duke vëzhguar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standartë dhe jo-standartë të normave të interesit. Skenarët standartë të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh baze (bp). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2011

	100 bp Ritje	100 bp Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	376	(376)

2010

	100 bp Ritje	100 bp Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	150	(150)

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutore të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja CBK është e ekspozuar ndaj SDR lidhur me aktivet dhe detyrimet e saj në FMN, të cilat i monitoron në vazhdueshmëri. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

2011

	100 bp Ritje	100 bp Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	35	(35)

2010

	100 bp Ritje	100 bp Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	7	(7)

4. Menaxhimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

31 Dhjetor 2011	EUR	DVT	Totali
Aktive			
Paraja e gatshme	13,456	-	13,456
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	31,513	-	31,513
Bono thesari	24,988	-	24,988
Depozita me bankat e huaja	1,009,046	-	1,009,046
Aktive me FMN	20,464	135,223	155,687
Aktive të tjera	446	-	446
Gjithsej	**1,099,913**	**135,223**	**1,235,136**
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave vendase	209,700	-	209,700
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	73,668	82,841	156,509
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	782,178	-	782,178
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	37,059	-	37,059
Detyrime të tjera vendase	3,337	-	3,337
Gjithsej	**1,105,942**	**82,841**	**1,188,783**
Pozicioni neto për valuta të huaja		**52,382**	

31 Dhjetor 2010	EUR	DVT	Totali
Aktive			
Paraja e gatshme	60,194	-	60,194
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	25,621	-	25,621
Bono thesari	199,275	-	199,275
Depozita me bankat e huaja	807,332	-	807,332
Aktive me FMN	22,141	132,413	154,554
Aktive të tjera	429	-	429
Gjithsej	**1,114,992**	**132,413**	**1,247,405**
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave vendase	203,572	-	203,572
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	72,982	80,886	153,868
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	798,721	-	798,721
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	43,228	-	43,228
Detyrime të tjera vendase	2,670	-	2,670
Gjithsej	**1,121,173**	**80,886**	**1,202,059**
Pozicioni neto për valuta të huaja		**51,527**	

4. Menaxhimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja me të cilat merret BQK-ja janë kryesisht "Të Drejtat e Vecanta të Tërheqjes" ("DVT"). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 ishin si vijon:

	2011 EUR	2010 EUR
1 DVT	1.186	1.159

DVT-të janë aktive shtesë nga rezervat e kursit të këmbimit që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqsëojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT - ve përcaktohet si mesatare e shportës së katër valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britaneze dhe jeni japonez.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BKQ-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përvec rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe standardet e pranuara gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative. Objektivi i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional si dhe të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me administrimin efektiv të kostove. Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket stafit menaxhues të çdo njësie organizative. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për manaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për rakordime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për administrimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve kontingjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimit të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i brendshëm. Gjetjet e kontrolleve të Auditimit të brendshëmdiskutohen me menaxherët e njësisë organizative me të cilat ato janë të lidhura dhe konkluzionet i dërgohen Komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të BQK-së.

4. Menaxhimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

f) Menaxhimi i Kapitalit

Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qëndrore të Republikës së Kosovës, aprovuar më datë 22 Korrik 2010 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përcakton kërkesat e kapitalit të BQK-së. Sipas këtij ligji, kapitali i autorizuar i BQK-së është 30 milionë Euro. Kapitali mund të rritet me shuma të tilla sic propozohet nga BQK dher aprovohet nga Qeveria. Asnjë reduktim i kapitalit të BQK nuk do të lejohet në asnjë kohë.

Sipas ligjit nr.03/L-209, e ardhura neto ose humbja neto e BQK llogaritet në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

E ardhura neto shpërndahet cdo vit në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë përqind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qëndrore.

Pjesa prej 50% e balancës neto e të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës. Ndërsa 50% që mbetet nga e ardhura e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti i BQK-së diskuton me Bordin zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 4).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Lejimet për humbjet kreditore

Aktivet e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi). Përbërësi specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të rrjedhjeve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave menaxhmenti i BQK-së gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të cdo kolaterali të nedosur. Çdo aktiv me rënie në vlerë, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që aktivet dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e aktiveve si të mbajtura deri në maturim, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për ti mbajtur aktivet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h).

6. Aktivet dhe detyrimet financiare (Klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre.

Në mijë Euro	Shënimi	Kredi dhe llogari të arkëtueshme	Të mbajtura deri në maturim	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale e mbartur	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2011						
Paraja e gatshme	7	13,456	-	-	13,456	13,456
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	31,513	-	-	31,513	31,513
Bono thesari	9	-	24,988	-	24,988	24,990
Depozita me bankat e huaja	10	1,009,046	-	-	1,009,046	1,009,046
Aktive me FMN	11	155,687	-	-	155,687	155,687
		1,209,702	**24,988**	**-**	**1,234,690**	**1,234,692**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	209,700	209,700	209,700
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	156,509	156,509	156,509
Detyrime ndaj institucineve qeveritare	17	-	-	782,178	782,178	782,178
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	37,059	37,059	37,059
Detyrime të tjera vendase	19	-	-	2,427	2,427	2,427
		-	-	**1,187,873**	**1,187,873**	**1,187,873**
31 dhjetor 2010						
Paraja e gatshme	7	60,194	-	-	60,194	60,194
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	25,621	-	-	25,621	25,621
Bono thesari	9	-	199,275	-	199,275	198,490
Depozita me bankat e huaja	10	807,332	-	-	807,332	807,332
Aktive me FMN		154,554	-	-	154,554	154,554
		1,047,701	**199,275**	**-**	**1,246,976**	**1,246,191**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	203,572	203,572	203,572
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	153,868	153,868	153,868
Detyrime ndaj institucineve qeveritare	17	-	-	798,721	798,721	798,721
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	43,228	43,228	43,228
